

Andrea Dhima Tiranë

# NENDORI

e përmuajshme letrare artistike  
shoqërore politike

6

DH. S. SHUTERIQI:  
POEZI  
S. VERDHA:  
LUFTA E RAMUSHIT  
R. KELMENDI:  
DY TREGIME

**ARKITEKTËT  
SHTROJNË PROBLEMET E TYRE**

**TAKIMI KOMBËTAR I ARKITEKTËVE  
RAPORTI - DISKUTIMET**

# NENDORI

Çimmi lek 3



15.10.68

16!



# NENDORI

Revistë e përmuajshme  
letrare-artistike  
shoqërore-politike

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE  
TË SHQIPËRISË

Nr. 6 VITI XVIII I BOTIMIT QERSHOR 1971

L E N D A :

## TAKIMI KOMBËTAR I ARKITEKTËVE

	Faqe
SOKRAT MOSKO	
Për një nivel më të lartë në krijimtarinë tonë urbanistike dhe arkitektonike, <i>raport.</i>	5
Nga diskutimet.	30
Realizime të arkitekturës sonë, <i>fotografi.</i>	79

## STUDIM

AGIM POLOVINA	
Chësia kompozicionale e romanit tonë.	115
Katër pyetje Petro Markos për romanin «Ara në mal».	133

## KUJTIME

SALI VERDHA	
Lufta e Ramushit.	141

## KRIJIME LETRARE

DHIMITËR S. SHUTERIQI	
Naimit — Malli i velave të bardha — Në shtëpi, të fush' e kuqe — Këngë dritash — Dëshmitarë — Për Sh. — Malli i poezisë, <i>vjersha.</i>	153
HARALLAMB QESKO	
Kënga — «Vajza e valëve» — Ekzotikë detare — Katakombë dasmash — Pemët rrëzojnë këngët — Ajri freskohet <i>vjersha.</i>	161
GËZIM EREBARA	
Metamorfozë — Në xhamin e dritares sime, <i>vjersha.</i>	165



	Faqe
DIONIS QIRIXIDHI	Lef Sallata — Së shpejti nisin korret. — Fillimi i një poeme — Këngë për këngëtarin lab, <i>vjersha.</i> 168
BAJAZIT CAHANI	Diella — Ujvarat — Vargje të bardhë, <i>vjersha.</i> 171
SOTIR TH. ANDONI	Një ditë në mes të pyjeve, <i>tregim.</i> 173
KRISTAQ BALLI	Dy njerëz mbi shkrepë, <i>tregim.</i> 205
SPIRO GJIKONDI	Pas pesë vjetësh, <i>tregim.</i> 211
MARK KRASNIQI	Lirisë — Katundi i djegun, <i>vjersha.</i> 224
ALI PODRIMJA	Njeriu i zdashun lakuriq shetit nëpër botë. — Ballada për urën, <i>vjersha.</i> 227
RRAHMAN DEDAJ	Dera e një miniere — * * * — Orfe i malit, <i>vjersha.</i> 229
SHPRESA THAÇI	Këngë më vete. — Shokut tim A., <i>vjersha.</i> 231
RAMIZ KELMENDI	Bazeni — Abrakadabra, <i>tregime.</i> 232

#### BOTIME TË REJA

- Joga e bardhë ● Riza Cerova ● N. E. ● Agjenti 333. 252

#### NGJARJE KULTURALE ARTISTIKE

- Festivali IV i këngës dhe valles i fëmijëve të kopshteve të Tiranës. 258
- Festivali kombëtar i këngës dhe valles popullore të përpunuar. 260

Në kopertinën I: Studim i Institutit të projekteve për qendrën e Vlorës, fragment.

Në kopertinën IV: Këngëtarët e Shëpalit — nga Maks Velo.

Kryeredaktor: Fatmir Gjata.

Kolegjumi i redaksisë: Andon Kuçali (sekretar i kolegjumit), Dilaver Dilaveri, Dhimitër Xhuvani, Eglantina Mandia, Fatos Arapi, Gjergj Zheji, Jakov Xoxa, Lavdie Leka, Pandi Mele, Sandër Çefa, Sterjo Spasse.

# TAKIMI KOMBËTAR I ARKITEKTEVE

Më 6 maj, në Tiranë, në sallën e leksioneve të Pallatit të madh të kulturës, zhvilloi punimet takimi i parë kombëtar i arkitektëve i organizuar nga kryesia e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Në takim merrnin pjesë arkitektë, inxhinierë ndërtimi, skulptorë, piktorë, studentë të degës së arkitekturës së USHT e punonjës të artit e letërsisë.

Midis tyre ndodheshin edhe anëtarët e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Manush Myftiu, Ramiz Alia e Spiro Koleka, anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë Dashnor Mamaqi, Fadil Paçrami e Nexhmije Hoxha, ministri i arësimit e kulturës Thoma Deliana, kryetari i komitetit ekzekutiv i k.p. të rrethit Myqerrem Fuga, kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë Dhimitër Shuteriqi, sekretari i parë i Komitetit Qendror të BRPSH Agim Mero e të tjerë.

Takimin e hapi ministri i ndërtimit Shenasi Dragoti, i cili ndër të tjera tha: «Në këtë dinamizëm të pashëmbëllt të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, në këtë transformim të madh shoqëror ekonomik e kultural drejt socializmit e komunizmit, një barrë me përgjegjësi të madhe historike bie mbi inxhinierët dhe arkitektët e vendit tonë, që të kryejnë sa më mirë detyrat që u takojnë. Këto vepra duhet t'i përshkojë arti dhe teknika moderne e ndërtimeve të aplikuara me aftësi e dinjitet në përshatje me kushtet konkrete të vendit, që ndërton socializmin. Ato duhet të ruajnë brez pas brezi vulën e përpjekjeve dhe të djersës së popullit tonë, i cili ndërton so-



cializmin me udhëheqjen e Partisë së Punës, talentin dhe aftësinë e tij krijuese, entuziazmin dhe ndërgjegjen e tij të lartë revolucionare. Këto vepra duhet të qëndrojnë gjatë kohërave, jo vetëm nga pikëpamja e qëndrueshmërisë së tyre, por edhe si art, si krijimtari, si mishërim i madhësisë së kësaj epoke të lavdishme, që jemi duke kaluar dhe thjeshtësisë proletare që e karakterizon».

Pastaj, shoku Sokrat Mosko, anëtar i komitetit drejtues të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, mbajti referatin kryesor. Pas referatit diskutuan shokët Misto Mele, Valentina Pistoli, Koço Miho, Kostaq Sahatçiu, Niko Titka, Petraq Kolevica, Anton Lufi, Enver Faja, Fuat Dushku, Foto Stamo, Vasilika Cicko, Fadil Paçrami, Kristaq Rama, dhe studentët diplomantë të degës së arkitekturës Ilir Fico, Maksim Mitrojorgji dhe Violentina Shehu.

Pastaj e mori fjalën kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve Dhimitër S. Shuteriqi. Pasi foli për rëndësinë e këtij takimi të parë, që shtroi dhe diskutoi probleme, që preokupojnë ndërtimet urbanistike, shoku Dh. S. Shuteriqi theksoi se në situatën e tanishme, kur ritmet e ndërtimeve po shtohen, kur objekte të reja e të shumta do të ndërtohen, është e nevojshme, për të përballuar këtë vëllim të madh pune, shtimi i kuadrove dhe specializimi i tyre. Gjithashtu ai tha se arkitektët tanë duhet të përfitojnë më shumë nga tradita jonë, nga përvoja 25-vjeçare e ndërtimeve dhe nga ajo botërore, por duke iu shmangur ndikimeve të dëmshme; se ata duhet të rrisin shpirtin e tyre krijues, të eksperimentojnë duke u bazuar më shumë mbi dijen, të zgjerojnë e të thellojnë njohuritë shkencore, që të jenë më të aftë për të ndërtuar ashtu si këshillon Partia.

Në fund, nga mbledhja iu dërgua një letër KQ të PPSH.

Koresp. i «Nëndorit»

# PER NJE NIVEL ME TE LARTE NE KRIJIMTARINE TONE URBANISTIKE DHE ARKITEKTONIKE

*Raport i shokut SOKRAT MOSKO*

Gjatë gjithë historisë së vet, populli ynë është shquar për aftësitë dhe talentin e admirueshëm në artin e të ndërtuarit, por kurrë ai nuk ka mundur dot të ndërtojë aq shumë sa në këto njëzet e shtatë vjet të jetës së tij të lirë në rrugën që i tregoi dhe në të cilën e udhëheq Partia.

Hapat vigane të pesëvjeçarëve, përpjestimet e pashembullta të ndërtimeve si rezultat i zhvillimit të gjithanshëm ekonomik, kultural dhe arësimor, e kanë kthyer atdheun tonë në një kantjer të pafund ndërtimi. Të rrethuar me skelat e përherëshme të ndërtimit, të cilat tanimë janë bërë tipare të tyre dalluese, qytetet dhe fshatrat tona janë rritur dhe zhvillohen me ritme shumë të shpejta duke plotësuar më mirë nevojat dhe kushtet e jetës dhe të punës të njerëzve tanë. Ata janë bërë e po bëhen gjithënjë e më të bukur. Pamja e tyre ka ndryshuar kaq shumë sa është vështirë t'i njohësh, aq të thella janë transformimet që kanë pësuar, duke u kthyer nga qytete me tipare mesjetare, me rrugë të ngushta e ndërtime përdhese kaotike, në qytete komode, me rrugë e sheshe të gjëra, plot godina të bukura banimi, social-kulturale, shërbimi, prodhimi etj. Të shumtë janë dhe qytetet e rinj që lindën nga zhvillimi i vrullshëm industrial i vendit e që



ndërtohen në bazë të parimeve të jetës sonë socialiste. Numri i qyteteve tona në krahasim me paraluftën është dyfishuar, ndërsa popullsia e tyre është katërfishuar. Vetëm Tirana ka sot më shumë banorë nga sa kishin të gjithë qytetet e Shqipërisë të marrë së bashku më 1938.

Nga ana tjetër, ritmet e ndërtimit rriten me shpejtësi të mahnitëshme. Plani i pesëvjeçarit të IV për ndërtim-montim caktuar nga Kongresi V i Partisë u plotësua në 4 vjet e 4 muaj, duke u kryer kështu një vëllim pune 43<sup>0</sup>/<sub>0</sub> më i madh nga ai i pesëvjeçarit të tretë.

Regjimit zogollian, që për 15 vjet me radhë nuk ndërtoi veçse burgje për popullin dhe poste për xhandarmërinë, do t'i duheshin jo më pak se 850 vjet për të kryer ndërtimet e këtyre 27 vjetëve të realizuara vetëm nga ndërmarrjet shtetërore. Kaq të mahnitëshme janë ritmet e zhvillimit të jetës sonë, të tilla janë hapat vigane të Shqipërisë punëtore, që llërëpërveshur marshon fitimtare në rrugën e socializmit. Këto ndërtime të panumërta e të shumëllojta hapën për urbanistikën dhe arkitekturën tonë rrugën e gjerë e të pafund të zhvillimit e të përparimit. Ato krijuan për arkitektët dhe urbanistët tanë një fushë të gjërë veprimi, mundësinë për një krijimtari të pasur me projektimin e qyteteve, të qendrave të banuara dhe të veprave të ndryshme, dhe në një masë të atillë që as mund të ëndërrohej më parë.

Ndërtimi socialist i vendit shtroi përpara urbanistëve dhe arkitektëve detyra të mëdha e të vështira për t'iu përgjegjur me kohë ritmit të shpejtë të ndërtimit me vepra të denja, të cilat të plotësonin jo vetëm kërkesat e kohës, por dhe të perspektivës, me vepra në të cilat qëllimi funksional jo vetëm të arrihej në përputhje me zhvillimin e jetës sonë të re, por në të njëjtën kohë të shprehej përmes formash harmonike të afta për të zbukuruar vendin e banimit, të punës, të mësimit e të pushimit, në qytetin e në fshatin, në mënyrë që njerëzit të fitonin kënaqësi estetike e të edukoheshin me shije të lartë artistike. Sot ne jemi larg ndërtimeve të kryera pa kritere të vërteta shkencore siç ndodhte para kësaj. Shoqëria jonë socialiste krijoi kushtet materiale dhe na mësoi e na mëson dita ditës të mbajmë një qëndrim shumë ekzigjent ndaj ndërtimeve, të kemi kërkesa shumë të përparuara ndaj urbanistikës, të kërkojmë rrugë të reja dhe përherë e më të përsosura për arkitekturën, të dimë të kombinojmë në bazë kriteresh shkencore e artistike cilësitë e ndërtimeve tona të shumta. Të gjitha këto dëshmojnë për një zhvillim e lulëzim të dukshëm të mendimit tonë ur-

banistik e arkitektural, i cili, ndonëse i ri, e ka treguar veten të fuqishëm në kontributin për ndërtimin e qyteteve tona të reja, me krijimin e fizionomisë së re socialiste të qendrave tona të banuara. Arkitektët e urbanistët janë përpjekur dhe përpiqen ta mishërojnë me sukses në krijimet e tyre frymën revolucionare të filozofisë sonë marksiste-leniniste, hovin optimist të jetës tonë të re. Në këtë rrugë urbanistika dhe arkitektura jonë e re kanë arritur një tok suksesesh. Ato, në fakt, u formuan nëpërmjet kësaj rruge duke përcaktuar gjithnjë e më qartë tiparet e tyre karakteristike. Sot janë të panumërta veprat dinjitoze të ndërtuara apo që janë në ndërtim e sipër në të gjitha anët e vendit si shumë banesa të bukura në Shkodër, Laç, Durrës, Tiranë, Korçë, Elbasan, Lushnjë, Çorovodë, Fier, etj., të projektuara nga Ibrahim Prushi, Miço Pepa, Vlash Goga, Petraq Kolevica, Mauricio Bega, Sami Pashallari, Fatbardha Daja, Kostandin Mona, spitalet në Tiranë dhe Pogradec të Skënder Luarasit dhe Mërgim Çanos, hoteli në Sarandë i Anton Lufit, Shtëpia Qëndrore e Ushtrisë Popullore në Tiranë e Koço Mihos, kinemaja dhe hoteli në Elbasan të Valentina Pistolit, Shkolla e Partisë në Tiranë, hotel pensioni në Fier, hotel turizmi në Korçë të Koço Çomit, shtëpia e kulturës në Rëshen i Bujar Ferës, spitali në Vlorë i Adem Stërmasit, hoteli dhe banesat në Krujë të Haxhi Subashit, stadiumi i lojrave me dorë në Fier i Kosta Çomorës, hoteli i turizmit në Shkodër i Niko Titkës e Albert Shanit, Komiteti i Partisë dhe kinemaja në Berat të Faik Idrizit, komplekset e konvikteve të Universitetit dhe Vorrezat e dëshmorëve në Tiranë të Besim Dajës, Enver Fajës, Vasilika Cickos, Ilia Papanikollës e Robert Kotes, mjaft vepra industriale nga Kostaq Saatçiu e Pandeli Borova, shumë plane rregulluese e studime pjesore të Misto Meles, Zija Fterës, Ketii Qanos, Rustem Myteveliut, Faik Alimehmetit e Agim Shehut e shumë e shumë të tjera. Në to kemi një larmi të pasur formash, përgjithësisht të thjeshta, por të kompozuar me shijë e shprehi të pasur arkitektonike që e bëjnë secilën të tingëllojë me origjinalitet.

Një kujdes i veçantë është treguar për planet rregulluese, të cilat në fazën e projekt-idesë janë hartuar për të gjitha qytetet e vendit. Ato u bënë një mbështetje e mirë për disiplinimin e ndërtimeve dhe për vendosjen e tyre në mënyrë harmonike, ato hodhën themelet e transformimit të qyteteve, e zhvillimit të tyre mbi baza të shëndosha shkencore e shoqërore, në mënyrë që ato të merrnin përherë e më tepër tipare të reja socialiste dhe të çe-



leshin perspektivat për një zhvillim dhe shtrirje të mëtejshme të harmonizuar të ndërtimeve. Krahas zgjidhjes së shumë problemeve të ndërlikuara siç është ai i zonifikimit funksional, i lëvizjes e qarkullimit, i futjes së organizuar të gjelbërimit etj. ato përcaktuan edhe organizimin kompozicional estetik të hapsirave duke krijuar shumë komplekse dhe ansamble të goditura.

Hartimi i planeve rregulluese, pamvarësisht nga mungesat a të metat, duhet vlerësuar pa dyshim si një sukses i dukshëm i urbanistikës sonë të re. Përpunimi i tyre i mëtejshëm me anë studimesh të pjesëshëm për shumë zona, lagje a qendra qytetesh, qe një tjetër hap i rëndësishëm në fushën e krijimtarisë urbanistike, që përcaktoi më mirë organizimin e hapësirave e të volumeve. Nuk ka dyshim se të gjitha këto janë sot një mbështetje e mirë në studimin e mëtejshëm për zhvillimin e qyteteve tona.

Pa dashur të zgjatemi më tej në sukseset e arritura, duhet të themi se planet rregulluese e studimet e pjesëshme, me gjithë përpjekjet e mëdha të kryera, nuk arritën dot kurdoherë t'i përgjigjen si duhet dhe në kohë volumit të madh dhe ritmit të shpejtë të ndërtimeve. Për këtë arsye mjaft vepra u ndërtuan pa studimet përkatëse urbanistike, shumë plane rregulluese nuk u shoqëruan kurdoherë me studime të thelluara të pjesëshme duke i lënë shteg vendosjes spontane, volumeve monotone, pa kërkime të mjaftueshme për organizimin estetik të hapësirës, për arritjen e një fizionomie të përcaktuar qartë për çdo qytet a zonë në përputhje me madhësinë, kushtet klimatike, ambjentin natyral dhe reliefin.

Këto detyra me kaq përgjegjësi kanë qenë dhe janë veçanërisht të rënda po të kemi parasysh nga ana tjetër numrin shumë të pakët të urbanistëve dhe arkitektëve që kemi patur dhe që kemi edhe sot.

Çdo plan rregullues mbështetet në të dhënat mbi perspektivën e zhvillimit të qytetit. Këto të dhëna hartohen nga komitetet ekzekutive në bashkëpunim me dikasteret qëndrore. Është e qartë se ky është një problem tepër i vështirë e delikat. Megjithatë, duhet të themi se organet përkatëse në rreth e në qendër duhet të preokupohen e të shqetësohen shumë më tepër për të hartuar programe me të dhëna sa më të plota mbi zhvillimin perspektiv të qyteteve. Mungesat e këtyre të dhënave të thelluara më një anë, ritmet shumë të larta të përparimit tonë, nga ana tjetër, kanë bërë që parashikimet 15-vjeçare të shumë planeve rregulluese si ai i Beratit, Tiranës, Vlorës, Elbasanit etj. të tejkalohen brenda 5-10 vjet. Kështu,

p.sh., Tirana e tejkaloi që më 1967 numrin e popullatës, që, simbas të dhënave të planit rregullues, duhej ta arrinte më 1973. Po të kemi parasysh edhe rritjen e volumit të ndërtimit, s'është e vështirë të kuptohet gjendja e koklavitur e krijuar për çeljen e fronteve të punës, gjëndje që çoi edhe në një sërë të metash e gabimesh. Këto të meta bien në sy, në radhë të parë, në vendosjen e godinave me rrjesht, pa ide kompozicionale, pa marrë parasysh lidhjen e tyre të përshtatëshme me terenin, pa shfrytëzuar në maksimum trojet e ndërtimit, siç ka ndodhur, p.sh., me banesat në rrugën Bajram Curri në Tiranë, siç ka ndodhur me depot dhe banesat në hyrje të Beratit, me banesat dykatëshe në dalje të Fierit për në Vlorë, me banesat njëkatëshe dhe depot në hyrje dhe dalje të Lushnjes, me depot në hyrje të Shkodrës e në shumë qendra të tjera. Ca më keq qëndron puna kur komitetet ekzekutive, në vend që të luftojnë më mirë për zbatimin e plotë të planit rregullues apo për plotësimin e tij me studime të mëtejshme, të shtyrë vetëm nga nevoja imediate e duke harruar perspektivën, i vendosin godinat «ku ka vende bosh» dhe jo në vendin e duhur, duke shkelur kështu planin rregullues, siç ndodhi, p.sh., në Laç me vendosjen e furrave të bukës e të lavanderisë në Tiranë me vendosjen e restorantit «Vollga», godinës pranë hotel «Tiranës», etj. Të gjitha këto janë një pengesë serioze për zhvillimin e harmonishëm të ndërtimeve të mëtejshme. Është rasti të theksojmë se urbanistika jonë nuk mund dhe nuk duhet të lejojë dëshirat thjesht subjektive në vendosjen e objekteve, por shtrirjen e tyre të harmonizuar në bazën e studimeve shkencore dhe më shumë duhet të dëgjohet në rrethe mendimi i specialistëve, urbanistëve dhe arkitektëve, që të mos bëhen gabime të tilla si vendosja e autoparkut mbrapa vorrezave të dëshmorëve në Pogradec, e Komitetit të Partisë në Shkodër etj.

Duhet pohuar se urbanistët dhe arkitektët tanë nuk arritën, në dy vitet e para, t'i përgjigjen si duhet me studimet përkatëse aksionit të madh të ndërtimit të banesave me kontribut vullnetar. Për këtë arsye, një pjesë e mirë e këtyre godinave, për mos të thënë shumica, u krye në të ashtuquajturat «vende boshe» brenda lagjeve të banuara dhe shumë herë u bënë ndërtime edhe pranë rrugëve duke krijuar kështu pengesë për ndërtimet e mëvonëshme. Ndërsa ka dhe shokë, si ata të Laçit, të cilët edhe pse kanë një studim të plotë urbanistik për qytetin e tyre të ri, e shkelin atë duke i vendosur banesat në një terren të papërshtatshëm, pa u përpjekur që krahas zgji-



dhjes së problemit të strehimit dhe edukimit klasor revolucionar të masave me metodën e aksionit, të arrihet dhe zbulurimi e jo dëmtimi i qytetit.

Shembulli i Elbasanit në përqëndrimin e banesave mbi bazën e studimeve komplekse në formën e kuartalleve, që u ndoq e po ndiqet dhe nga Tirana, Durrësi, Fieri, Vlora, Berati e shumë qytete të tjerë tregon për vlerësimin e drejtë që i është bërë, krahas të tjerave, edhe detyrës që ndërtesat me kontribut vullnetar të ndihmojnë në zbulimin e qytetit.

Gjëndja e krijuar dhe zhvillimi edhe më i vrullshëm i ndërtimeve në pesëvjeçarin që filluan këtë vit shtron detyrën e zgjerimit të studimeve urbanistike në qendër e në rrethe për t'u dalë përpara ndërtimeve masive që do të kryhen, në mënyrë që ato të kryhen simbas planeve të plota e skicave të planeve rregulluese e studimeve të tjera. Kjo do të bënte të shmangeshin shumë gabime. Studimet duhet të kenë në themel një larmi të pasur idesh kompozicionale, ato duhet të mbështeten dhe të çfrytëzohen sa më drejt kushtet konkrete klimaterike dhe të relievit, të cilët, nga ana e tyre, do të diktojnë zgjidhje të ndryshme.

Është koha për të treguar një kujdes më të madh për ndërtimet e harmonizuara edhe në fshat, për të cilat Partia ka dhënë orientime e porosi të veçanta. Edhe në fshat ritmi i ndërtimit është tepër i lartë. Në pesëvjeçarin që kaloi atje u ndërtuan mesatarisht 8500 godina në vit, d.m.th. 3000 godina në vit më shumë se në pesëvjeçarin e tretë.

Elementet e rinj të ndërtimeve në fshat: volumi i tyre i madh, grumbullimi në qendra të caktuara dhe tendencat e ndërtimeve me më shumë se një kat diktojnë nevojën e ngutëshme për një ndihmë më të gjerë, që edhe ato të zhvillohen të harmonizuara, mbi bazën e studimeve urbanistike, që të jenë sa më komode dhe të bukura.

Theksojmë këtu në mënyrë të veçantë idenë kompozicionale mbasi ajo përbën burimin kryesor për të zbuluar të gjitha rezervat në krijimin e komponimit e formave më të larmishme të shprehjes arkitektonike. Dobia kryesore e shumë planeve rregulluese dhe e studimeve të pjesëshme qëndron pikërisht në përdorimin e pak skemave kompozicionale, të cilat dëndur përsëriten nga një vend në tjetrin duke krijuar kështu monotoni, që forcohet edhe më tepër nga volumet monotone të vetë godinave. Në këtë drejtim ka edhe shembuj që mund të për-

menden për mirë. Duke kaluar nga blloku «50 vjetori» te blloku «Partizani» në Tiranë si dhe nga studimet për Cërrikun e Prrenjasin te ato për Laçin, Kuksin, Ballshin, Vlorën etj., shohim qartë përparimet në zgjerimin e ideve kompozicionale. Ato i hetojmë edhe në studimet e pjesëshme brenda një qyteti si, p.sh., nga lagja Nr. 1 në atë Nr. 2 të Laçit, vemë re përpjekje të mira për t'u larguar nga skemat e thata, nga vendosja rrjesht e godinave pa mendim e ide të pasur kompozicionale dhe pa zbuluar e arritur të bukurën që duhet të na komunikojë kompleksi urbanistiko-arkitektonik. Kështu, megjithëse lagja Nr. 1 e Laçit u ngrit krejt e re e, pra, pa pengesat e ndërtimeve ekzistuese, me të cilat ndeshemi në qytetet e tjerë e që kanë detyruar shumë herë vendosjen e godinave në rrjesht gjatë një brezi të ngushtë, ajo u ndërtua me parime të vjetëruara, duke krijuar një mur të rëndë që fsheh ndërtimet e kryera mbrapa dhe krijon oborre të mbyllur e pa farë bukurie. Për fat të keq lagja Nr. 1 e Laçit nuk është e vetme. Këto shëmbuj dëshmojnë se vendosje të tilla, të thata, pa mendim të qartë, pa ide kompozicionale dhe pa përdorimin e të gjitha mjeteve të ndryshme të shprehjes arkitektonike në dobi të një zgjidhjeje të pasur plastike, ishin bërë një koncept dominues, koncept që frenonte fantazinë dhe pengonte që të krijoheshin mënyra dhe forma të tjera e të panumërta, të cilat do të ishin të afta të ndihmonin më mirë në arritjen e organizimit më estetik të planit dhe hapësirës.

Në lagjen Nr. 2 të Laçit, në studimet e planeve rregulluese të Ballshit, Kuksit, Vlorës si dhe në mjaft studime të pjesëshme urbanistike vërejmë përparime në zhvillimin e konceptimit dhe të organizimit urbanistik të kuartalleve e qendrave, përdorimin e një game më të gjërë të kompozicioneve të volumeve, çfrytëzimin më të mirë të shumë mjeteve të shprehjes arkitektonike. Kjo gjë u bë e mundur, në radhë të parë, nga një kuptim dhe vlerësim më i mirë i gjëndjes, nga shtimi i përpjekjeve për të gjetur zgjidhje të larmishme kompozicionale si dhe nga largimi prej vendosjes perimetrale, prej konceptimit të thjeshtëzuar të volumeve të vetë godinave, konceptim që jo vetëm nuk krijon dhe nuk organizon kushte të mira banimi, por përkundrazi i bën ato të rënda e monotone.

Këto përparime të krijimtarisë urbanistike janë veçanërisht të dukshme sidomos në studimin e zhvillimit të qytetit të Vlorës, në zonën e skelës dhe të Ujit të Ftohtë. Këtu gjejmë një konceptim të pastër dhe modern të kuartallit të banimit, tepër funksional, të orientuar e të aj-



rosur mirë. Duke iu larguar nënshtrimit të rrugës në vendosjen e godinave gjatë saj, me pak tema volumesh, por duke manovruar në shtrirjet dhe lartësitë e tyre, janë arritur variacione të shumta kompozicionale, të cilat janë të ndryshme dhe, nga ana tjetër, kanë një tingëllim të përbashkët e të harmonishëm, duke çelur pamje të bukura e të ndryshme gjatë lëvizjes nëpër shetitoren bregdetare dhe në brendi të kuartalleve. Vlera të tilla të hijshme e të bukura të organizimit të hapësirës i gjejmë edhe në lagjen Nr. 2 të Laçit, ku me tre tema volumesh është arritur një kompozim i pasur e mjaft shprehës. Edhe blloku «Partizani» në Tiranë shquhet për konceptim të qartë dhe zgjidhje të bukur nga që, nëpërmjet vendosjes së lirë të ndërtesave ndaj rrugës, duke i dhënë precedencë orientimit më të mirë, vetëm me dy tipe godinash të thjeshta, por me plastikë të pasur e kontrast të bukur dritë e hije, është arritur një kompozim i pastër, me tingull të veçantë, që krijon panorama plot variacione. Vlerat estetike të këtij kuartalli do të qenë edhe më të mëdha po të që shmangur monotonia e lartësive; kjo do ta shtonte edhe më shumë kënaqësinë që të komunikon i tërë kompleksi.

Është rasti të theksojmë këtu mungesën e kryerjes së sistemimeve që aq shumë i dëmton kuartallet dhe veprat e veçanta e që i bën ato, sidoqë të mbaruara, të duken ende si karabina e të mos plotësojnë si duhet funksionin dhe qëllimin e tyre estetik. Kjo gjë e ka burimin në mosvlerësimin e sistemimeve dhe shumë herë në qëndrimet e gabuara, kur çdo gjë pritët të kryhet nga shteti, në një kohë kur për një pjesë të madhe të sistemimeve mund të kontribuojnë fare mirë vetë masat punonjëse. Ndryshe s'ka si ta spjegojmë, p.sh., faktin që në spitalin e Sarandës, i cili është në çfrytëzim prej dy vjetësh, nuk është mbjellur as edhe një pemë. Po kështu ndodh dhe në mjaft kuartalle banimi si në bllokun «50 vjetori», në kompleksin e rrugës «Myslim Shyri» në Tiranë e gjetkë.

Krahas monotonisë së vendosjes dhe të volumeve, monotonia e lartësive përbën sot për ndërtimet tona një problem që duhet të na tërheqë vëmëndjen. Ky problem duhet të zgjidhet në mënyrë të larmishme edhe me lartësi të përshtatëshme, mbasi, siç dihet, ai përbën një nga elementët e rëndësishëm të kompozicionit urbanistik dhe arkitektonik. Loja e volumeve dhe e lartësive, aq e nevojshme për të zhdukur sëmundjen e monotonisë, duhet të përdoret më drejt nga urbanistët dhe arkitektët tanë në të gjithë larminë e variacioneve të shumta për të rritur

forcën e efektit estetik të ndërtimeve tona. Për këtë është e nevojshme të tërheqim vëmëndjen në dy faktorë kryesorë — në atë të përdorimit të lartësisë optimale e të theksimit të volumeve si elemente të rëndësishëm kompozicionalë dhe në atë të shtrirjes së ndërtimeve edhe në zona me pjerrësi, ç'ka është më ekonomike për kursimin e tokës bujqësore, ndërsa nga ana tjetër krijon kushte shumë më të përshtatëshme funksionale dhe për variacione në kompozimin e volumeve e të lartësive.

Përgjithësisht qytetet tona kanë shtrirje të madhe në raport me popullsinë e tyre. Kjo gjë ka qenë kushtëzuar së pari nga ekzistenca e pjesëshme e lagjeve me ndërtime të ulta dhe, nga ana tjetër, nga që ndërtimet e reja nuk kanë mbajtur kurdoherë parasysh çfrytëzimin më racional të trojeve të ndërtimit nëpërmjet ndërtimesh të larta. Ky problem është shqetësonjës sidomos për qytetet si Tirana, Shkodra, Korça, Durrësi, Elbasani, Fieri, Berati, Vlora etj., të cilët janë zhvilluar shumë dhe, në të ardhmen do të kenë zhvillim edhe më të madh. Kufizimi i shtrirjes së tyre, për të kursyer tokën, si dhe për shkurtimin e shpenzimeve të shumta për rrugët, ujësjellësat, kanalizimet, mirëmbajtjen komunale, transportin, sistemit, ndriçimin etj. nëpërmjet rritjes së dëndësisë, me anë të ndërtimeve më të larta dhe mbi bazën e kompozimeve urbanistike, edhe të theksimeve të lartësive në pika e zona të veçanta, në raport, të arësyeshem me larësinë mesatare të ndërtimeve të tjera të qytetit, gjë që do të ndihmonte, nga ana tjetër, edhe për t'u dhënë qyteteve një fizionomi më tërheqëse e të përcaktuar, përbën sot një nga detyrat imediate të urbanistikës sonë për t'u bërë ballë ndërtimeve të ardhshme. Urbanistika duhet t'i paraprijë arkitekturës dhe ndërtimit, dhe duke e hedhur vështrimin tutje në perspektivë, me anë studimesh të thelluara, duhet të jetojë që sot me të ardhmen, në mënyrë që ndërtimet tona t'i qëndrojnë sa më mirë kohës. Ajo duhet të vështrojë kurdoherë përpara, duke shfrytëzuar në këtë mes edhe përvojën e fituar nga puna e madhe e gjertanishme. Realiteti na tregon se jeta tek ne ecën me vrull përpara, me ritme të mahnitëshme, shumë herë edhe më shpejt se sa parashikimet tona. Pak vjet më parë ne kemi ndërtuar më 2 e 3 kate, më pak me 4 dhe 5 kate. Ndërtime të tilla tani janë bërë fare të zakonëshme edhe për qytetet e vogla. Sot godinat pesëkatëshe, për mungesë të ashensorëve, të hekurit e të çimentos, por edhe si pasojë e qëndrimit nënvleftësues ndaj mundësive dhe aftësive të ndërtimit, janë bërë limiti i ndërtimeve tona. Por cili



do të jetë vallë limiti i lartësive për qytetet tona këtu e mbas dhjetë pesëmbëdhjetë vjetëve? Ky është një problem i rëndësishëm që duhet studjuar dhe parashikuar qysh sot nga urbanistët, ndërtuesit dhe ekonomistët tanë.

Ndërtimet më të larta do të sjellin një notë të re në tingullin e arkitekturës së qyteteve tona ashtu sikurse e sjellin atë sot disa godina të veçanta me gjashtë dhe shtatë kate në Tiranë, Korçë, Elbasan, Fier apo hotelet që po ndërtohen në Korçë, Sarandë, Shkodër e Elbasan.

Në përcaktimin e një fizionomie më të qartë për pamjen në kompleks të qyteteve tona, do të ndihmonte së tepërmi edhe çfrytëzimi për ndërtim i tokave me pjerrësi si dhe lidhja e mirë, organike e godinave me terrenin, me natyrën rrethonjëse.

Ndërtimet në terrene të pjerrta dhe lidhja e tyre e mirë me reliefin përbën një faktor të rëndësishëm në krijimin e kompozimeve të larmishme urbanistiko-arkitektonike. Ato japin mundësi për më shumë variacione të lartësive, të cilat diktohen nga vetë terreni dhe ndihmojnë që qyteti të jetë më i bukur, jo vetëm në pamjen e tij të përgjithshme, por edhe në brendi.

Megjithatë, duhet të pranojmë se urbanistët e arkitektët tanë, të nxitur edhe nga porositisit e ndërtuesit, janë prirur përgjithësisht drejt ndërtimeve në terrene të rrafshta duke iu shmangur tokave të pjerrta të përshtatëshme për ndërtim gjë që i ka sjellë dhe i sjell dëme jo vetëm ekonomisë, duke qenë se zihen për ndërtim toka bujqësore, por edhe arkitekturës, sepse, i privon qytetet nga pamje më të bukura dhe nga fizionomitë më të veçanta e të përcaktuara qartë që ato mund të marrin ndryshe nga njëri tjetri. Vështirësitë e organizimit të ndërtimit apo shpenzimet për sistemime, që ngrihen e hiperbolizohen në këto raste, u kundërvihen pa të drejtë shumë përfitimeve që ka qyteti i vendosur edhe në terrene të pjerrta, në kodra të bukura, të cilat ndodhen thajse rrëzë çdo qyteti të vendit tonë malor. Kjo prirje është kthyer thajse në metodë pune, aq sa edhe kur ndërtojmë në kodër, e rrafshojmë atë duke dëmtuar natyrën dhe duke e bërë ndërtesën disi të huaj për vendin ku qëndron dhe ambjentin që e rrethon (siç ka ndodhur me spitalin në Çorovodë) ose i vendosim godinat duke futur pjesë të tyre në gjermime të thella a duke i nxjerrë me xokolatura tepër të larta ndërsa ato duhet të ndjekin terrenin, t'i përshtaten e të lidhen mirë me të. Një punë e tillë domosdo kërkon zgjidhje dinamike e plot variacion të vOLUMEVE që i japin qytetit hijeshi të veçanta. Në këtë drej-

tim, pa tjetër, ka edhe shembuj të mirë siç është kompleksi i konvikteve të Universitetit në Tiranë, tre kullat në hyrje të Gjirokastrës, apo ndërtimi i disa banesave në Çorovodë. Në to gjejmë përpjekje të mira nga ana e arkitektit. Suksesi bie menjëherë në sy: zgjidhja funksionale është arritur plotësisht, godinat kanë orientim të mirë, ato lidhen bukur me terrenin, e ndjekin atë duke i dhënë qytetit a pjesës së tij një pamje shumë tërheqëse e me tipare tepër dallonjëse. Megjithatë, bashkë me pak të tjerë këta janë shembuj të shkëputur. Në shumicën e rasteve, ndërtimet në qytetet që ndodhen në pjerrësi janë trajtuar si në toka të rrafshta. Në shumë qytete, tendencat e zhvillimit të mëtejshëm janë drejtuar përgjithësisht nga fushat. Kështu, Tirana po zhvillohet më shumë nga jugë-perëndimi, d.m.th. drejt fushës dhe shumë pak ose aspak drejt kodrave të bukura të lindjes, rrëzë Dajtit. Kështu po ndodh edhe me Lushnjën, Pogradecin, Beratit e me mjaft qytete të tjerë. Durrësi, p.sh., është futur e po ndërton në tokat e ish kënetës, me shpenzime të mëdha për themelet, duke iu larguar kodrave, pjesëve të tyre të shëndosha e jo rrëshqitëse, që do t'i jepnin qytetit një pamje më të bukur në sfondin e një dekori piktoresk.

Edhe në studimin urbanistik të Laçit, të këtij qyteti krejtësisht të ri, kodrat në lindje, të bukura e shumë të lehta për ndërtim, ose nuk janë parashikuar të ndërtohen ose u janë lënë ndërtimeve vetiake, kryesisht njëkateshe. Ato pak godina të ndërtuara në teren pak të pjerrët, në të djathtë të unazës, duke çfrytëzuar reliefin, kanë dalë me plastikë të pasur, e me ato pak lëvizje në lartësi që ka diktuar terreni, i kanë dhënë qytetit një pamje më të hijshme. Po të vazhdohej me to dhe më lart kodrës, s'ka dyshim që kjo jo vetëm do të ishte më funksionale, mbasi godinat do të ajroseshin më mirë dhe para tyre do të hapej panorama e bukur e fushës gjer në Adriatik, por edhe më ekonomike, mbasi do të kursehej toka e bukës. Nga ana tjetër, ato do t'i jepnin qytetit një pamje edhe më të bukur; ai do t'i çfaqej vizitorit me një fizionomi më të plotë e me lëvizje dinamike e, në të njëjtën kohë, nga brenda kuartalleve do të krijoheshin aspekte më të këndëshme. Edhe në studimin e zonës së skelës dhe të Ujit të Ftohtë në Vlorë, studim që shquhet për vlerat e tij në organizimin e ansambleve të bukura, me silueta tërheqëse e me funksion të qartë, vërejmë megjithatë një largim nga kodrat piktoreske, që, po të mbulohehin me ndërtime, do t'i jepnin qytetit një pamje të veçantë, si nga shetitorja anës detit ashtu dhe gjatë lë-



vizjes nëpër brendësi të kuartalleve të banimit. Atë që ne përpiqemi ta arrijmë me aq vështirësi në terrenet e rrafshata — lojën e volumeve dinamike e të harmonishme — terreni i pjerrët na e lehtëson duke i dhënë qytetit një pamje karakteristike. Për këtë arsye ne, urbanistët dhe arkitektët, duhet ta kthejmë më shumë vështirimin drejt kodrave e terreneve të pjerrëta, të shtojmë përpjekjet për t'i lidhur godinat me natyrën dhe reljefin në mënyrë sa më të përsosur e të ndriçuar nga frymëzimi krijues, duke çfrytëzuar më mirë mundësitë e gjëra që ka krijuar sistemi ynë socialist, të rritim nivelin e mjeshtërisë sonë duke zbuluar të gjitha rezervat e artit arkitektonik e duke i vënë ato në shërbim të plotë të ndërtimit në terrene kodrinore që do t'u japin vlera të reja estetike qyteteve tona.

Në qoftë se, siç u tha, me disa përjashtime të ralla, ne i kemi vlerësuar dhe çfrytëzuar pak ose aspak kushtet e favorëshme që na ofron terreni për arritjen e variacioneve të ndryshme, po ashtu pak ose aspak ne kemi ditur të çfrytëzojmë kushtet e ndryshme klimaterike për realizimet tona arkitekturale. Prandaj, dhe në këtë aspekt, ne ndërtojmë thujtë njësoj, pa vlerësuar dhe përdorur me mjeshtëri kushtet klimaterike dhe materialet lokale, qoftë në qytete të mëdhenj apo të vegjël, qoftë me klimë të ngrohtë a me klimë të ftohtë. Erërat e forta të Tepelehtës, tufanet me dëborë të Pukës, klima e butë e Sarandës dhe Vlorës, ajo kontinentale e theksuar e Pukës e kështu me radhë duhet të na kishin diktuar në mos zgjidhje krejtësisht të veçanta, të paktën disa tipare karakteristike, të cilat ne ende nuk i kemi arritur në krijimet tona.

Kjo vlen të thuhet gjithashtu edhe për veprat e reja industriale, ku mjetet e shprehjes janë të tjera e duhet të diktojnë zgjidhje më tipike për një arkitekturë industriale, më të harmonishme, në mënyrë që edhe këto vepra të jenë, në natyrën e vet, të bukura, si në pamjen e përgjithshme ashtu dhe në interiëret e tyre.

Të gjitha këto pakujdesi s'ka si të mos shtojnë monotoninë, këtë të keqe për të cilën urbanistëve dhe arkitektëve u janë bërë shumë kritika, sepse ajo nuk u jep njerëzve atë kënaqësi estetike, që ata kërkojnë nga arkitektura.

Në hotelin që po ndërtohet në qytetin malor të Pukës dhe në mjaft godina për qendrat minerale malore, shohim përpjekje për të realizuar disa forma arkitektonike, vërtet ende në zhvillim, por tipike për qytete të kësaj natyre; këto forma lidhen mirë me kushtet klimaterike,

me materialet rrethore dhe krijojnë një karakteristike dallonjëse në pamjen e përgjithshme të qytetit. Dhe kjo është një fushë e gjërë ku arkitektët kanë shumë për të bërë; ajo kërkon jo vetëm nivel më të lartë, pregtitje dhe fantazi të larmishme, krijonjëse, por edhe një punë më këmbëngulëse studimore, krijimin e kushteve të përshtatshme për njohjen deri në hollësitë më të vogla, të të gjitha veçorive karakteristike lokale si përsa i përket klimës ashtu dhe për sa u përket materialeve dhe teknikës së ndërtimit. Arkitektura e qyteteve me klimë të fortë kërkon përdorimin e një sërë mjeteve të tjera shprehëse, ashtu sikurse kërkojnë masa të tjera për mbrojtjen nga era, nga dielli etj. Duke i njohur dhe përdorur me mjeshtëri këto mjete e masa, arkitektët duhet të vënë më shumë në lëvizje mendjen dhe talentin e tyre për të gjetur rrugë të reja e mjete të ndryshme shprehëse arkitektonike që të jenë të thjeshta e në të njejtën kohë me vlerë të larta artistike.

Duke vështruar atë që kemi bërë gjer më sot, në krijimtarinë arkitektonike nuk është vështirë të dallojmë dy tendenca — edhe ndërlikimin e tepruar të formave e të elementëve arkitektonikë jashtë shkallës dhe kërkesave estetike të veprës, edhe tendencën tjetër — më të përhapur — forma e kompozimeve tepër skematike, të thata që nuk u komunikojnë dot njerëzve atë kënaqësi estetike e ngrohtësi që duhet t'u japë atyre arkitektura.

Principet e kompozimit urbanistik dhe arkitektonik si edhe elementët me të cilët arrihen variacionet e tij nuk janë dhe s'ka si të jenë të njëjlojta për qytete me madhësi të ndryshme, me kushte klimaterike të ndryshme, ashtu si nuk janë dhe nuk mund të jenë të njëjlojta dhe për vepra me madhësi e të llojeve të ndryshme. Ndjenja e masës dhe e shkallës e, për pasojë, trajtimi arkitektonik i veçantë për vepra të një kategorie, por me përmasa të ndryshme, përbën një element të rëndësishëm, që duhet të përdoret me vend dhe mjeshtëri për të mos rënë në lëvizje të tepruar të volumeve dhe në përdorimin e shumë lloj elementëve që nuk përmbushin më detyrën e tyre e bëhen shqetësorë, siç ka ndodhur me godinën e vogël të Institutit të Kërkimeve Minerale në Tiranë. Në këtë godinë është vështirë të gjesh dy dritare të njëjlojta, nga ana tjetër thyerjet, hyrje-daljet e tepëruara të volumeve janë pa asnjë kërkesë funksionale, të pajustificuara edhe nga ana estetike, sepse ato në masën e përdorur e bëjnë veprën tepër shqetësorë. Kështu ndodh edhe me banesën pranë Hotel Krimesë në Korçë me ato forma aq të



ndërlikuara e arkaike, me disa ndërtime në Gosë të Kavajës kur vërejmë imitacione formash në miniaturë e deri edhe në mjaftë qoshe, ku duket mania për t'i dhënë forma sa më të ndërlikuara. Kjo mani, megjithëse në një masë më të vogël, ka lënë gjurmët e saj edhe në disa vepra që përgjithësisht kanë vlera kompozicionale si shtëpitë e kulturës në Çorovodë e në lagjen «Çlirimi» në Berat e në disa ndërtime në Institutin Bujqësor në Kamëz.

Ndjenja e masës dhe e shkallës, përdorimi i kursyer e logjik i elementëve arkitektonikë dhe i lojës së dritës është i domosdoshëm aq sa lypset për t'i dhënë veprës tingëllimin e duhur, që përgjithësisht duhet të jetë i thjeshtë e i pastër, në mënyrë që ajo të shprehë më drejt funksionin e saj, të komunikojë kënaqësi estetike e të mos ngjallë asnjë shqetësim.

Është rasti të theksojmë se edhe përdorimi i ngjyrës, si element i rëndësishëm i shprehjes arkitektonike që ndihmon për të perceptuar më mirë të bukurën në arkitekturë, duhet të shikohet me kujdes të veçantë nga arkitekti si pjesë përbërëse e idesë kompozicionale. Ngjyrat bëhen edhe ato shqetësuese kur nuk përdoren me vend siç ka ndodhur me banesën në P.T.T. e në disa banesa të tjera në Korçë dhe në një godinë në Berat, ku ngjyrat e përdorura me shumicë e pa vend dhe në trajta që nuk përputhen me idenë kompozicionale dhe me tektonikën e veprave, nuk i kanë ndihmuar, por i kanë dëmtuar pamjet e tyre.

Ato që përmendëm përbëjnë vetëm disa përjashtime, por të mjaftueshme për të nxjerrë prej tyre mësim për të përmirësuar më tej punën për një përdorim më të drejtë e logjik të formave dhe ngjyrave në arkitekturën tonë.

Edhe më e dëmshme është tendenca tjetër që e ndeshim më shpesh kur hasim forma tepër skematike, të tharta, pa mendim dhe pa kërkime kompozicionale. Këtë tendencë e shohim në shumë godina e sidomos në ato të banimit, që mbushin qytetet tona. Një prirje e tillë i sjell dëm të madh arkitekturës sonë, sepse banesat janë lloji dominues i ndërtimeve që kryhen në qytete, me këto ndërtesa thuret qyteti, ato përcaktojnë në masën më të madhe edhe fytyrën e tij. Për këtë arsye kemi të bëjmë këtu me një dobësi serioze të arkitekturës sonë që e ka burimin në shumë faktorë të ndryshëm e, në radhë të parë, në boshllëqet e mëdha të nivelit profesional të arkitektëve, në volumin tepër të madh të punës që ata janë të detyruar të përballojnë për shkak të numrit shumë të pakët, në kushtet më të përshtatëshme që duhet t'u krijohen aty-

re dhe në një vlerësim më të drejtë të krijimtarisë arkitektonike, në kuptimin dhe përdorimin me vend të tipizimit si dhe në disa koncepte e qëndrime ndaj problemeve estetike dhe të bukurës në arkitekturë.

Secili nga arkitektët tanë projektton në të njëjtën kohë disa vepra, gjë që u le shteg zgjidhjeve skematike të shpejtuara e të pa arritura, e që bëhet pengesë për një punë më të thelluar në secilën prej tyre, për zgjidhje më funksionale, më ekonomike e të shprehura me forma më të bukura. Nga ana tjetër, kjo ka penguar e pengon punën sistematike për ngritjen e mjeshtërisë dhe për specializimin e arkitektëve. Lloji dhe madhësia e veprave që ndërtohen tek ne është zgjeruar kaq shumë sa specializimi për grupe veprash të afërta e për probleme të veçanta si akustika, anedamenti etj. del si një detyrë e ngutëshme dhe tepër e nevojshme për njohjen me themel të funksionit të veprës si dhe për gjetjen e formave më të përshtatëshme, më ekonomike dhe më estetike të shprehjes së tyre. Mungesa e theksuar që ndjehet për arkitektë e urbanistë u ka lënë shteg edhe disa veprimeve të tjera të dëmshme që vijnë gjithashtu edhe nga që problemi nuk kuptohet dhe vlerësohet drejt. Nuk janë të rralla rastet kur projektet e zbatuara në një qytet merren dhe zbatohen edhe në vende të tjera pa asnjë kriter krijues, në kushte krejt të ndryshme. Kështu, rrethimi i bukur i shkollës së Partisë në Tiranë ka marrë rrugët. Atë e gjejmë edhe në sektorin e Saukut të fermës «Gjergj Dimitrov», edhe në qytetin e Kavajës, edhe në kooperativën e Novoselës e ndoshta edhe në vende të tjera. Kopja e shtëpisë së kulturës së Çorovodës po ndërtohet nga shokët e Pukës pa asnië përpunim tjetër edhe në Fush Arëz. Shumë banesa të vecanta të ndërtuara në Tiranë, Laç, Fier, Korçë i gjen të përsëritura edhe në Elbasan, Durrës, Shkodër, deri edhe në qytetet e vegjël, pa zënë në gojë këtu përsëritjen e po atyre ndërtesave brenda një qyteti. Të gjitha këto s'ka si të mos e shtojnë monotoninë që e ka burimin gjithashtu edhe te mjaft dobësi të krijimtarisë arkitektonike, te mosçfrytëzimi si duhet i të gjithë elementëve të ndryshëm kompozicionalë si dhe nga përdorimi pa kriter i projekteve tip.

Një fenomen i tillë ushqehet, në radhë të parë, nga qëndrimet jo korekte të porositësve, të cilët nuk preokupohen të porositin në kohë hartimin e projekteve sipas të dhënave përkatëse për ndërtimet që do të kryejnë. Çështja lihet gjithnjë për në fund, kur për hir të sigurimit të frontit të punës dhe që të mos «digjen fondet», nuk mbetet



rrugëdalje tjetër veçse të mirren projektet që janë zbatuar një herë në një tjetër vend. Në të tilla veprime duken qartë qëndrimet e gabuara, burokratike e nënvleftësuese ndaj së bukurës në arkitekturë.

Nga ana tjetër, monotonia ushqehet edhe nga tipizimi dhe standartizimi, i cili, krahas anëve pozitive, bart në vetvete edhe farën e uniformitetit. Kjo kontradiktë e brendëshme e tipizimit duhet të zgjidhet nga arkitektët dhe inxhinierët tanë nëpërmjet një pune të madhe, të vazhdueshme dhe këmbëngulëse.

Tipizimi dhe standartizimi është jo një qëllim, por mjet që ndihmon industrializimin e ndërtimit, mekanizimin dhe shpejtimin e ritmit të punimeve, prandaj ai përbën një domosdoshmëri në kushtet dhe detyrat e mëdha të ndërtimit që duhet të zgjerohet edhe më tej, kryesisht në tipizimin dhe standartizimin e elementëve dhe pjesëve. Por ndoshta ne jemi përhapur më tej caqeve të domosdoshme duke tipizuar edhe të tërën, d.m.th. godinat dhe këtu fjalën e kemi kryesisht te banesat, shkollat, kopshtet e çerdhet e fëmijëve. Dihet se kjo përbën një burim të theksuar të monotonisë. Për ta luftuar atë më mirë, veç të tjerash, ndoshta është e nevojshme të shihet më me kujdes shtrirja e tipizimit dhe, për godinat që u përmëndën, të hartohen zgjidhje të veçanta në përputhje me gabaritet dhe elementët e standartizuar dhe të normativave të projektimit.

Ndërtimet krejtësisht të industrializuara që do të nisnin së shpejti shtrojnë me urgjencë detyrën e studimit të thelluar e të gjithanshëm të projekteve të tyre për të shmangur sa më shumë monotoninë që mund të shkaktojnë ato.

Veç kësaj, nga ngarkesa e madhe që kanë arkitektët, studimi funksional dhe estetik i detajuar i interierëve të ndërtesave tona ka mbetur një fushë thuajse ende e pashkelur. Interieri në vija të përgjithëshme përcaktohet së bashku me konceptimin e tërë veprës, por studimi i tij i hollësishëm, aq i nevojshëm për të krijuar ambjente sa më funksionale dhe të mobiluara e të organizuara bukur, kërkon jo vetëm mjeshtëri e shije të hollë, por edhe më tepër kohë, e cila, në të shumtën e herës, në kushtet e ngarkesës së madhe, u mungon arkitektëve tanë. Ndaj dhe krijimet e arkitektëve tanë vuajnë nga interieret skematike, që nuk ndihmojnë sa duhet për një funksion sa më të përsosur, ku të jetë studjuar me imtësi çfrytëzimi sa më racional i çdo centimetri dhe jo vetëm i dyshemesë, por edhe i mureve, që ato t'i përgjigjen organizimit më të mirë të procesit të jetës që zhvillohet në to dhe që,

nga ana tjetër, të jenë sa më të bukur. Kjo përbën pa dyshim një nga boshllëqet kryesore të arkitekturës sonë, sepse studimi i hollësishëm i interierëve është i lidhur ngushtë me funksionin e veprës, me qëllimin për të cilin shoqëria jonë socialiste i ndërton këto vepra, me krijimin e kushteve sa më të përshtatëshme, komode dhe të bukura për banimin, punën, mësimin, pushimin e punonjësve si dhe me shfrytëzimin racional të sipërfaqes së ndërtimit, me prodhimin e vendosjen e mobiljeve dhe orendive sa më funksionale, estetike dhe ekonomike si mjete të rëndësishme për arritjen e qëllimeve që përmenden më lart.

Praktika e gjertanishme, kur mobiljet dhe orenditë projektohen e prodhohen nga ndërmarrjet përkatëse, jashtë përmasave dhe kompozimit të ambjenteve ku ato do të vendosen, s'ka si të mos e dëmtojë krijimin e interierëve më komode, më racionale dhe më estetike. Universiteti ynë do të nxjerrë këtë vit kontigjentin e parë të arkitektëve. Kjo është një ngjarje e rëndësishme për arkitekturën tonë. Ky gjak i ri, nevoja e ngutëshme për të cilin është ndërjerë e mprehtë vite më parë, duke u formuar e kalitur më tej në punën e madhe projektuese do ta gjallërojë atë dhe do të krijojë më shumë mundësi për një krijimtari më të thelluar e me një nivel më të lartë teknik dhe artistik.

Efektet estetike të arkitekturës janë të lidhura ngushtë edhe me materialet me të cilat realizohet vepra e veçanërisht me materialet dekorative për punimet përfundimtare.

Guri, ky material aq i vjetër ndërtimi dhe aq i bollshëm e i ndryshëm te ne, duhet të gjejë më shumë vend në ndërtimet tona, sidomos si material dekorativ e i qëndrueshëm, duke u përdorur me mjeshtëri e në trajta të larmishme siç është vepruar në mjaft ndërtime të Gjirokastrës e Sarandës, në pallatin e kulturës, në pallatin e rinisë, në pallatin e sportit e në mauzoleumin në Durrës, ku është përdorur bukur në formën e veshjes si mozaik, në hyrjet e rrethimit të shkollës së partisë në Tiranë ku përdorimi i tij është i gjetur plot dritë hije e plastikë të pasur. Ashtu si për gurin, arkitektët tanë duhet të përpigën më shumë edhe për përdorimin origjinal të mjaft materialeve të tjera natyrale ose të atyre që prodhohen apo mund të prodhohen nga industria jonë.

Në disa banesa të ndërtuara në Laç me tulla silikate, përmes kombinimit të tyre të harmonishëm, me pjesët e suvatuara është arritur një efekt i këndshëm arkitekto-



nik. Kjo është një nga rrugët që duhet zhvilluar më tej e që duhet pasuruar edhe me përdorimin më të gjërë të materialeve të tjera për të zbuluar kështu më shumë aftësitë estetike të godinave. E të mos veprohet si në mjaft ndërtesa të tjera me tulla silikate në Tiranë e gjetkë, ku nuk bien në sy përpjekje të tilla e ndërtesat kanë dalë të zbeta, me një bardhësi të përhime e tepër monotone. Nga ana tjetër, duhet thënë gjithashtu se industria jonë e prodhimit të materialeve dekorative, me gjithë zhvillimin e gjertanishëm, ka mbetur më prapa nevojave që kanë sot ndërtimet tona. Gama ende e vogël e materialeve dekorative kufizon punën krijuese të arkitektëve, në përpjekjet për t'u dhënë veprave më tepër individualitet, jo vetëm nëpërmjet larmisë së kompozimeve dhe formave, por dhe të materialeve që i shprehin ato. Pllakat majolike me forma e faktura të ndryshme, me dhe pa gllazurë, mozaikët me qeramikë, me qelq, gurë natyral, pllakat e xhamit të ngjyrosur e shumë të tjera si këto që mund të prodhohen në vend, do t'i ndihmojnë arkitektët, po të përdoren me mjeshtëri, që të krijojnë vepra më të bukura, më të qëndrueshme nga pikpamja e paraqitjes së sipërfaqëve, për të zhdukur njëherë e përgjithmonë atë sëmundje të rëndë të fasadave të njollosura që aq shumë e dëmton pamjen e qyteteve tona.

Veç kësaj, arkitektura jonë mund dhe duhet t'u lerë vend në faqet e saj arteve figurative të aplikuara e, në unitet me ta, të rritë forcën e saj edukative, të shprehë edhe më qartë madhështinë e epokës që po jetojmë nën udhëheqjen e ndritur të Partisë. Hapat e para që dëshmojnë për aftësitë e piktorëve, skulptorëve dhe arkitektëve tanë janë hedhur në shumë monumente, lapidare e pllaka përkujtimore të ngritura sidomos në kuadrin e 25-vjetorit të çlirimit. Ka ardhur koha dhe janë të gjitha mundësitë që ky bashkëpunim të shtrihet edhe në vepra të tjera e sidomos në ato social-kulturale, që ndërtohen kryesisht në qendrat e qyteteve e kanë një frekuentim masiv, si edhe në komplekset industriale ku punon klasa jonë punëtore. Kjo do t'i afrojë artet e aplikuara me masat e do ta shtojë ndikimin e tyre ideologjik dhe edukativ klasor. Nga ana tjetër, kjo gjë do ta ndihmojë arkitekturën të bëhet më shprehëse. Rruga për realizimin e kësaj sinteze midis arkitekturës dhe arteve figurative të aplikuara mund të gjëndet, nga njera anë, me përpjekjet për ta kuptuar atë si një nevojë të kohës dhe, nga ana tjetër, me disa masa konkrete për të forcuar bashkëpunimin e arkitektëve me piktorët dhe skulptorët në krijimin e ba-

zës materiale, për të arritur një larmi më të madhe të teknikës së arteve të aplikuara duke filluar së pari nga krijimi dhe vendosja e këtyre veprave në ato objekte që i presin ato prej kohësh.

Sigurisht gjykimi mbi vlerat funksionale dhe estetike të një vepre mund të jepet i plotë vetëm kur ajo është ndërtuar. Krijimtaria arkitektonike është vetëm një pjesë e kësaj pune, fillimi, pjesa përcaktonjëse dhe vendimtare në gjetjen e zgjidhjeve sa më të goditura. Megjithatë, projekti s'është veçse një ide, një mendim i shprehur grafikisht në një plan, në letër. Ai shndërrohet në vepër materiale, në tre dimensionet e hapsirës, vetëm në sajë të punës së punëtorëve dhe mjeshtërive të ndërtimit, dhe jo vetëm të këtyre, por edhe të prodhuesve të materialeve të ndërtimit e të mjaft kolektivave të tjera. Në këtë fazë pune, arkitektët dhe urbanistët bashkë me kolegët e tjerë projektues kanë detyra të rëndësishme në mënyrë që vepra e projektuar bukur edhe të ndërtohet e tillë, mbasi populli shikon dhe përdor veprën e përfunduar e jo projektin e saj. Prandaj ata duhet ta ndjekin punën në të gjitha fazat, të luftojnë për zbatimin e saj të plotë e me cilësi të lartë, të bëjnë plotësimet përkatëse dhe të mësojnë nga përvoja e pasur e ndërtuesve, të dëgjojnë me vëmendje dhe të mësojnë nga vrejtitet, sugjerimet, kritikant dhe përvoja e pasur e punëtorëve dhe mjeshtërive të mrekullueshëm të ndërtimit, të cilët me duart e tyre të arta kanë zbatuar vepra të shumta e aq të bukura. Por është e nevojshme të theksojmë gjithashtu se kjo kërkon më shumë përpjekje nga zbatuesit qëllimi i të cilëve nuk është dhe s'duhet të jetë vetëm përfundimi i veprës, por ndërtimi i saj më i mirë, sa më i plotë dhe me materiale e cilësi të mira e të mos ndodhë që ata, në vend që ta plotësojnë projektin, ta dëmtojnë atë, duke eliminuar e shkurtuar në forma mekanike nën pretekstin e kursimit e të mungesës së materialeve pjesë të tij, ca më tepër kur këto bëhen pa e përfillur projektuesin dhe porositesin. Në këtë fazë, sikurse edhe gjatë hartimit të projektit, një detyrë të rëndësishme kanë porositesit. Shumë shembuj, e në mënyrë të veçantë ndërtimi i Shkollës së Partisë në Tiranë, na mësojnë edhe një herë se që një ndërtim të kryhet bukur dhe me cilësi të mirë, krahas projektit të bukur dhe punës së lavdërueshme të zbatimit, kërkon edhe ndihmën, kujdesin e përpjekjet këmbëngulëse të porositesit, luftën e tij për të arritur atë çka i duhet, një vepër që të plotësojë më së miri qëllimin funksional për të cilin ndërtohet, një vepër me vlerë të



dukëshme estetike. Nga kjo përvojë e mirë mund të përfitojnë shumë porositës, të cilët mjaftohen vetëm me hartimin e projekt-detyrës, parashikojnë fonde gjysmake, nuk luftojnë bashkë me projektuesit dhe zbatuesit për sigurimin e materialeve përkatëse dhe për cilësi të lartë, por qëndrojnë sehirxhinj, në pritje për të marrë çelsat e ndërtesës.

Por burimin kryesor për mjaft dobësi të arkitekturës sonë duhet ta kërkojmë edhe në disa qëndrime të gabuara ndaj anës estetike, e cila konsiderohet disa herë jo si element i domosdoshëm i arkitekturës, por si një diçka e veçantë, që mund ose jo ta shoqërojë atë. Një konceptim i tillë i gabuar motivohet me prioritetin e funksionit dhe me faktorët ekonomikë.

Është e vërtetë se qëllimi për të cilin ngrihen shumica absolute e veprave të arkitekturës, është krijimi i kushteve të caktuara për një qëllim utilitar. Prandaj edhe përqëndrohet pikërisht këtu kërkimi kryesor arkitektonik duke përdorur konstruksione të logjikshme që përbëjnë mjetin me të cilin arrihet funksioni dhe sigurohet qëndrueshmëria e veprës. Por këto të dyja arrihen me elementë që në të njëjtën kohë ushtrojnë edhe efekt estetik, kur forma e tyre i nënshtrohet krijimtarisë së frymëzuar arkitektonike.

Në përshëndetjen e Komitetit Qëndror të P.P.SH. drejtuar Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve me rastin e 25-vjetorit të themelimit të saj, thuhet: «Me shëllirë e ka ngjyer kafshatën në të kaluarën populli ynë, por pjatën e drunjatë e kish të skalitur si s'ka më bukur». Me dashurinë e tij të madhe për artin popullit ynë i ka dhënë kurdoherë formë të bukur çdo elementi funksional. Këtë e gjejmë të shprehur edhe në ndërtimet që kemi trashëguar, ku spikat dashuria e veçantë për artin dhe shija e hollë artistike e popullit. Çdo element funksional në të është trajtuar me formë të bukur, mbasi mjetet me të cilat arrihet e bukura në arkitekturë nuk janë elementë të veçantë të jashtëm, të shtuar, por janë po ata elementë funksionalë që, të lidhur organikisht me veprën dhe të trajtuar me mjeshtëri, e bëjnë atë të shprehet me proporcione dhe forma të harmonishme, të bukura, duke e kuptuar të bukurën jo si një teprim, por si një domosdoshmëri. Në vazhdim të kësaj tradite të pasur, arkitektura jonë e sotme duhet edhe ajo të jetë e bukur, por natyrisht me kuptimin që kemi ne sot për të bukurën dhe me mjete të tjera, të kohës. Arkitektura jonë e re do të shprehë dhe ajo epokën tonë shoqërore, ideologjinë tonë, zhvillimin

tonë ekonomik dhe teknik. Si kulturë materiale, edhe si art ku materialet dhe teknika e ndërtimit kanë një rol përcaktonjës për format e saj, ajo ecën në një hap me zhvillimin dhe përparimin shkencor dhe material, në një hap me kohën, me kërkesat e shoqërisë që e lind si dhe të ritmeve të saj të zhvillimit. Prandaj për të janë kaq të huaja eklektizmi dhe anakronizmi, përsëritja e formave, të cilat kanë lindur në të tjera kushte shoqërore, me një tjetër teknikë ndërtimi, me mundësi të kufizuara materiale. Trashëgimia jonë në lëmin e arkitekturës përbën një thesar të vyer që duhet ta ruajmë me kujdesin më të madh, por jo ta imitojmë, për të mos përsëritur kështu ato gabime që kemi bërë. Ne duhet të mësojmë nga ajo atë çka ruan vlera për kushtet e sotme, çka na shërben në punën tonë krijuese dhe kjo ka të bëjë, në radhë të parë, me filozofinë e saj, me atë që mjeshtri popullor, me intuitën e tij, me njohjen e thellë të kërkesave, mundësive dhe me ndjenjën e tij të hollë artistike ka arritur në një zgjidhje të përsosur të funksionit, në një çfrytëzim tepër racional të sipërfaqes, në përdorimin e materialeve më të përshtatëshme dhe të gjitha këto në një unitet organik, të trajtuar me forma të bukura. Ne kemi ç'të mësojmë nga të parët tanë edhe lidhur me çfrytëzimin e goditur dhe tepër racional të zonave të pjerrta, për lidhjen e shkëlqyer të godinave me reliefin. Për qytete si Gjirokastra dhe Berat, që kanë patur një fizionomi tepër tipike dhe të formuar, detyra jonë është që, me ndërtimet tona, pa i kopjuar ato (dhe kjo as që mund të kuptohet për godina me një tjetër funksion që ndërtojmë ne) të mos e prishim, por ta plotësojmë më tej pamjen e tyre. Këto janë detyra që kërkojnë shumë mund dhe arkitektët tanë duhet të ndihmohen në këtë drejtim me më shumë studime nga ana e Institutit të monumenteve të kulturës dhe ai i Histori-Gjuhësisë.

Në këtë aspekt ne kemi ç'të mësojmë dhe duhet të marrim dhe nga arkitektura e vendeve të tjera atë çka është më përparimtare, pozitive, e dobishme, jo me qëndrime qorre e përlulëse, por me sy kritik, duke flakur tej të keqen e tyre dhe duke përpunuar me frymë revolucionare për atë që u përshtatet kushteve dhe nevojave tona.

Zhvillimi i madh i vendit, përparimet e shkencës dhe teknikës së ndërtimit, materialet e reja që përdoren dhe ritmi i lartë i zhvillimit të punimeve na diktojnë një arkitekturë të thjeshtë e të pastër, ku efektet e bukura të arrihen jo me elemente të shtuar, që nuk lidhen organikisht, por me konceptimet kompozicionale, me lojën e vo-



lumeve e të dritë-hijes, me zbulimin dhe përdorimin racional të efekteve estetike të materialeve të ndryshme, me trajtimin estetik të elementëve të domosdoshëm funksionalë. Bukuria nuk duhet të konsiderohet si diçka që mund ose jo të jetë në të, por si një domosdoshmëri që buron nga vetë kërkesat shpirtërore të njeriut tonë.

Shoku Enver, duke folur për të bukurën në arkitekturë, në takimin me shkrimtarët dhe artistët, ka thënë: «...ndërtimet tona, qytetet, fshatrat, banesat, institucionet shoqërore, kulturele, parqet etj. të jenë sa më të bukura ku të kënaqen dhe të edukojnë shijen artistike njerzit tanë...».

Kënaqësia estetike dhe edukimi i shijes artistike nëpërmjet arkitekturës ka një rëndësi të dorës së parë, sepse njerzit kudo dhe kurdoherë janë në kontakt të vazhdueshëm me të, nuk mund t'i shmangen, sepse ajo përbën vetë ambientin material, në të cilin ata punojnë dhe jetojnë. Lidhur me këtë plenumi XV i K.Q. të P.P.SH. mbi letërsinë dhe artet, në Tetor 1965 theksonte: «...përpara artit në kuptimin e ngushtë të fjalës është ajo, arkitektura, që ushtron ndikimin estetik të parë e të pashmangshëm tek masat. Ngado që të shkojmë, do të ndeshemi me ndërtesat, ansamblet e ndryshme, parqet e lulishtet, monumentet bile edhe me vetrinat e magazinave. Të gjitha këto nuk ka se si të mos ndikojnë në edukimin estetik të bashkëqytetarëve tanë».

Kërkesat estetike që shtrohen para arkitekturës sonë përmbahen pra në vetë esencën e saj, ndaj ato nuk mund të injorohen as të nënvleftësohen përkundrejt faktorëve të tjerë.

Faktori ekonomik nuk mund dhe s'ka se si të shndërrohet në arkitekturë në një qëllim në vetvete. Ai s'ka si të mos shihet në raport të drejtë e logjik me të gjitha anët e arkitekturës dhe jo vetëm për nevojat imediate, por për një kohë sa më të largët, sepse i tillë është dhe destinimi i veprave të arkitekturës. Ato ndërtohen për një kohë shumë të gjatë dhe do të qëndrojnë atje ku i vendosim dhe ashtu si i vendosim, i zgjidhim e i ndërtojmë duke e zbukuruar ose duke e shëmtuar qytetin.

Shumë shembuj të praktikës sonë tregojnë qartë se veprat që dhe nga ana estetike nuk i qëndrojnë kohës, nuk mund të jenë ekonomike. Por disa prej tyre, në rrugët e sheshet kryesore të qyteteve, po bëhen që tani për-pjekje me shumë shpenzime për t'i transformuar në forma estetike si, p.sh., banesat në rrugën «Qemal Hysenaj» në Fier, fasada nga sheshi të teatrit «Çajupi» në Korçë etj.

Sigurisht arkitektura jonë ka ende shumë për të bërë për të gjetur më mirë rrugën më rationale duke flakur tej ndonjë teprim që nuk e justifikon veten, për të ndër-tuar më shumë, më shpejt, më lirë dhe më mirë e më bukur, por është e nevojshme që ajo edhe të ndihmohet më shumë në këto rrugë kërkimi dhe arkitektëve t'u krijo-hen kushte më të përshtatshme për një krijimtari më të thelluar. Fjalën e kemi te konceptet dhe qëndrimet e gabuara që kërkesat estetike të arkitekturës i njëjsojnë me mbishpenzimet. Në të kundërtën, çdo teprim arkitektonik, çdo mbishpenzim i paarsyeshëm është i huaj për të. Arkitektura jonë duhet të jetë e thjeshtë, duke kuptuar me këtë fjalë të bukurën.

Shumë herë përshtypja e mbishpenzimeve krijohet artificialisht nga qëndrimet burokratike të porositësve, të cilët, pa asnjë llogari të saktë, i coptojnë fondet në shumë vepra përgjithësisht nën kërkesat reale për ndërtimin e veprës, gjë që e vështirëson së tepërmi punën e arkitek-tëve, duke i prerë rrugën studimit dhe zgjidhjes së plotë e të gjithanëshme, duke shkaktuar disa herë edhe shkurt-time mekanike, që e bëjnë veprën të mos i qëndrojë kohës e të «vjetërohet» shumë shpejt. Ndoshta është më e udhës që t'u priten rrugët këtyre veprimeve, që të plani-fikohen për ndërtim veprat më të domosdoshme, simbas mundësive ose me faza, duke i caktuar fondet për një sërë veprash, e sidomos për ato social-kulturalet që janë unika-le, kanë karakter edukativ e frekuentim masiv, mbi bazën e studimit të projektit dhe jo para tij, në mënyrë që ajo që ndërtojmë sot të plotësojë më së miri kërkesat që i vihen e t'i qëndrojë sa më gjatë kohës, përparimit të vrull-shëm të jetës sonë. Për këtë shoku Enver ka porositur: «Ne do të bëhemi «pishman» si i thonë fjalës dhe brezat e ardhshëm do të na kritikojnë në qoftë se nuk mendojmë dhe punojmë që ato që ndërtojmë dhe prodhojmë sot të jenë të tilla jo vetëm sa për të plotësuar nevojat imedia-te, por të kënaqim dhe shijen, dhe jo vetëm të brezave të sotëm, por dhe të atyre të ardhshëm».

Arkitektura dhe urbanistika jonë duhet ta hedhin larg, shumë larg vështrimin e tyre, ashtu siç porosit udhë-heqësi ynë i dashur. Në këtë raport është e udhës të shi-kohen të gjithë faktorët e arkitekturës, duke përfshirë dhe ato ekonomike.

Në përmbushjen e detyrave të mëdha që ka përpara, tani që arkitektura jonë ndodhet në rrugën e mbarë drejt një faze të re pjekurie, kur ajo, si të themi, po përcakton edhe më qartë tiparet e saj dalluese, do të ndihmonte



së tepërmi edhe kritika arkitektonike, e cila tek ne në fakt nuk ekziston. Është koha sot dhe janë të gjitha mundësitë që ajo të krijohet për ta shpënë përpara mendimin arkitektonik shqiptar e platformën e saj teorike në përshtatje me kushtet dhe kërkesat tona konkrete. Për këtë është i nevojshëm botimi i më shumë artikujve, studimeve, organizimi i më shumë diskutimeve duke tërhequr mendimin e gjërë jo vetëm të arkitektëve, konstruktorëve dhe ndërtesuesve, por dhe të njerëzve të artit e të kulturës, të masave të gjëra të punonjësve siç ka filluar gazeta «Drita», revista «Ylli» etj.

Këtij qëllimi i shërben edhe takimi ynë i parë i këtij lloji për krijimtarinë arkitektonike.

Pa pretenduar se u prekën këtu të gjitha problemet e shumta të urbanistikës dhe arkitekturës, u përpoqëm të përqëndrohemi në disa më kryesoret, që me siguri do të thellohen edhe më tej nga diskutimet. Nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve dhe analizës kritike të punës sonë, ne do të qartësojmë më mirë detyrat e urbanistëve dhe arkitektëve dhe jo vetëm të tyre, por edhe të porositësve, ndërtesuesve, prodhuesve të materialeve të ndërtimit, për të rritur kërkesat ndaj punës sonë, për të rritur nivelin tonë profesional, për të luftuar më mirë konceptet edhe qëndrimet që e frenojnë arkitekturën në përparimin e saj më të shpejtë e më të guximshëm dhe arkitektët për një krijimtari më të pasur e më të larmishme, që arkitektura jonë t'u përgjigjet më mirë dhe me një nivel më të lartë teknik dhe artistik detyrave madhështore aktuale dhe të perspektivës në ndërtimin e vrullshëm socialist të vendit tonë. Të gjitha këto kërkojnë gjithashtu që diskutimet dhe debatet për problemet e veçanta, në forma të ndryshme, duke tërhequr më shumë mendimin e gjërë të specialistëve dhe të vetë punonjësve, të vazhdoen edhe më tej, ashtu siç porosit shoku Enver që «organet e projektimit, p.sh., në planet e tyre të udhëhiqen jo vetëm nga kuotat financiare e normat e caktuara teknike, por duke u mbështetur në to të organizojnë sa më shumë konsultime në mes tyre dhe me studjuesit dhe njerëzit e krijimtarisë, me ekzekutuesit, arkitektët bile dhe me vetë punonjësit, intelektualët, gratë, të rinjtë etj. në mënyrë që ndërtimet tona, qytetet, fshatrat, banesat, institucionet shoqërore kulturore, parqet, etj të jenë sa më të bukura...».

Arkitektët tanë, së bashku me shokët e tyre të specialiteteve të ndryshme, si një repart luftarak që rriti dhe edukoi partia, do të venë të gjitha aftësitë krijuese për të përballuar detyrat madhështore të pesëvjeçarit të pestë që

do të aprovojë kongresi VI i Partisë, i cili do të mbledhet në jubileun e lavdishëm të 30-vjetorit të themelimit të saj, detyrat për të ngritur krijimtarinë arkitektonike në një shkallë edhe më të lartë, për të krijuar vepra të denja për madhësinë e epokës sonë, vepra që të plotësojnë më së miri qëllimin e tyre funksional, të arritur me mjete të thjeshta, por me një larmi të pasur idesh kompozicionale, që të ndihmojnë për ta bërë edhe më të bukur jetën e njerëzve tanë, në përputhje jo vetëm me mundësitë e sotme, por dhe me kërkesat e të ardhmes së ndritur drejt së cilës marshon fitimtar populli ynë i udhëhequr me unitet nga partia e shoku Enver.



## NGA DISKUTIMET

MISTO MELE

### Urbanistika dhe kultura

Urbanistika është problem kulture, para se me qenë problem teknik. Disa gabime, që janë bërë e bëhen, e kanë pikërisht burimin këtu. Duke mos u thelluar në njohjen e vlerave të kulturës materiale dhe historike që ruhen në qytetet tona, në ansamblet me vlerë arkitekturale, në bukurinë e siluetit dhe të natyrës për rreth, në historikun e zhvillimit simbas kohës së pjesëve përbërëse të qytetit dhe për mungesë të bashkërendimit të të gjitha këtyre me kërkesat e reja të zhvillimit të ndërtimeve tona sot mund të biem në gabime që shpesh janë të pandreqëshme.

Shoku Enver, në maj të vitit 1969, duke folur para popullit të qytetit të Gjirokastrës, dha një sërë këshillash e porosish për të ruajtur vlerat e kulturës materiale të këtij qyteti. Ndër të tjera, ai tha: «Të tregoni kujdes të madh për të ruajtur e zbukuruar më tej këtë qytet, që është një ansambël i mrekullueshëm arkitektural i ndërtuar me mjeshteri nga të parët tanë, nga muratorët e gurëgdhendësit e talentuar...».

Duke e parë me sy kritik zhvillimin e ndërtimeve në qytetin e Gjirokastrës e me radhë edhe në qytetet e tjera, na duhet të nxjerrim një mësim të madh dhe pikërisht atë që të thellohem shumë në studimin, në njohjen dhe zbërthimin e problemeve të shumta me karakter historik, shoqëror ideo-artistik për të bashkërenduar pastaj në mënyrë krijuese ndërtimet e vjetra me të rejat, për të gjetur gjuhën e përbashkët ndërmjet tyre. Por mos vallë me këtë punë duhet të merren vetëm arkitektët dhe urbanistët? Këtu dalin një sërë detyrash edhe për punonjësit e artit e të kulturës, historianët dhe studjuesit e kul-

turës materiale që ruhen në qytetet e qendrat e banuara të vendit tonë.

Nga vlerësimi që mund t'u bëhet ndërtimeve tona në qytetin e Gjirokastrës del se aty në këto vitet e fundit vërehen përpjekje për të gjetur rrugën nëpër të cilën duhet të ecin ndërtimet e reja brenda dhe jashtë qytetit muze dhe disa përpjekje të përbashkëta të specialistëve të I.SH.P. dhe të I.M.K. gjatë hartimit të planit rregullues dhe zonifikimit të qendrës historike që i kanë çelur rrugën zhvillimit më të drejtë të ndërtimeve në këtë qytet muze të një bukurie të rrallë. Por ndërtimet e bëra në periudhën e parë mbas çlirimit, sidomos ato të zonës ekonomike gjatë rrugës kombëtare, depot pranë pazarit, ndërtimet e reja në lagjen Palorto e në qafën e pazarit, pengojnë, janë të huaja e dëmtojnë bukurinë e ansambleve ku janë ndërtuar.

Edhe në qytetin e Beratit, megjithëse ndërtimet e reja të ndërtuara jashtë janë të veçuara nga lagjet rreth kalasë, volumi i pagjetur i Shtëpisë së kulturës dhe kuartallet masive të ndërtuara me banesa të vendosura në formë perimetrale, vijnë në kontrast e janë larg që të harmonizohen me ansamblin e bukur të lagjes Mangalem, me të cilën soditen bashkarisht nga rrugët kryesore të qytetit.

Në qytetin e Korçës, me zhvillimin e ndërtimeve në zonën e pazarit, u rrezikuan të prisheshin ndërtime që kanë vlerë arkitekturale dhe historike. U desh ndërhyrja nga lart që të merreshin masat e nevojshme për studimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre. Dhe kjo detyrë duhet të zgjidhet në bashkëpunim me I.M.K. edhe për të gjitha qytetet e tjera që ruajnë vlera të ngjashme.

Por ne jemi të mendimit se në këtë çështje nuk duhet të ketë tepërime, se nuk duhet të ruajmë nga e kaluara gjithshka për hir të moshës.

Ne duhet të rindërtojmë qytetet tona duke shfrytëzuar në maksimum trojet e lira dhe ato që duhet të lirohen nga ndërtimet e vjetra e pa vlerë.

Në qytetin e Tepelenës zhvillimi i ndërtimeve në një rryp gjatë rrugës kryesore nga ana e Vjosës ka dëmton rëndë zhvillimin e drejtë të ansamblit të qytetit. Ato ndërtime mbyllin pamjen e luginës së Vjosës dhe të vargmalit për karshi, janë në kontrast të keq me kalanë e vjetër dhe e kanë kthyer rrugën kryesore të qytetit në një rrugë të zakonshme.

A nuk do të sillte pra ky trajtim urbanistik i kësaj



rruge një notë të re në qytet, në fytyrën e tij, në kompozimin e tij, gjë që nuk përsëritet tek ndonjë qytet tjetër?

Pra, bashkërendimi dhe nxjerrja në pah e vlerave natyrale, krijimi i mashtabit, i madhësive të volumeve të qyteteve dhe qendrave të banuara simbas madhësisë së tyre dhe kushteve natyrale ka rëndësi të veçantë në formimin e figurës artistike tipike për secilin qytet, që urbanistët e arkitektët duhet ta mbajnë gjithmonë parasysh në krijimtarinë e tyre, veçanërisht në konditat e vendit tonë me relief të thyer e me bukuri të rrallë.

Në qytetin e Pogradecit, gjatë rrugës kryesore që kalon anash liqenit, ndërtime (të bëra kryesisht para çlirimit) mbyllin si një mur pamjen e liqenit piktoresk. Por edhe disa ndërtime të bëra gjatë kësaj rruge, me format e fhjeshësuara dhe të vendosura në një rrjesht, nuk kanë krijuar atë lidhje të domosdoshme të ansambleve të lagjeve të banuara deri në brendësitë e qytetit me hapësirën e liqenit. Kjo do të sillte një notë të re, do të ishte tipike për këtë qytet. Në studimet e viteve të fundit dhe në studimet e reja që do të bëhen, këta faktorë duhet të mbahen parasysh.

Më mirë janë trajtuar ansamblet e reja me volumet e ndërtesave 3-4 katëshe në qytetet e Skraparit dhe të Librazhdit. Ato qëndrojnë e lidhen mirë me faqet e kodrave mbi të cilat ngrihen dhe kanë përcaktuar drejt fytyrën e këtyre qyteteve. Por më duket e tepëruar dhe pa vend ndërtesa 6-katëshe që u transportua mekanikisht në Rrëshen. Këtu nuk ka lidhje të anës funksionale me siluetin e rritur në lartësi që nuk i shkon një qyteti të vogël si Rrësheni.

Në disa qytete vërehen edhe disa gabime në vendosjen e ndërtimeve për arsye të mosthellimit në studime paraprake. Po japim disa shembuj: Në Tiranë, në zonën e parkut të madh, janë lejuar të bëhen ndërtime që janë në kundërshtim me planin rregullues dhe që dëmtojnë rëndë pamjen e qytetit nga kjo anë. Ato krijojnë një mur të shëmtuar që mbyll pamjen e bukur të Tiranës nga kodra. Në Korçë, ndërtimi i shkollës mbi kodrën karshi stadiumit, ka mbyllur pamjen e bukur që hapej në zonën kodrinore nga shëtitoret kryesore e qytetit. Ndërtime të një dhe dykatëshe të ndërtuara këto kohët e fundit në hyrjen e qytetit të Beratit nga ana e Lushnjës, tregojnë për një vendosje të shpejtuar e pa krijimtarë. Në Tiranë, në rrugën «Qemal Stafa», për vendosje të ndonjë banese janë prerë pisha të rritura gjatë disa dhjetëvjeçarëve, të cilat zbukuronin siluetin e gjelbër të qytetit.

Dhe shembuj të tillë ka mjaft për të nxjerrë mësim. Problem i rëndësishëm që do t'i hapë rrugën e gjerë krijimtarisë në ndërtimin e qyteteve është kalimi nga zgjidhjet e objekteve të veçanta, ose si të thuash «me copë», në zgjidhje ku mendimi krijues të shtrihet në komplekse të mëdha e që bashkërisht krijojnë ansamblin e madh të qytetit. Sidomos në këtë dhjetëvjeçarin e fundit janë bërë e po bëhen studime për rrugë, sheshe e lagje banimi, të cilat kanë hapur shteg për krijimin e disa ansambleve me vlerë ideoartistike. Një punë e gjerë u bë nga grupe arkitektësh e urbanistësh për disa qendra e sheshe qytetesh e veçanërisht për Tiranën. Megjithatë, në zonën e qendrës së Tiranës mendohet të bëhen ndërtime me projekte të veçuara, si rasti i ndërtesës që parashikohet të ndërtohet në rrugën «Bajram Curri», përbri hotelit «Tirana». Pa studim të plotë të bulevardit «Stalin» po ngrihet ndërtimi i ri i hotelit «Donika», ndërsa një studim i bërë vite më parë për këtë rrugë kryesore të kryeqytetit ekziston në arshivën e I.S.H.P.

## VALENTINA PISTOLI

### Kërkesat e perspektivës në qendër të vemendjes së arkitektit

Në të gjitha epokat njerëzore, tema më e rëndësishme e veprimtarisë së arkitekturës ka qenë dhe mbetet arkitektura e banesave, për vetë faktin se ajo, me masivitetin e saj, jep shprehjen themelore të qyteteve dhe vendeve të banuara. Sot, në zhvillimin socialist të vendit tonë, banesa, si një domosdoshmëri jetësore, merr një rëndësi të dorës së parë, sepse ajo plotëson një nga kërkesat më elementare dhe më të nevojshme të jetës — strehimin e popullit. Për këtë qëllim partia dhe qeveria nga pesëvjeçari në pesëvjeçar kanë investuar shuma kolosale fondesh.

Banesa është nga produktet më jetëgjatë që krijon dhe përdor njeriu. Si art, arkitektura e banesave ngjall ndjenjë emocionale tek njeriu, sepse lidhja midis tij dhe banesës është intime dhe e thellë.



Politika e vendit tonë është drejtuar në rritjen e pandërprerë të nivelit jetësor të popullit. Zhvillimi ekonomik i mëtejshëm gjithmonë e më shumë do të shpejtojë progresin shoqëror dhe teknik. Do të ndryshojë edhe jeta në familjet tona. Banuesit e ardhëshëm, të cilët do të kenë mundësi ekonomike edhe më të mira, do të kenë kërkesa më të mëdha karshi banesave. Kjo është e kuptueshme. Njohuritë tona mbi kërkesat e ardhëshme dhe mbi programet e perspektivës në hollësitë e saj nuk janë të plota. Kështu, p.sh., problemi i ngrohjes së apartamenteve dhe i gatimit të ushqimeve, që lot një rol të madh në zgjidhjen funksionale të banesës, ende nuk është zgjidhur plotësisht. Dimë se lënda e drurit do t'i lerë vendin elektrikut, gazit etj, por kur, si e qysh?

Nga ana tjetër, rritja e shkallës së përdorimit të mjeteve shoqërore të ushqimit dhe shërbimet kulturalo-jetësore do të pakësojnë së tepërmi mundin e gruas dhe të pjestarëve të tjerë të familjes, do të rrisin kohën e lirë duke krijuar kështu kushte për një ngritje të mëtejshme të nivelit kultural dhe arësivor të tyre, rrjedhimisht do të dalë i nevojshëm krijimi i një kabineti pune në apartamentet ose ndonjë gjë tjetër. Në mënyrën se si do të jetë përbërja familjare në të ardhmen, lidhur edhe me kërkesat për dhomën e ditës, të gjumit apo të punës etj., si dhe shumë probleme të tjera të tilla që nuk mund të zgjidhen pa një studim shkencor të specialistëve kompetentë, duke përfshirë këtu arkitektët, ekonomistët, sociologët etj. Këto studime shkencore, bazuar në karakterin dinamik të proceseve të jetës dhe në perspektivën e zhvillimit të shoqërisë sonë socialiste do të na ndihmonin e do të ishin baza e studimeve të apartamenteve sipas përbërjes familjare, apartamente në përshtatje me kërkesat e sotme dhe të vlefshme në një masë të mirë për kërkesat e nesërme.

Ndërtesat tona të reja shumë herë nuk kanë patur parasysh kërkesat e perspektivës dhe për këtë arsye ato janë vjetëruar në një kohë jashtëzakonisht të shkurtër. Shkaqet janë të njohura: kushtet ekonomike, materiale dhe mundësitë ndërtimore kanë qenë të tilla në kohën e ndërtimit të tyre dhe, çka është më e rëndësishmja, sepse në projektuesit, krahas apartamenteve me sipërfaqe dhe zgjidhje normale, kemi dhënë edhe apartamente të cinguar, apartamente pa depo, me kuzhina të vogla, me dhoma kaluese, me dritë indirekte të banjove etj. Këto të meta të rritjes në punën tonë të përditëshme na janë bërë mësim dhe sot, krahas luftës për banesa

sa më ekonomike, luftojnë për një utilitet sa më të madh, për ta bërë banesën sa më komode, për t'u krijuar familjeve kushte për një jetë sa më të gëzueshme që t'i mbushë zemrat e punonjësve plot gjallëri e optimizëm dhe të shtojë forcat për ndërtimin e shoqërisë sonë socialiste. Ekziston kontradita midis ekonomisë dhe kërkesave për të ardhmen. Në kushtet konkrete të sotme ne duhet të plotësojmë detyrën për të dhënë sa më shumë apartamente për popullin, për të zgjidhur strehimin në një kohë sa më të shkurtër; nga ana tjetër, të ndërtojmë apartamente të tillë që t'i përgjigjen perspektivës. Kjo është një çështje për t'u diskutuar nga të gjithë që të arrihen rrugë zgjidhjeje sa më të drejta. Mbi të gjitha, ne duhet të krijojmë bindjen tonë të plotë se apartamentet duhet t'i projektojmë dhe t'i ndërtojmë të paktën sipas kërkesave të sotme, duke patur parasysh standartin e jetës që ka krijuar rendi ynë socialist.

E një rëndësie të madhe është edhe çështja e shprehjes së jashtme arkitekturo-estetike e ndërtesave të banimit. Si pjesë përbërse dhe dominonjëse e kompozimit urbanistik ndërtesa e banimit të kohës së sotme, me volumet e saj, me lidhjen organike ndërmjet tyre, duhet të na japë ansamble arkitektonike të tilla që të hapë perspektiva të bukura në çdo shikim, që të jenë në unitet me natyrën tonë të mrekullueshme, ta pasurojnë dhe të nxjerrin në pah anët e saj, të na japë një larmi formash dhe volumesh të bukura. Shembull i mirë në këtë drejtim është zgjidhja e bllokut «Partizani», ku vendosja, volumet dhe format e banesave na tërheqin vemendjen për një zgjidhje sa origjinale aq edhe të bukur që kënaq njerëzit dhe i jep një pamje të bukur kësaj zone të kryeqytetit tonë.

Komplekset e banimit, që ndërtohen sot në Tiranë e gjetkë, janë një hap përpara përkundrejt ndërtimeve të deritanishme, qofshin këto në kompleks dhe sidomos përkundrejt ndërtimeve të shkëputura brenda kuartaleve ose në vënde boshe. Në këtë drejtim mbetet mjaft për t'u bërë, për të dhënë zgjidhje origjinale — që nuk përsëriten — që secili të veprojë me forcën e vet të së bukurës dhe madhështisë në psiqikën e banorëve. Sigurisht këto komplekse do të kërkojnë më shumë punë e mund nga ana e grupeve projektuese sesa zgjidhja e një godine të shkëputur. Në praktikën e deritanishme ka ndodhur shpesh nga moskonceptimi i drejtë i kohës së projektimit nga komitetet ekzekutive të rretheve është kërkuar zgjidhja e këtyre problemeve kaq të rëndësi-



shme në një konë jashtëzakonisht të shkurtër, gjë e cila na ka shpënë në zgjidhje të ngutëshme, skematike duke përdorur për to aftësitë e një zanatçiu të thjeshtë, pa kurrfarë krijimtarije, sikurse ka ndodhur në kompleksin e banimit me kontribut vullnetar të Pogradecit apo të ndonjë vendi tjetër, ku jo vetëm nuk kemi zgjidhje kompozicionale të banesave, por nuk është kryer kurrfarë lidhje me terrenin duke e shëmtuar kështu ambjentin. Në këto raste nuk duhet eliminuar as përgjegjësia e vetë shokëve projektues, të cilët duhet të jenë më këmbëngulës, të vlerësojnë punën, (qofshin këto me kontribut vullnetar), të bëjnë studime më të thella, në disa zgjidhje të ndryshme dhe të kërkojnë për këtë ndihmë më të madhe nga kolegët e tyre të rretheve apo të qendrës.

## KOÇO MIHO

### Të luftojmë të metat tona

Kur më takon të shikoj kalanë e Gjirokastrës, Urën e Beratit, ndërtesat e Shkodrës, Xhaminë e Tiranës, e ndonjë objekt tjetër provoj një ndjenjë respekti për mjeshtrin e panjohur që, në kushte të vështira, shumë më të vështira se çdo vend tjetër, ka ditur të ndërtojë kaq me mend, kaq me guxim, kaq mirë, kaq bukur!

Kjo nuk është një shprehje e një momenti të veçantë në gjendjen shpirtërore të njeriut. Ky është një konstatim konkret. Mjeshtrat tanë Dibranë kanë ndërtuar shumë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në gjithë Ballkanin, duke lënë pas tyre ndërtime të rëndësishme dhe një emër të madh. Por këto ishin, natyrisht lule, lule të veçanta, të shkëputura, të shpërndara në pyll, lule që nuk sollën dhe s'mund të sillnin pranverën.

Vetëm pas çlirimit, cilësitë e mëdha të mjeshtrit tonë, gjetën shpërthime, gjetën hapësirë.

Si pasojë, gjithë vendi ynë ndërroi rrënjësisht fytyrë: e bashkë me të ndryshuan edhe kushtet e jetesës së popullit tonë.

Duke përgatitur shënimet për këtë diskutim, kisha përpara volumnin e 4.të të veprave të shokut Enver. Aty

ndodhet fjala e mbajtur në komisionin e ngritur për çështjet e urbanistikës të qytetit të Tiranës, më 19 shkurt 1948. Aty, në një kuadër të përgjithshëm jepet orientimi se si duhet të jetë Tirana e ardhëshme në aspektin urbanistik.

Sot, 23 vjet pas kësaj mbledhjeje — për ne historike — duke i hedhur një shikim retrospektiv rrugës së kaluar, unë do të merrja guximin dhe me një ndjenjë të thellë respekti do të përgjigjesha: Po, shoku Enver, si pasojë e kujdesit Tuaj, e gjithë partisë sonë, me punën e palodhur të klasës punëtore e të gjithë popullit tonë, Tirana, Kryeqyteti i atdheut tonë, është bërë ashtu siç porositët ju: një kopsht i lulëzuar, një qytet i madh e i bukur.

Kombinati u ngrit në kodrat e Yzberishit, ujët erdhi nga burimet malore të Shëmrisë, rrugët ndriçohen me drita të forta, nga llambat e fabrikës së Vlorës, u ndërjuan parku i madh, ai botanik dhe zoologjik, u larguan dhe u sistemuan vorrezat, po ndërtohet madhështor Monumenti i Dëshmorëve në vendin më të lartë të qytetit, u ndërjuan me mijra apartamente, në Dajt u ngrit shtëpia e pushimit e sivjet do të ndërtohen edhe objekte të tjera, në qendër u ndërtua Pallati i madh i kulturës dhe së shpejti do të fillojë një ndërtesë tjetër: Hoteli i madh shumëkatësh.

Në procesin e gjatë të këtyre sukseseve në fushën e ndërtimeve, një meritë e veçantë — ashtu sikurse për të gjithë punonjësit tanë — bie edhe përmbi arkitektët tanë.

Duke punuar në Pallatin e madh të kulturës, duke mësuar në Shkollën e Partisë, në Klubin e Universitetit, duke u stërvitur në Pallatin e Sportit të Durrësit, duke u çlodhur në shtëpitë e pushimit të Pogradecit, duke jetuar në banesat e bukura të Korçës, Shkodrës etj. ne nuk kryejmë thjesht një proces fiziologjik. Duke parë këto ndërtime e shumë e shumë të tjera, ne emocionohemi, vihemi në kushte më të mira pune e mobilizimi, provojmë një ndjenjë optimizmi, kënaqësie, krenarie, besimi për të tashmen, për të ardhmen, për jetën vetë të atdheut tonë.

Nga kjo pikëpamje arkitektura e konceptuar dhe e zgjidhur mbi parimet e realizmit tonë socialist luan një rol të madh ideologjik në edukimin e njerëzve tanë.

E në këtë drejtim mjetet e format estetike kanë pjesën e tyre. Në këtë drejtim puna e arkitektëve tanë mendoj se duhet vlerësuar e mirë.



Por me gjithë rezultatet e padiskutueshme, megjithëse karakteristika e përgjithëshme e ndërtimeve tona është pozitive, në raport me nivelin e kërkesave të kohës, mundësive tona aktuale dhe sidomos të atyre të perspektivës, ne kemi akoma një sërë dobësish e të metash, eliminimi i të cilave përbën një nga detyrat tona më të rëndësishme.

Nga pikëpamja globale, urbanistike, e tërësisë ne kemi akoma mungesa studimesh, mungesa krijimi, monotoni për të cilat na ka kritikuar me kohë Komiteti Qëndror.

Nga pikëpamja e arkitekturës, pra e objekteve të veçanta ne kemi një farë varfërie, thjeshtime disa herë të tepëruara, mungesë volumesh, mungesë detalesh, mungesa të lidhjes me terrenin, mungesë të sistemimit.

Nga pikëpamja e urbanistikës dhe arkitekturës marrë së bashku, kemi një lëkundje të herëmbashershme në gjetjen të një harmonizmi të kërkesave të sotme me ato të prespektivës, pa e marrë akoma rrugën më të përshatshme.

Mendoj se këto të meta kanë influencuar në arritien e zgjidhjeve më të mira, janë bërë faktor që të kemi edhe raste negative, si rrugë të tëra edhe si objekte të veçanta.

Natyra e këtyre të metave është e ndryshme: ka këtu edhe arësye objektive edhe subjektive. Por unë mendoj se gabimet objektive janë më të pakta, prandaj do të guxoj të them se të metat tona në arkitekturë, kanë një karakter më shumë subjektiv.

Një pjesë e këtyre gabimeve vijnë si pasojë e mungesës së eksperiencës profesionale të arkitektit, në ndonjë rast edhe të mungesës funksionale të arkitektit, në ndonjë rast edhe të mungesës të të dhënave vetiake. Unë nuk mendoj dot që të ketë arkitekt, i cili do të dojë që vepra e tij të mos dalë e mirë, e bukur; kjo është dëshirë dhe si e tillë ajo varet nga ato që thashë. Por ka pa tjetër edhe raste nxitimesh, mosthellimi, mos tregimi kujdes e kështu me radhë. Për këto raste ka vënd për autokritikë, kritikë dhe zotime. Por këto janë gabime profesionale, gabime të rritjes, gabime që kanë mundësi të ndreqen dhe me siguri do të ndreqen.

Por ka edhe të meta të tjera, të meta konceptesh, të cilat nuk varen nga arkitekti dhe për më tepër e pengojnë atë.

Një koncept i tillë është vlerësimi i pakët që u bëhet aspekteve estetike të arkitekturës, në raport me faktorët e tjerë.

Natyrisht kundër të bukurës nuk ka se si të dilet hapur, por vihen përpara faktorë ekonomikë, industrializimi etj.

I parë më vete, problemi i kursimit është një problem i madh. 2000 vjet përpara, Vitruvi, arkitekt i madh romak, në traktatin e tij mbi arkitekturën i kushtoi asaj pasazhe të tëra. Bota 2000 vjet pas tij i kushton ekonomisë përsëri kujdes. E përsëri për shumë e shumë vjet ekonomia do të qëndrojë mbi piedestalin që meriton. Por ajo ka vendin e saj, raportin e saj, ajo s'është qëllim më vete, është një mjet që stimulon ecjen përpara.

U deshën të kalojnë vetëm 5-6 a më shumë vjete që të ndërrohej koncepti se dritaret tip (të përdorura ndofta edhe një milion herë) ishin bërë monotone. Përse? «Sepse prishej industrializimi i tyre!» Edhe industrializimi është një faktor me rëndësi, për më tepër është rruga e progresit teknik, është e ardhmja jonë, por industrializimi duhet parë në dinamizëm, në lëvizje. Dialektika nuk pranon as qëndrim as ekuilibër. Ne do të kemi dritare tip, do t'i përdorim këto dy vjet të themi, pastaj do të projektojmë tipa të tjerë, kështu s'pushon as industrializimi, por kryesisht nuk shëmtojmë e mërzisim fasadat tona.

## KOSTAQ SAHATÇIU

### Ndërtimet industriale dhe arkitektura

Krahas zhvillimit madhështor të industrisë sonë socialiste, lindi dhe po rritet arkitektura e re e panjohur më parë në vendin tonë, arkitektura industriale me tiparet dhe karakteristikat e saj dallonjëse. Si degë e re, ajo paraqet shumë të panjohura dhe kontradikta, të cilat na venë ne arkitektët para detyrave shumë të rëndësishme për zgjidhjen drejt të të cilave na duhet shumë mund dhe studime.

Si rrjedhim i ndërtimeve industriale, shumica e qyteteve janë dyfishuar, të tjerë janë rritur edhe më shumë. Pra, lidhjet dhe marrëdhëniet ndërmjet qytetit dhe industrisë janë shumë të ngushta, ato influencojnë njera-tjetrën. Kështu, kur flasim për arkitekturën e një qy-



teti, kemi përmbledhur në të edhe arkitekturën e ndërtimeve industriale.

Fjala e shokut Enver: «Ndërtimet tona, qytetet, fshatrat, banesat, institucionet shoqërore, kulturele etj., të jenë sa më të bukura ku të kënaqin dhe të edukojnë shijen estetike njerëzit tanë», shtrihet dhe përmbledh gjithshka që i përket arkitekturës, pra edhe arkitekturës industriale. Të jemi, pra, konsequent dhe të bëjmë përpjekje të gjithanëshme që të udhëhiqemi nga ky mendim në gjithë aktivitetin tonë të projektimit dhe ndërtimit.

Nuk duhet të harrojmë se në qendrën e punës kalohet një e treta e njëzetekatër orëshit ose më mirë më shumë se gjysma e pjesës më aktive të jetës; kështu që mënjanimi i objektit që krijon kushte komoditeti, që rrit dhe edukon ndjenjën dhe shijen e estetikës, që krijon kushte për rritjen e rendimentit në punë, mënjanimi pra i arkitekturës nga veprat industriale do të ishte një koncept i gabuar.

Puna e mbarë në këtë drejtim fillon që me vendosjen e objektit, duke marrë parasysh natyrën që e rrethon, ndërtimet pranë si dhe marrëdhëniet që duhet të krijojë me qytetin, duke harmonizuar të gjitha kërkesat dhe kontradiktat që mund të lindin nga kushtet e veçanta të truallit, ose kërkesat teknologjike. Një vendosje kompakte në planimetri me shfrytëzimin racional të truallit, do të na shpjerë në zgjidhjen e drejtë të volumeve të veprës.

Veprat industriale, për natyrën e tyre të veçantë, krijojnë mundësira të jashtëzakonëshme për të arritur në kompozime arkitektonike me vlerë. Dora e arkitektit duhet të sintetizojë tërësinë arkitektonike, duke shfrytëzuar në mënyrë krijuese kontrastet dritë-hije, lojën e volumeve, kontrastin e ngjyrave dhe materialeve rrethorë. Nuk është fjala këtu që arkitekturën industriale ta rëndojmë më tepër, qofshin këta elementë arkitektonikë ose volume ndërtimi, sepse do të binim në formalizëm që do të dëmtonte si anën ekonomike ashtu edhe vetë arkitekturën. Nga ana tjetër, nuk do të ishte e drejtë që të kalonim në ekstremin tjetër, në thjeshtëzimin total, duke e zhveshur arkitekturën nga çdo përmbajtje, sepse edhe ky rast do ishte po aq i dëmshëm.

Një vepër është e bukur kur në tërësinë e saj është zgjidhur bukur dhe jo kur ka ndonjë detaj ose hollësi të trajtuar në mënyrë të veçantë. Një objekt industrial ose edhe i tjetër natyre, duhet të na tërheqë edhe kur nuk është i suvatuar dhe do të ndodhë kështu në qoftë se do

të plotësojë kushtet e kompozimit arkitektonik të evidencimit të volumeve, të harmonizimit të kontrasteve, të ngjyrave, të materialeve, të pastërtisë së punimeve dhe të sistemeve. Nga ana tjetër, nuk do të ishin tepërime përdorimi i mbrojtseve nga dielli ose shiu, i strehëve të dala ose pensilinave, kur këto janë të domosdoshme për të siguruar kushte pune normale. Në NISH goma në Durrës, çdo vit shpenzohen sasi të mira lekësh për perde, për të ndaluar diellin të bjerë në vendin e punës. A nuk do të kishte qenë më e drejtë që këtë (mënjanimin e diellit në vendin e punës) ta kishin bërë me elementë arkitektonikë, duke shpenzuar vetëm njëherë një sasi lekësh?

Mendoj se po kaq i nevojshëm, në qoftë se kërkohet, është edhe përdorimi i suvatimit në një vepër industriale, sidomos kur materialet me të cilat është zbatuar vepra janë të cilësisë së dobët dhe nën veprimin e agjentëve atmosferikë dekompozohen duke krijuar kështu pamje të papëlqyera. Edhe përdorimi i disa materialeve si qeramikë, gur i gdhendur, suva granili etj, nuk duhet konsideruar si tepër, kur këto vihen me kriter për të realizuar një arkitekturë sa më të mirë.

Besoj se në arkitekturën industriale do të gjenin përdorim të mirë edhe artet e aplikuar, si për të krijuar efekte arkitektonike, ashtu dhe për anën edukativo-agjitative dhe për rritjen e ndjenjës së estetikës.

Puna e arkitektit në bashkëpunim me teknologun dhe piktorin e specializuar për këtë qëllim, duhet të ndihet në një të arthme të afërt, edhe në trajtimin e interiereve industriale. Kjo nevojë ka filluar të ndihet që tani. Ka ndërmarje dhe qendra pune që në këtë drejtim tregojnë kujdes dhe interesim, duke ju drejtuar për ndihmë edhe specialistëve përkatës dhe rezultatet, me sa shihet, do të jenë të mira. Ulja e lartësisë me anën e tavanit, rregullimi i dyshemesë, ngjyrosja e përshtatëshme e mureve, makinerive dhe pajisjeve do të krijojnë një ambient pune shumë të këndshëm në uzinën gjeologjike në Tiranë dhe me siguri do të ndikojnë në rritjen e rendimentit në punë.

Janë bërë prova dhe është konstatuar se një dysheme me ngjyrë gri në të zezë thith rreth 90% të dritës. Nga ana tjetër, një detal, që pas përpunimit shkëlqen, reflekton 95% të dritës. Punëtori, duke kaluar vështrimin nga detali në dysheme dhe anasjelltas, pëson një mikroverbim që është llogaritur se në tetë orë shkakton një ndërprerje të punës baraz me 30 minuta për çdo punëtor. Nga ana tjetër, vetitë e ngjyrave për të krijuar efekte të ndryshme



në ambjentin e punës janë po ashtu të njohura dhe do të ndihmonin shumë në krijimin e kushteve sa më të mira në punë. Kështu, p.sh., bëhet i nevojshëm studimi i ngjyrave për ambjentet që kanë shumë nxehtësi në mënyrë që, bashkë edhe me mjete të tjera, të ndihmojë në freskimin e ambjentit.

Arkitektura e interiereve lidhet, pra, drejtpërdrejt me krijimin e kushteve të përshtatshme në punë dhe ndihmon në rritjen e rendimentit.

Pesëvjeçari i pestë, përveç ngritjes së kolloseve industriale, do të çelë me siguri degë të reja të panjohura për ne. Dinamizmi i jetës sonë është më i fortë nga parashikimet tona, prandaj duhet të bëjmë përpjekje të gjithanëshme për të ecur të paktën paralel me të. Ne duhet të arrijmë në një të afërme të afërt të projektojmë në vend të gjitha llojet e ndërtimeve industriale. Por për këtë është i domosdoshëm fuqizimi i mëtejshëm i drejtorisë industriale, ku sot punojnë vetëm 5 arkitektë.

Mendoj se mund të jetë e frutëshme që të krijohen pranë kësaj drejtorie grupe projektimi komplekse, që të marrin përsipër projektimin e veprave deri në vënien e tyre në shfrytëzim. Këto grupe duhet të përmbledhin të gjithë specialistët, që nga arkitekti deri te teknologu.

Vetëm kështu ndërtimet tona industriale dhe arkitektura e tyre do ta thonë siç duhet fjalën e tyre në lidhje me kërkesat dhe nevojat e kohës, me problemet e mëdha që dalin në procesin e zhvillimit të vullshëm të ekonomisë së ndërtimeve dhe të gjithë shoqërisë.

**NIKO TITKA**

## **Arkitektura moderne t'i përgjigjet kohës**

Në tavolinat e punës së arkitektëve krijohen lagje të reja banimi, fabrika e uzina, shkolla dhe shtëpi kulture. Të gjitha këto ngrihen në letër, përpara se të ngrihen prej betoni, hekuri dhe xhami, përpara se të banojnë dhe të punojnë në to. Është jeta në shkallën 1:100.

Arkitekti sot formon kornizat e jetës të brezave të ardhshëm. Duhet pra të dijë jo vetëm nevojat e ditës së

sotshme dhe të mundë t'i zgjidhë, por të parashikojë nevojat e së ardhmes dhe mjetet e veprimt, të shikojë me mendje në të ardhmen duke krijuar mundësitë për të ardhmen. Në këto mendime për të ardhmen duhet të tingëllojnë fort faktorët themelorë që rrjedhin prej rritjes së shpejtë të popullsisë, akoma më tepër të zhvillimit dhe revolucionit teknik.

Në vitin 2000, në një periudhë prej afro 30 vjetësh popullsia e vendit tonë arrin rreth 3-3,5 milion njerëz. Gjatë kësaj kohe duhet të ndërtojmë edhe një herë sa është ndërtuar deri tashti. Kjo krijon domosdoshmerinë për krijimin — duke e marrë praktikisht — të një ambjenti të ri, të ndryshëm nga ai që kemi sot, për shoqërinë e re kërkesat e së cilës gjithmonë ndryshojnë shpejt dhe janë vazhdimisht në rritje.

Në këtë proces të madh të ndërtimit të qyteteve dhe të fshatrave tona, një rol të madh për të plotësuar kanë arkitektët, të cilët duhet të tregojnë rrugët si duhet ndërtuar, në mënyrë që ndërtesat të plotësojnë jo vetëm nevojat fizike të shoqërisë, por të jenë edhe të bukura.

Mendoj se kjo mund të arrihet vetëm në qoftë se do të angazhohet për këtë qëllim një rreth më i gjerë ku të diskutohet për mënyrën e ndërtimit të ambjentit që na rrethon. Nuk mendoj këtu vetëm për numrin e arkitektëve që duhet të rritet, por gjithashtu edhe për shokët që janë të interesuar në degët e tjera të kulturës dhe artit, shkrimtarët, plastikët, kritikët, publicistët, njerëzit e radios dhe të filmit e të televizionit, njerëzit e kulturës të shoqërisë sonë. Urbanistika dhe arkitektura gjithmonë dhe më tepër gërshetohen me kohën. Dhe kjo është gjëja më e re e profesionit tonë, që në kohët e fundit del shumë në dukje. Ndryshimet tek ne sot bëhen në mënyrë çuditërisht të shpejtë. Dalin mjaft probleme që deri dje nuk ekzistonin. Me rritjen e mirëqënies së popullit, kërkesat janë gjithmonë në rritje.

Leonardo da Vinçi, duke vërejtur ngjarjet që pasojnë, rastet dhe zbulimet, ka thënë: «Nganjëherë më duket se nuk ka të tashme. E kaluara bashkohet me të ardhmen. Është vetëm dita e djeshme dhe e nesërme.»

Në vitet '50 janë ndërtuar shtëpi banimi një e dykatëshe. Numri i kateve më vonë ka ardhur duke u ngritur gradualisht në 3, 4 dhe 5. Sot kemi arritur edhe 6-katëshe, bile edhe 7-katëshin në raste të rralla. Këto dy vjetët e fundit, në aksionin e ndërtimeve me kontribut vullnetar, janë ndërtuar prapë 1, 2 dhe 3 katëshe.



Ndërtimet e ulta, të cilat kërkojnë terren të madh, rrjet kanalizimesh, rrugë dhe instalime elektretiko-telefonike etj. dhe kosto të madhe janë pa perspektivë të gjatë. E gjithë kjo sipërfaqe që jepet sot për ndërtimin e banesave, për industri, për pushim, a do të na kënaqë edhe për 30 vjet, atëherë kur kjo sipërfaqe do të jetë pak?

Në urbanistikë duhen krijuar bazat shkencore, të cilat të lejojnë për kapërcimin e fakteve për 30 vjet.

Ndërtesat që janë ndërtuar para 30 vjetësh sot janë pengesë për zhvillimin e qyteteve dhe ne ju vemë atyre vulën «për t'u prishur». Duhet, pra, të ndërtojmë sot në mënyrë të atillë që mbas 30 vjetësh ato të qëndrojnë njësoj mirë dhe bukur.

Duhet të mbështetemi në faktin e thjeshtë se ajo, që ne arkitektët krijojmë sot, ka një influencë të madhe për kulturën e të nesërme. Arkitektura jonë moderne duhet lidhur ngushtë me truallin tonë shqiptar, me funksionin dhe formën e saj popullore. Në luftë të vazhdueshme rrymat dekadente, ajo duhet t'i përballojë kohës duke u mbështetur në teknikë të përparuar.

Detyrat që vihen përpara arkitektëve, kontraktorëve dhe ndërtuesve janë të thjeshta, por njëkohësisht të vështira. Të projektosh një lagje, një shtëpi banimi, apartamentin, fabrikën, dyqanin, duhet që kjo lagje e zakonshme dhe banesë e zakonshme të jetë e rehatëshme, e lirë, të jetë brenda normativave dhe të jetë e bukur etj.

Mundësitë tona finaciare, materiale, teknike dhe ato të kuadrove janë të kufizuara (por gjithmonë në rritje). Por edhe me këto mjete të kufizuara ne ngremë arkitekturën që u shërben masave.

Bindja ime është se arritja e një arkitekture të mirë është e pavarur nga niveli ekonomik i shoqërisë, duke u mbështetur në parimin se në çdo nivel ekonomik mund të bësh një arkitekturë të mirë. Niveli i arkitekturës nuk varet nga fakti në se do të përdorim duraluminium apo jo. Jam i bindur se edhe me materialet primitive mund të ngremë ndërtesa moderne, se arkitektura e kohës mbështetet para së gjithash në mendimin përparimtar.

Atëherë del pyetja: Sot projektet tona janë të mira apo të këqia? Kjo është një pyetje e vështirë. Ka projekte të mira dhe të këqia. Mua më duket se projektet tona duhet të ishin më të mira.

Le të marrim, p.sh., ndërtesat e banimit. Nuk mund ta ndajmë qytetin nga banesa. Njera duhet kthyer karsi tjetrës. Duhet gjetur forma e qytetit dhe pastaj duhet gjetur forma e banesës.

Përsa i përket formës së qytetit ajo nuk është gjetur, fakt është se ne ndërtojmë në të gjitha qytetet me të njëjtat lartësi dhe kudo me të njëjtat tipe.

Vendi ynë i vogël ka klimë të ndryshme, pra duhet ndërtuar me materiale të ndryshme të ndërtimit simbas zonave me tradita dhe zakone të ndryshme. Del pyetja: A ekzistojnë ndryshime rajonale në mënyrën e ndërtimit? Duhet të ketë pra ndryshime edhe në shprehjen arkitektonike, ashtu si ndryshojnë edhe veshjet tona kombëtare.

Vendi ynë ka ndryshime relievesh. Mvartësia ndërmjet ndërtesës dhe natyrës është problem në të cilën secili takohet jo vetëm me ndërtesat e banimit, por në çdo degë të projektimit. Terreni është fillimi i arkitekturës. Për këtë duhet të mësojmë si ka ndërtuar populli.

## PETRAQ KOLEVICA

### Arkitektura duhet të ecë përpara

Është në dorën tonë që ky takim i shumëpritur dhe tepër i domosdoshëm të japë frutet e dëshëruara. Këtu ne duhet të shtrojmë problemet kryesore që pengojnë punën tonë dhe të mundohemi të gjejmë zgjidhjen më të mirë për të ndihmuar në ecjen e arkitekturës sonë përpara. Këto probleme kryesore u prekën dhe u trajtuan mirë në raport. Unë dua vetëm të nënvizoj dhe të theksoj më tepër disa prej tyre.

Profesioni ynë na ngarkon me përgjegjësi të madhe ndaj shoqërisë. Guxoj të them, bile, me një përgjegjësi më të madhe se sa mjekët apo pedagogët.

Jo më kot egjiptasit e vjetër e mbanin profesionin e arkitektit për të shenjtë.

U përmend këtu roli i madh edukonjës i arkitekturës. Dhe unë dua të shtoj se s'ka ekzagjeruar shumë ai që ka thënë: «Mund ta vrasësh një njeri me pamjen e një ndërtese siç mund ta vrasësh me sopatë». Po ta mendojmë kështu, kuptojmë se sa përgjegjësi të madhe, kemi ndaj shoqërisë, e cila na ka dhënë në dorë një lapës dhe tok me të edhe dhjetra milionë lekë, na ka lënë në dorë rrugët, ndërtesat, gjelbërimin, qytetet dhe fshatrat. Na



ka besuar ndërtimin e Shqipërisë së sotme dhe të nesërme.

Deri më sot arkitektët kanë punuar pa u kursyer për ta mbajtur me nder këtë barrë të rëndë, për t'i kryer sa më mirë detyrat. Shumë punë kanë dalë nga duart e tyre, shumë prej tyre janë rritur nëpërmjet kësaj pune, por kjo barrë po bëhet sa vjen e më e rëndë, kërkesat po shtohen nga dita në ditë. A do të jenë në gjëndje arkitektët t'i përballojnë si duhet këto detyra?

Le ta analizojmë gjendjen.

Vitet e fundit, veçanërisht, me krijimin e zyrave të urbanistikës dhe projektimit në rrethe, numri i projektuesve është shtuar, simvjet na shtohen edhe një tok arkitektësh entuziastë, që mbarojnë universitetin, është shtuar dhe kristalizuar më tej përvoja e pasur e më të vjetërve. Këta janë faktorë pozitivë, por ka dhe diçka që na pengon.

Puna intensive, shpejtësia në projektim na kanë aftësuar vërtet, na kanë mësuar të zgjidhim shpejt një planimetri dhe një fasadë, na kanë ushtruar të kombinojmë mirë dhoma e koridore sipas një teknologjie të caktuar, por na kanë bërë të harrojmë shumë gjëra. Këto që do të them e di që do të na dhëmbin, se po e fut bisturin thellë, por është e domosdoshme të njohim vetveten.

Ajo që bie më shumë në sy në radhët tona është mungesa e njohjes së thelluar të profesionit nga ana teorike. Përgjithësisht në punën tonë mbizotërojnë diletanizmi dhe praktiçizmi.

Njohja e historisë së arteve dhe historisë së arkitekturës në veçanti si mjet interpretimi i fenomeneve të sotme mungon. Ato njohuri të pakta që kemi, mbeten të vagëlluara në mes kujtimeve të mjegullta nga shkolla. Përgjithësisht punohet me përshtypjet e çastit, nga çfletimet e revistave. Pa ndonjë përvetësim kritik të orientuar nga ligjet e përgjithëshme të artit dhe shkencave. Gjykimi ynë i bie shkurt: Më pëlqen; s'më pëlqen! Kjo bën që nganjëherë të merren nga literatura (desha të them nga fotografitë e revistave) tamam ata elementë që s'duhen marrë. Përveç boshllëqeve të kulturës teknike, ndër ne kultura e përgjithëshme ka mbetur e cekët dhe fragmentare.

Duhet të jemi të bindur se në qoftë se arkitektët nuk do të bëhen pjesa më e kulturuar e intelektualëve të vëndit tonë, të mos kemi asnjë iluzion për ndonjë ndryshim të dukshëm në arkitekturë.

Për të ecur në këtë drejtim duhet punuar me hir e me pahir.

Të organizohen konsulta të përherëshme, leksione me tema të caktuara, diskutime mbi probleme të veçanta, reçensione librash të rëndësishme dhe deri provime të detyruara në lëndët dhe gjuhët kryesore.

Pa një bagazh gjithmonë e më të pasur profesional dhe kultural nuk ka se si të përballojmë problemet e mëdha që duam të zgjidhim.

Arkitekt do të thotë kryendërtonjës, pra është ai që duhet ta dijë mjeshtërinë më me themel dhe më mirë nga gjithë të tjerët, duhet të jetë inxhinieri i ndërtimit më i aftë për të qenë pastaj arkitekt i mirë. Që në çastin që do t'i ndajmë, biem në gabim. Përveç kësaj, duket se ka ardhur koha që arkitektët ta profilojnë punën e tyre, të mos projektojnë të gjithë të gjitha llojet e ndërtesave, duhet të fillojë specializimi. Thamë se arkitektët kanë përgjegjësi ndaj shoqërisë më shumë se sa mjekët, por le të themi bars me mjekët. Që ta përballojnë mirë këtë, duhet të aftësohen, të njohin tërësisht të fshehtat e profesionit të tyre.

Ndër të tjera kjo arrihet me specializimin, por ndërsa mjekët shkojnë me konvejer jashtë shtetit për specializime në degë të ndryshme me afate optimale, për arkitektët duket sikur është zgjidhur problemi duke i dërguar me pavilionet e Dhomës së Tregëtisë a ndonjë punë tjetër kësodore. Me këtë rast ata shikojnë rrëmbimthi nja dy aeroporte apo stacione treni, soditin shkarazi rrugë qytelesh e fasada ndërtesash — në rastin më të mirë — marrin disa fotografi dhe vinë më shpejt seç venë. Asnjëherë, asnjë arkitekt nuk është dërguar të studiojë për një periudhë të caktuar problemet e ndërtimit të shkollave, të spitaleve, të banesave apo të shohë zgjidhjen e problemeve urbanistike të ndonjë qyteti të huaj.

Për të shpjeguar se sa keq është kuptuar kjo çështje po jap një shembull të freskët: Kohët e fundit u dërgua jashtë shtetit një ekip inxhinierësh për të studjuar ndërtimin e banesave me pjesë të parapregatitura. Shumë bukur. Po pse në këtë ekip mungonte arkitekti?

Dua të flas edhe për një problem tjetër, për konkursat. Sapo të ze këtë fjalë në gojë, arkitektët kanë të drejtë të nënqeshin me hidhërim, sepse edhe një konkurs që u çel dikur për projektin e Vorrezave të Dëshmorëve në Tiranë s'e mori vesh njeri se si u mbyll.

Pjesëmarrësve, që punuan muaj me radhë, në fund nuk iu tha gjysëm fjale as për mirë as për keq. Me gjithë



pasojën negative që pati, se lëkundë besimin e njerëzve ndaj konkurseve, pati të mirë të madhe se për këtë projekt kaq të rëndësishëm u hodhën shumë idera, u rrahën shumë mendime dhe, ç'është më kryesorja, ai tregoi se ne ishim në gjëndje të përballojmë konkurset. Sot jemi edhe më të fortë, prandaj duhet t'i praktikojmë. Ata janë një garë fisnike ku secili mundohet të japë maksimumin në dobi të shoqërisë.

Ç'të keqe do të kishte sikur organeve që do të aprovonin, p.sh., hotelin në qendër të Tiranës, apo Galerinë e Arteve, apo Muzeumin e Luftës t'ju paraqiteshin jo një po dhjetë variante nga një konkurs i organizuar mbi këto tema edhe sikur të harxhohej një e pesëqinta e fondit të ndërtimit për organizimin e këtyre konkurseve? Asnjë humbje, vetëm fitime!

Problemin e fundit që dua të prek e lashë të fundit jo nga rëndësia, por që ta theksoj më shumë.

Një nga pengesat më të mëdha në rrugën për ngritjen në një shkallë edhe më të lartë të arkitekturës sonë është procesi i realizimit të veprave, domethënë zbatimi i projekteve.

Pjesa konstruktive — statike — mure, kollona, trarë, zbatohen pa shumë fjalë ashtu siç janë parashikuar në projekt. Pse? Sepse për qëndrueshmërinë e ndërtesës s'merr përgjegjësi zbatuesi, le ta mbajë konstruktori.

Për «të rregulluar» pamjen e ndërtesës janë gati të japin «kontributin» e tyre të gjithë.

Sapo fillojnë punimet përfundimtare, suvatimet, shtresat, ngjyrat dhe elementë të tjerë plotësues të ndërtesave, fillon edhe ndërmarrja zbatuese: «këtë s'e bëj se s'kam, këtë s'e bëj se s'di, këtë s'e bëj se s'dua.» Të formohet kështu përshtypja sikur ndërmarrjet tona zbatuese janë ndërmarrje të ndërtimeve karabina. Edhe shumë ndërtesa të mbaruara mbajnë vulën e shëmtuar të karabinasë, sepse mjaft procese pune lihen të pakryera.

Po të luftosh për të mos pranuar punime të këqia e ke nofkën prapa: «Ti kërkon qiçra në hell!»

Këtu s'flas për dy tre objekte, për të cilën interesohen të gjithë, por për ato objekte që interesohet vetëm projektuesi, d.m.th. për shumicën.

Asnjëri nuk ka kundërshtim, përkundrazi janë të gjithë të gatshëm, që objektet t'i diskutojmë në fazën e projektit në këshilla teknike, në konsulta me punëtorët dhe kudo gjetkë për të gjetur zgjidhjen më të mirë, por kur vendosim, atëherë duhet të luftojmë për kryerjen e përsosur të këtij projekti.

Një prej rrugëdaljeve nga kjo gjëndje është rritja e autoritetit të arkitektit në objekt. Konfirmimi i këtij autoriteti me ligj. Në qoftë se i është ngarkuar një detyrë, duhet t'i krijohet mundësia dhe t'i jepet e drejta që ta shpjerë këtë detyrë deri në fund.

Mundet që ndonjë arkitekt kërkon në ndonjë rast qiçra në hell, por gjithë të tjerët rrojnë me problemet tona të ndërtimit dhe mundohen t'i kuptojnë e t'i zbatojnë drejt ato duke u përpjekur t'i futin në një rrugë që ndihmon në shpënieën e arkitekturës sonë përpara.

Në këto përpjekje arkitektët nuk po gjejnë mbështetjen dhe përkrahjen e duhur nga ndërmarrjet zbatuese. Dhe ndërmarrja zbatuese ka në dorë dhe gurin dhe arrën. Të thotë s'e bëj — dhe vate. Ose s'të thotë fare dhe e bën si di. Arkitekti kështu e ndjen veten në rolin e një këshilltari për ndonjë problem që ndërmarrja s'e zgjidh dot dhe që të marrë në fund përgjegjësinë për të metat e objektit.

Kështu nuk mund të ecet. Kjo kontradiktë duhet të zgjidhet dhe ka mundësi të zgjidhet, por kjo zgjidhje duhet të gjëndet sa më parë për t'i dhënë arkitekturës një hap më të madh përpara.

ANTON LUFË

## Arkitekti dhe industrializimi i ndërtimit

Në referatin e sotëm me të drejtë theksohet se «ndërtimet më dominuese si nga sasia ashtu dhe nga përhapja që kanë janë banesat dhe se pikërisht janë këto që e përcaktojnë fytyrën e vërtetë të qyteteve tona».

Kur flasim për probleme estetike të arkitekturës dhe të urbanistikës, flasim pra në radhë të parë për këto lloje ndërtesash.

Aksioni i madh politik për ndërtimin e banesave me punë vullnetare dhe me goditje të përqëndruar, shtron para arkitektit dhe ndërtuesit detyrën që ky problem të kryhet «shpejt, mirë dhe lirë».



Pra ky volum ndërtimi kërkon nga arkitektët të kujdesen me punën e tyre krijuese që jo vetëm për godina të veçanta (si hotel, shtëpi kulture, etj) të kenë arkitekturë të bukur dhe të denjë, por që edhe këto komplekse urbanistike (blloqe, rrugë banimi etj.) të paraqesin, sipas porosisë së shokut Enver, ambjente të bukura dhe të denja.

Plotësimi i detyrave të mëdha kërkon një thellim të revolucionit tekniko-shkencor në fushën e projektimit të ndërtesave.

Ky revolucion nuk mund të kryhet mirë dhe shpejt me teknikën e vjetër artizanale, pa mekanizimin dhe industrializimin, pa i kthyer sheshet e ndërtimit në sheshe montimi.

Industrializimi i ndërtimit, parafabrikimeve dhe montimi i pjesëve tip në godinë, përfaqëson, në kuptimin më të plotë, revolucionarizimin e teknikës së ndërtimit, dhe pikërisht kjo është teknika më shkencore dhe më e përparuar e kohës sonë.

Dihet se teknika e ndërtimit, qoftë ajo e qerpiçit, e gurit, qoftë ajo e montazhit dhe e parafabrikateve, është ajo që ndikon drejtpërsëdrejti në tiparet dhe në formën e arkitekturës së kohës përkatëse: pra ndikon në sferën e estetikës së arkitekturës, gjë të cilën ne sot e diskutojmë.

Format e arkitekturës realizohen vetëm me teknikën përkatëse të ndërtimit; ato nuk mund të jenë të çfardoshme edhe bëhen sa më shprehëse në arkitekturë, kur këto forma i përgjigjen në mënyrë të plotë teknikës përkatëse të ndërtimit.

Për këtë arsye, ne arkitektët duhet të jemi shumë të interesuar për llojin e teknikës së ndërtimit dhe duhet të marrim pjesë e të ndikojmë në zhvillimin dhe revolucionin tekniko-shkencor në ndërtim.

Në saje të teknikës së ndërtimit, arkitektura është njëkohësisht shprehja e kulturës materiale të kohës (epokës) përkatëse.

Mendoj se kjo vartësi duhet të theksohet kur flasim për arkitekturën në aspektin e saj artistik; vartësi, e cila nuk ekziston në artet e tjera. Pra, nga ana artistike, arkitektura është e lidhur ngushtë jo vetëm me qëllimin e saj ideo-artistik, por edhe me formën që është materiale, ajo është prodhimi i teknikës dhe duhet t'i përgjigjet teknikës së ndërtimit në mënyrë sa më reale. Përdo-

rimi i formave të tjera që nuk i përshtaten kësaj teknike ndërtimi, çojnë në imitime, në eklektikë jo krijuese. Në arkitekturë janë të lidhura arti dhe teknika në një unitet, ato janë dy pjesë (anët) dialektike të veprës së artit të ndërtimit dhe vetëm kështu, të lidhura bashkë, fjala arkitekturë merr kuptimin e saj të plotë, d.m.th. «kryendërtim» (për dallim nga inxhinieria tjetër, që nuk ka për qëllim shprehjen artistike si, p.sh., bonifikimet, ndërtimet hidroteknike, tunelet, etj.) Arkitekti në histori ka qenë ai që e ka zotëruar, e ka ushtruar dhe e ka zbatuar teknikën e ndërtimit si një mjeshtër i artit. Kështu ai gjithmonë ka përfaqësuar të dy mjeshtritë, teknikën dhe artin së bashku. Po me zhvillimin e teknikës dhe shkencës së ndërtimit gjatë dy shekujve të kaluar (18 dhe 19) arkitektura — ndërtim, që më parë bashkonte artin dhe teknikën, gjithënjë e më tepër kaloi në fushën e veprimtë të inxhinierëve. Ana artistike dhe estetike u kufizuan vetëm në detyrën e dekorimit, në artin (arkitekturën) akademike, eklektike të kopjimit të formave dhe stileve të vjetra, ose në krijimin e formave «të lira» (baroke) dhe «dinamike», «poetike» dhe të «guximshme», d.m.th. abstrakte dhe fantastike, joreale.

Vetëm nga kalimi i shek. të 20, nën ndikimin e teknikës dhe shkencës moderne, arkitektura duke e përvetësuar këtë teknikë, hyri rishtaz në rrugën e kryendërtimit, të arkitekturës reale, jo kopjuese dhe jo imituese. Sot arkitektura e botës kapitaliste dhe revizioniste është rishtaz e mbushur me rryma dekadente të të ashtuquajturave arkitektura «të lira» dhe «abstrakte».

Çdo përpjekje për ta çuar arkitekturën vetëm në rrugën artistike, ka pësuar dhe do të pësojë falimentim, për deri sa teknika nuk futet në procesin e krijimtarsisë.

Rrymat e ndryshme, «izmat» e shumta në arkitekturën e botës perëndimore përfaqësojnë ikjen nga teknika reale. Arkitektura e tyre është shprehje e ideologjisë kapitaliste në kalbje, të kohës imperialiste. Si edhe rimi i teknicizmit në arkitekturë, ashtu dhe çdo largim nga realiteti dhe tendenca të ndryshme të tilla si «arti i lirë», «forma të lira», «humanizimi i teknikës» etj. çojnë në akademizëm dhe janë të huaja për arkitekturën tonë socialiste.

Arkitektura jonë është pjestare në ndërtimin madhështor të vendit dhe të njeriut socialist.

Sot arkitekti ynë ka dy role të rëndësishme: në një anë ai ka për detyrë të realizojë (në projekt dhe në zba-



tim) një vepër konkrete ndërtimi (një godinë ose kompleks kodinash, rrugë ose kuartalli etj.) dhe t'u japë një zgjidhje të mirë e të plotë kërkesave funksionale utilitare, strukturale, tekniko-ekonomike ashtu edhe atyre arkitektonike-estetike. Nga ana tjetër ai duhet të jetë një nga përkrahësit dhe inisiatorët kryesorë për zhvillimin e bazës materiale e të forcave prodhuese në fushën e ndërtimeve industriale dhe qytetare (në urbanistikë dhe në arkitekturë), një nga përkrahësit e revolucionit tekniko-shkencor dhe të industrializimit në ndërtim.

Përsa u takon veprave konkrete, arkitektët i kryejnë këto me interesim dhe, në këtë drejtim, kemi suksese të dukshme. Por përsa i takon revolucionit tekniko-shkencor, këtu arkitektët, me sa duket, ja kanë lënë inisiativën konstruktorëve dhe zbatuesve. Kjo duket veçanërisht në strukturat e ndryshme të parafabrikimeve. (Kolona — 1-3 kate, mbulesa të ndryshme, me arqe dhe me membrana, shede ose me struktura pjesore shkalla etj).

Edhe ramat e parafabriuara për banesa (rama H. ose ato të lehta të tipit të Sarandës) janë studjuar me pjesëmarrjen e pakët të arkitektit.

Ne deri tani kemi struktura të ndryshme parafabrikatesh, që janë studjuar dhe për të cilat janë nxjerrë vizatime dhe albume. Ato përdoren mjaft në objekte industriale, por për banesat, të cilat janë në shumicë struktura vertikale montazhi (skeleti ose mbajtëse dhe ndarëse) ne jemi në fillim. Përdorimi i tyre nga arkitektët është i pakët, sepse strukturat e parafabriuara dhe aplikimi i godinave tip nuk përkrahet sa duhet nga ata, mbasi problemi estetik, për variacionet dhe kombinimet me tipa (në lloje, në formë dhe në trajtim të faqeve me ngjyra) nuk është bërë akoma problem i mjaftueshëm i arkitektëve. Po që se tipat, elementat, seksionet dhe godinat tip përdoren vetëm për të plotësuar boshllëqet e planit, nuk duhet të habitemi kur të kemi përsëritje të thjeshtë mekanike dhe monotoni në komplekset urbanistike (rrugë, blloqe ose lagje).

Por megjithatë kemi edhe mjaft shembuj ku tipat dhe seksionet tip janë përdorur me kriter estetik dhe kanë krijuar kombinime jo monotone, por me volume dhe pamje të ndryshme.

## Faza e projektimit, faza më e rëndësishme e çdo objekti.

Arkitektura në vendin tonë karakterizohet nga ndjenja e madhe humanitare që tregojnë për njeriun duke e konsideruar atë si qënien më të lartë: nevojat dhe aspiratat e tij përbëjnë bërthamën e zgjidhjes së çdo problemi teknik funksional dhe estetik. Aspektet e ndryshme arkitektonike projektohen për njerëzit, për tërë shoqërinë, prandaj ato nuk mund të ndërtohen mirë dhe bukur pa njohur ligjet e zhvillimit të shoqërisë socialiste, kushtet në të cilat rritet, formohet njeriu ynë i ri. Arkitektura tek në rritet e zhvillohet në saxe të rritjes së zhvillimit të ekonomisë sonë socialiste e sidomos të industrisë, të rritjes që ka marrë sot vendi ynë nën udhëheqjen e drejtë të Partisë së Punës me shokun Enver në krye.

Siç e dimë, që të realizohet bukur një vepër arkitektonike duhet që ajo të projektohet mirë. Të ketë një projekt të studjuar mirë dhe me imtësi në të gjitha drejtimet. Faza e projektimit është koha më e rëndësishme e çdo objekti. Në qoftë se objekti është zgjidhur pastër dhe kjo nga ana funksionale, drejt dhe mirë nga ana arkitektonike dhe është formuluar bukur nga ana estetike arkitekturale, ai pa dyshim do të gëzojë këto cilësi edhe mbasi të ndërtohet. Ai do të kënaqë ata që e shfrytëzojnë (punojnë apo banojnë), por edhe të tjerët që kalojnë pranë tij, pse objekti do të ketë arkitekturën e jashtme të bukur dhe interesante.

Por që të arrihet kjo për çdo objekt sado i vogël që të jetë, se arkitekturën nuk e formojnë vetëm objektet e mëdha, por edhe ato të voglat, çdo projekt duhet t'i kushtohet koha e nevojshme që kërkon ai për hartimin e tij, që varet natyrisht nga volumni i punës, nga përgatitja tekniko-profesionale e projektuesve, përvoja etj. Krijimi i byrove të projektimit në disa rrethe të Shqipërisë për mendimin tim ka shkaktuar një shpërndarje më uniforme të punës në projekte, pse me anë të tyre janë aktivizuar shumë kuadro, kanë lehtësuar Institutin shtetëror të projektimit dhe kanë dhënë një larmi në përgjithësi të arkitekturës së objekteve që po ngrihen në çdo qytet. Disa byro projektimi kanë punuar me ata dhe kanë pasur rezultate të mira në krijimtarinë e tyre arkitektonike. Mi-



rëpo çdo byro nuk është plotësuar me kuadro projektues. Disa prej tyre udhëhiqen bile nga inxhinierë të një profili krejt të ndryshëm, të atij hidroteknik, të cilëve u ka rënë barra e projektimit të veprave arkitektonike. Megjithë dëshirën për të dhënë sa më shumë në fushën e projektiveve arkitektonike, përsëri për shkak të mospregatitjes së përshtatshme, krijimi në këtë byro, për mendimin tim, ka munguar. Për këtë është e nevojshme që në byrotë e projektimit të rretheve të aktivizohen më tepër ata që janë specializuar nga fakulteti i inxhinierisë me profilin e arkitekturës, të cilët do të ndihmonin mjaft në përmirësimin e cilësisë së projektimit në këtë byro.

Ne ndërtojmë shumë godina banimi, kopshte e grupe godinash dhe sot ne projektojmë e po ndërtojmë edhe lagje banimi. Kështu, p.sh., janë ngritur një sërë lagjesh në Tiranë: «50 vjetori», «Partizani», etj. lagja e banimit në Elbasan, apo lagjet e banimit në qytetet tona të rinj të Laçit, Kukësit etj.

Në qytetet egzistuese në mënyrë të veçantë ndërtimi i përqëndruar në një zonë më të gjerë, në një bllok dhe lagje jep mundësi jo vetëm të një planifikimi më të drejtë e të bukur urbanistik të lagjeve, por edhe të një organizimi të mirë të jetës së banorëve.

Po a i kanë të gjithë elementët kompozicionalë urbanistikë lagjet e banimit të ndërtuara deri më sot? Unë mendoj se jo. Ato nuk janë projektuar dhe për këtë nuk janë ndërtuar ashtu si duhet të ndërtohet plotësisht një lagje banimi. Në lagjet e banimit më duket se një vëmendje të veçantë i është dhënë vetëm kompozimit volumor të godinave të banimit, ndërsa objektet e tjerë nuk janë formuar plotësisht.

Një lagje banimi nuk është vetëm një njësi banimi, ku vetëm banohet, por është njëkohësisht dhe një njësi shoqërore ku zhvillohet edhe jeta kulturele e shoqërore e banorëve. Nuk mund të zhvillohet normalisht jeta e një lagjeje në qoftë se asaj i mungojnë objektet e domosdoshëm shoqërorë. Ajo, që të zgjidhet drejt dhe mirë, nuk duhet t'u plotësojë banorëve vetëm komoditetin e banimit, banesën me dritë, diell e gjelbërim, por dhe kërkesat e tyre social-kulturale.

Si mund të jenë të kënaqur banorët e lagjeve kur nuk u ngrenë shkolla 8-vjeçare dhe fëmijët për të shkuar në shkollë duhet të bëjnë 1 km. rrugë duke i detyruar të kalojnë në arteriet kryesore të qytetit? Apo kur, për të

blerë artikuj ushqimorë, që i ka si nevojë të përditëshme, banori detyrohet të shkojë në qytet?

Jeta jonë e re është e pasur me një aktivitet të gjerë politik, shoqëror kultural. A është menduar, p.sh., se në ç'vend në lagjet e reja do të zhvillohen mbledhjet që bëjnë organizatat e masave me banorët e lagjes, apo për zyrat e Frontit demokratik? A është menduar, për shembull, për një vend ku do të lozin fëmijët?

Unë mendoj se organizimi urbanistik i lagjeve të banimit kërkon një studim më të thellë urbanistik, që të mos ndodhi ajo që shikojmë sot në kuartallet e banimit të Laçit, ku banorët e qytetit po i ndërtojnë vetë dyqanet ushqimore, se nuk janë parashikuar në projekt, apo vështirësitë që po dalin për ndërtimin e një shkolle 8-vjeçare për banorët e lagjes «Partizani» në Tiranë, pasi në lagje s'ka vend dhe nuk është parashikuar...

FOTO STAMO

## Arkitektura të shprehë të bukurën

Ne artistët arkitekturën e kemi konsideruar dhe e konsiderojmë art, duke e përfshirë në gjirin e arteve të tjera. Duke e parë arkitekturën si art, gjithnjë na kanë preokupuar edhe problemet e saj. Shpesh në diskutimet tona për probleme të arteve figurative, sidomos të arteve të aplikuarra, jemi hedhur edhe te arkitektura, duke e parë atë si një nënë që mban në gjirin e saj edhe gjini të artit figurativ. Kjo çështje na ka preokupuar dhe na preokupon akoma deri sa të thyhet koncepti që pengon akoma për përdorimin e veprës së artit e sintezën e arteve të aplikuarra në arkitekturën tonë të sotme.

Kërkesat e partisë sonë në drejtim të letërsisë dhe të arteve për një nivel më të ngritur, për një formë kombëtare dhe për një përmbajtje të shëndoshë socialiste kanë bërë që arti dhe letërsia të ecin përpara dhe të formojnë pak a shumë fizionominë e tyre kombëtare. Gjithashtu, sot edhe për artin e arkitekturës ngrihen të njëjtat kërkesa, të cilat duhet të rriten ndaj krijimtarisë së arkitektëve. Kërkesat e sotme në drejtim të arkitekturës, janë që jo



vetëm të projektohet mirë dhe lirë, por të projektohet bukur me qëllim që arkitektura jonë e re socialiste t'u përgjigjet më mirë jo vetëm kërkesave funksionale, por edhe kërkesave estetike të përmbajtjes dhe formës, natyrisht pa nënvleftësuar edhe kërkesat në drejtim të kursimit.

Mendimi se: «tani nuk është koha të shtrojmë para projektuesve e arkitektëve tanë kërkesa estetike» mendoj se nuk i qëndron kohës.

Masat tona punonjëse gjatë këtyre 27 vjetëve kanë ngritur nivelin e tyre ideologjik e kultural si rezultat i revolucionit të thellë ideologjik e kultural që zhvillohet me sukses nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës. Prandaj kërkesat në drejtim edhe të arkitekturës nga ana e masave punonjëse për një hop cilësor në krijimet arkitekturale janë të kohës dhe të drejta. Diskutimi më i gjerë i problemeve aktuale krijuese në fushën e arkitekturës, sidomos për problemet më të mprehta, do të kishte sjellë edhe më shumë rezultate. Prandaj, zhvillimit të mendimit kritik, të teorisë së arkitekturës, të principeve arkitekturale duhet t'i kushtojmë më shumë vëmendje e kujdes në të ardhmen.

Kërkesat për një volum pune në projekte si dhe çështjet teknike dhe funksionale të lidhura edhe me kërkesat estetike nuk kanë qenë në një raport të drejtë. Prandaj ka edhe dobësi e të meta që vihen re, të cilat zbehin anën estetike. Kjo çështje lidhet edhe me ndonjë koncept jo të drejtë ndaj së bukurës dhe estetikës në arkitekturën tonë, ku shpesh e bukura dhe estetika shikohen e konsiderohen si të tepërta. Duhet të pranojmë se sot flitet më shumë se dje për të bukurën në arkitekturën tonë. Këtë e ngrejne dhe e kërkojnë më shumë si arkitektët, ashtu edhe porositësit. Të bukurën e kërkojnë sot edhe masat punonjëse. Një kuartall i bukur, një hotel turistik i bukur, një godinë e bukur, një qytet i ri i zgjidhur bukur si nga ana urbanistike dhe arkitekturale kënaq shijet, të mbush me optimizëm, të inspiron, të lehtëson e të gëzon shpirtërisht. Prandaj, mendoj se gjithnjë e më shumë duhet të synojmë për të bukurën dhe estetikën, në arkitekturën tonë.

Flitet dhe dëgjoher herë mbas here, u fol edhe këtu, se në ndërtimet tona arkitekturale vërehen edhe aspekte monotone e uniformiteti, përsëritje të tipeve të banesave shoqërore dhe të atyre social-kulturale. Shumë herë dëgjon mendime jo vetëm nga artistët, por edhe nga masat se kur je në Lushnjë, të duket sikur je në Fier apo në Shkodër. Mendoj se këtu ka një të vërtetë të madhe dhe

kjo vjen nga përsëritja e skemave, e tipeve kompozicionale, nga masat e lartësive dhe të volumeve, nga monotonia e ngjyrave. Çështja e të projektuarit dhe të krijuarit edhe në artin e arkitekturës kërkon një proces krijimi e origjinaliteti. Arkitekti nuk është një kopjues mekanik, por një artist krijues, që mendon dhe krijon larmi kompozicionale në veprat e projektet e tij, duke u mbështetur në parimet e metodës sonë të realizmit socialist si dhe në vijën politike, ekonomike të partisë dhe të shtetit tonë dhe në trashëgiminë tonë të pasur.

Na duhet të vlerësojmë më mirë dhe më drejt problemet, të luftojmë për të kapërxyer me sukses disa dobësi që vihen re si uniformiteti, ngjashmëria etj., duke mos bërë punë të ngutëshme dhe me kërkesa që injorojnë çështjet estetike dhe çështjen e së bukurës në arkitekturë.

Një aspekt tjetër që dua të ngre është ai i përdorimit të ngjyrave. Për këtë çështje tani së fundi vihet re një shqetësim më i madh si për suvatimin ashtu edhe për ngjyrosjen. Aspekti i brendshëm dhe i jashtëm i godinave luan një rol shumë të madh duke ushtruar një ndikim të madh estetik e të pashmangshëm në masat punonjëse. Në qoftë se hedhim një vështrim si në qytetin e Tiranës, ashtu edhe në qytetet e tjera, dominojnë ngjyra krejtësisht të zbehta, në gama të përafërta, monotone e anemike. S'ka dyshim se një aspekt i tillë anemik në qytet ndikon keq tek masat punonjëse. Koloriti i qytetit dhe i godinave të reja ashtu edhe për të vjetrat duhet zgjidhur drejt dhe me shumë kujdes. Një larmi koloristike, dekorative dhe me kontraste krijon një aspekt tjetër, aspekt gazmor, krijon frymëmarrje të gjerë dhe inspironjëse për masat. Çështja e trajtimit të gamës dhe e larmisë koloristike nuk është një çështje e thjeshtë, por një çështje me rëndësi që duhet vlerësuar. Kjo lidhet gjithashtu edhe me materiale të ndryshme dekorative të ndërtimit që tanimë duhet të përdoren në një gamë shumë më të gjerë.

Përsa i përket problemit të shfrytëzimit dhe përdorimit të traditave tona në fushën e arkitekturës ky është një aspekt tjetër me rëndësi që nuk duhet lënë pas dore, por duhet bërë më shumë nga ana e arkitektëve e inxhinierëve, nga ana e Institutit të mbrojtjes së monumenteve, nga Instituti shtetëror i projektimit si dhe nga vetë Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve.

Populli ynë ka një trashëgimi të pasur edhe në fushën e ndërtimeve. Qytetet tona muze, kështjellat, ndërtimet e tjera në qytet e fshat dokumentojnë më së miri



pasurinë në këtë fushë dhe këto e bëjnë arkitekturën shqiptare një arkitekturë me aspekte të veçanta nga arkitektura e vendeve të tjera, me përjashtim të disa veçorive të përbashkëta.

Kush nuk është mahnitur nga qyteti muze i Gjirokastrës, apo ai i Beratit jo vetëm nga tërësia kompozicionale, jo vetëm nga uniteti i kuartallave, por edhe nga përdorimi i formave e volumeve, nga përdorimi i materialeve të ndërtimit si dhe nga cilësia e punimeve. Të gjitha këto e vlerësojnë arkitekturën tonë në përgjithësi, vlerësojnë mjeshtërit, artizanët dhe gurëgdhendësit tanë. Nuk është e rastit që një godinë në Gjirokastrë e shikon të përkryer në ndërtimin e saj dhe si një të tërë të harmonizuar, të realizuar me mjeshtëri e shije; këto e bëjnë shtëpinë gjirokastrite si një vepër artistike arkitekturale të bukur.

Nga arkitektura kombëtare arkitektët tanë kanë mundësi që të zbulojnë shumë principe dhe elemente që mund t'i shërbejnë krijimtarisë së tyre dhe arkitekturës sonë moderne. Por në radhë të parë duhet njohur më shumë e kaluara jonë, ajo duhet shikuar më thellë, duke krijuar edhe një bazë materiale të plotë, e cila duhet të vihet në dispozicion të arkitektëve tanë për qëllime studimi. Arkitekturën tonë e bën kombëtare fryma e saj, forma dhe përmbajtja e saj, të krijuara këto nga një kënd vështrimi dhe të diktuar nga kushtet aktuale të sotme. Shfrytëzimi i elementëve më artistikë arkitekturalë shqiptarë të traditës sonë dhe përdorimi i tyre me zgjuarësi në arkitekturën tonë të re, lufta kundër ndikimeve të huaja dhe shfrytëzimi i përvojës së arkitekturës botërore do të bëjnë që arkitektura jonë të zhvillohet dhe të krijojë edhe më shumë fizionominë e saj shqiptare dhe t'u përgjigjet gjithënjë e më mirë jo vetëm kërkesave teknike, por edhe kërkesave funksionale dhe estetike.

Ne artistët kemi ngritur gjithënjë dhe e kemi konsideruar të domosdoshme çështjen që në projektet arkitekturale duhet të gjejë vend edhe vepra e artit figurativ, sidomos veprat e arteve të aplikuara. Sot ky problem ngrihet më me forcë mbasi janë përgatitur kuadro artistësh dhe arteve figurative u shtrohet detyra që të mos mbejnë brenda muzeumeve dhe galerive, por veprat e artit dhe veçanërisht ato të arteve të aplikuara të depërtojnë në masat punonjëse.

Përdorimi i veprave të arteve figurative — arteve të aplikuara, të pikturës e skulpturës monumentale, afreskut, mozaikut, qeramikës, xhamit etj., kërkojnë sipërfaqe

të tëra si brenda dhe jashtë godinave. Në radhë të parë përdorimi i tyre duhet jo vetëm të kuptohet e të njihet, por duhet të konsiderohet edhe si i domosdoshëm dhe jo vetëm për qëllim estetik, por edhe për qëllim edukativ. Nëpërmjet veprave të tilla ilustron historia e vjetër dhe e re e popullit tonë, si dhe reformat e mëdha ekonomike, politike dhe shoqërore.

Trajtimin dhe përdorimin e veprave të arteve figurative në arkitekturë e kërkon koha, por e kërkon edhe vetë gjinia e artit të arkitekturës natyrisht për vepra arkitekturale ku bëhet fjalë edhe për vepra të artit figurativ.

Mendoj se edhe arkitektët tanë duhet ta konsiderojnë veprën e artit figurativ në arkitekturë si një element të domosdoshëm që i ndihmon arkitekturës dhe të krijojnë një koncept më të drejtë mbi këtë çështje; bashkëpunimi midis arkitektëve dhe artistëve të arteve figurative duhet të bëhet më i ngushtë me qëllim që të diskutohet e të krijohet bashkërisht për një sintezë më të plotë të arkitekturës me artet figurative.

## VASILIKA CICKO

### Arkitektura e gjelbërimit

Në referat u ngrit problemi i trashëgimisë sonë arkitektonike. Ky problem i ka preokupuar gjithmonë arkitektët në veprimtarinë e tyre krijuese. Me përpjekjet që janë bërë është ende shpejt të themi se arkitektura e re që ne po krijojmë në veprat tona ka arritur tiparet e saj nacionale.

Duke folur për problemet estetike në arkitekturë, këtu u përmenden disa faktorë që influencojnë në këtë drejtim siç janë: zgjidhja funksionale, përdorimi i materialeve dekorative, kompozimi i bukur i volumeve, efektet që mund të fitohen nga përdorimi i fakturave apo ngjyrave të freskëta me kontrast etj. Në tërë këtë kompleks problemesh s'ka dyshim që një rol të rëndësishëm luan përshatja e veprës arkitektonike me ambientin ku vendoset dhe lidhja organike që duhet të krijojë ajo me natyrën. Ndërtesa në veçanti, ansambli në tërësi, apo edhe i gjithë



qyteti duhet të jetë i tillë që të mos duket i huaj atje ku vendoset, por të lidhet me vendin, të shkrihet me natyrën, të ndiejnë reciprokisht qënien e njera tjetrës duke krijuar kështu një të tërë të vetme harmonike.

Po të hedhim një vështrim në ndërtimet tona, nuk mund të themi se gjithmonë ato kanë gjetur zgjidhjen e tyre të përsosur. Për rritjen e vlerave estetike në arkitekturë një rol të rëndësishëm luajnë edhe disa faktorë të thjeshtë si sistemimet, gjelbërimi, ndriçimi.

Në të kaluarën mjeshtri popullor e ka shfrytëzuar shumë mirë natyrën, dhe megjithëse ndërtimi i tij ishte i thjeshtë, nganjëherë me mungesa funksionale dhe i varfër, sepse të tilla ishin mundësitë e tij materiale, nga ana estetike ai ka arritur gjithmonë vlera të pasura artistike.

Duke bërë një kompozim të bukur të veprës së tij me natyrën në përputhje me terrenin dhe gjelbërimin mjeshtri popullor ka arritur një larmi të pasur, tipare dhe bukuri të veçanta arkitektonike që ndryshojnë jo vetëm nga një krahinë në tjetrën, por edhe brenda për brenda qytetit ka ndryshim nga një lagje në tjetrën. Shëmbëll i mirë për të ilustruar këtë mendim është Berati. Këtu një rol të rëndësishëm ka luajtur shfrytëzimi i terrenit dhe kompozimi i bukur i gjelbërimit.

Meqënëse leverdia që sjell shfrytëzimi i reliefit u zhvillua në mënyrë të hollësishme në referat, dua të shtjelloj më gjatë problemin e gjelbërimit.

Të parët tanë kompozimin e gjelbërimit e kanë përdorur shumë bukur dhe nëpërmjet pasurisë së tij u kanë dhënë karakter të veçantë ndërtimeve të tyre. Ndërsa në oborin e shtëpisë ai përdorte pemë frutore, në ndërtimet monumentale dhe me karakter publik, që në atë kohë ishin vetëm kishat, ka krijuar kompozime të bukura gjelbërimi që i përshtateshin mjaft mirë karakterit të tyre.

Vendi ynë me klimën e tij të favorshme ka një florë shumë të pasur me drunj dekorativë. Përdorimi i tyre në arkitekturën e sotme, e cila në krahasim me arkitekturën e periudhave të kaluara është e zhveshur nga çdo lloj zbukurimi klasik, e ndjen si një nevojë të domosdoshme bashkëpunimin dhe lidhjen e saj me gjelbërimin.

Gjelbërimi si një objekt plastik e gjallëron arkitekturën, i jep asaj jetë, krijon një ambient romantik dhe çlodhjeje.

Po të shfrytëzojmë eksperiencën e pasur të të parëve tanë në këtë drejtim, me anën e gjelbërimit, mund të fitohen efekte të pasura estetike në arkitekturë dhe të thy-

het, deri në një farë mase, monotonia, e cila është shfaqur sot në pamjen e qyteteve apo lagjeve tona.

Le të përmendim një nga shembujt më të thjeshtë: përdorimin e drurëve dekorativë në rrugët e qyteteve. Këta drunj të mbjellë në të dy anët e rrugës krijojnë një rryp kalimi shumë të këndshëm, sepse me kurorën e tyre mbrojnë në verë kalimtarët nga rrezet përvëltonjëse të diellit; veç kësaj, ata e mbushin rrugën, pasurojnë arkitekturën e ndërtimeve të saj dhe, kur këta drunj ndryshojnë nga një rrugë në tjetrën, krijojnë variacion të madh dhe tipare të veçanta për secilën prej tyre. Në këtë drejtim shembuj të mirë ka në qytetet tanë dhe veçanërisht në Tiranë.

Por jo gjithmonë dhe nga të gjithë kuptohet drejt ky element kaq i nevojshëm i arkitekturës. Pema është një objekt pa vlera të mëdha materiale dhe kjo na bën që ndonjëherë të tregohemi të pamëshirshëm, ta presim gjer në rrënjë, pa menduar për kohën e gjatë dhe vitet që janë dashur për ta rritur. Dhe fatkeqësisht duhet të pranojmë se ngandonjëherë ju biem më qafë kot, na duket sikur ato na maskojnë arkitekturën e-pallateve, na prishin bukurinë e rrugës dhe, me lehtësi, i shkulin prej andej. Besoj se kjo ka qenë arsyeja që në rrugën kryesore të Fierit janë prerë pemët dhe, duke menduar se e kemi zbukuruar këtë rrugë, i kemi bërë një dëm të madh.

Në ndërtimet tona gjithmonë më tepër po duken shembuj të mirë të lidhjes së tyre me gjelbërimin. Krahas ndërtimit të veprës bëhet sistemimi i territorit, mbillen drunj dekorativë dhe gjelbërim i ulët. Por kjo tani për tani është praktikuar vetëm në ndërtime të veçanta, p.sh., në ato me karakter social kultural. Problemi qëndron që ta futim këtë në masën e arkitekturës, dhe këtë masë e bëjnë banesat.

Në kuartallet apo lagjet tona ndihet në mënyrë të theksuar mungesa e gjelbërimit, mungojnë sistemimet, mungon ndriçimi. Territori para apo mbrapa pallatit është oborri i banesës dhe ai kryen një funksion të caktuar. Fëmijët atje qëndrojnë një kohë të gjatë, dëfrenjë dhe pushojnë në ajër të pastër, së bashku me ta edhe të moshuarit. Për këtë arsye duhet krijuar një ambient i bukur, i pastër, i këndshëm. Këtë nuk e krijojnë vetëm arkitektura e bukur e pallatit, por edhe gjelbërimi. Duke vlerësuar drejt pasurimin e madh estetik që i sjell gjelbërimi arkitekturës dhe duke patur parasysh që mund të kryhet pa investime dhe shpenzime të mëdha, në këtë drejtim duhet kush-



tuar një kujdes më i madh. Arkitektura e gjelbërimit është një degë e veçantë dhe që të zhvillohet sa më mirë kërkon specialistë të kualifikuar.

FADIL PAÇRAMI

## Mendime për urbanistikën dhe arkitekturën

Problemet e urbanistikës dhe arkitekturës, që po diskutohen në këtë takim kombëtar të arkitektëve, po rrihen kryesisht në aspektin estetik të tyre dhe kjo më duket me rëndësi. Në fund të fundit, ky është edhe qëllimi i kësaj mbledhjeje. Duke i parë me këtë sy, në shumë drejtime ato janë të përafërta me çështjet estetike edhe në fushat e tjera të artit, prandaj mund të diskutojmë dhe të themi ndonjë fjalë edhe në të tjerët, që nuk jemi specialistë të sektorit, e kam fjalën nuk jemi arkitektë ose inxhinierë. Besoj se shokët do të na falin në qoftë se në ato që do të themi do të ketë ndonjë gjë që nga ana teknike mbase nuk qëndron. Për vete do të përpiqem t'u shmangem çështjeve teknike duke mbetur në aspektin estetik për të cilin po flasim.

1. E para çështje ku desha të ndalem është kjo: a janë këto probleme vetëm të arkitektëve, d.m.th. a do t'i zgjidhin vetëm ata, apo janë edhe të të tjerëve, dua të them të një mase më të gjerë? konkretisht: edhe të inxhinierëve e teknikëve të tjerë të zbatimit, edhe të punëtorëve dhe mjeshtërve të ndërtimit, edhe të punëtorëve e specialistëve të tjerë që prodhojnë materialet e ndërtimit? Unë mendoj se problemet e mëdha e shumë të rëndësishme të urbanistikës dhe arkitekturës, për të cilat u fol këtu nga shumë shokë, do të zgjidhen nga të gjitha këto forca së bashku — sigurisht duke mbajtur secili vendin e vet, kam parasysh se dikush lot rolin e vjolinës së parë, dikush të vjolinës së dytë, e kështu me radhë. Unë këtë e shtroj seriozisht, se kur vemë pyetjen, bie fjala, kush e ndërtoi Tiranën, kush i ngriti këto ose ato godina? është krejt logjike të përgjigjemi se ato i ndërtuan edhe arkitektët, edhe inxhinierët e teknikët zbatues, edhe punëtorët e mjeshttrat e ndërtimit, edhe punëtorët e specialistët e

tjerë që prodhuan materialet e ndërtimit. Dua të kujtoj këtu pjesë nga një poezi e Brehtit. Ajo mban titullin «Pyetje të një punëtori që lexon».

Kush e ndërtoi Tebën me shtat porta?  
Ndër libra përmenden emra mbretërisht.  
Mos i mbartën mbretërit gurët e mëdhenj?  
Dhe Babiloninë q'u prish aq herë,  
Kush e ndërtoi sërish?

.....  
Roma e madhe është plot me harqe triumfi.  
Kush i ngriti?

.....  
Aleksandri i Madh pushtoi Indinë.  
I vetëm, vallë?

.....  
Filipi i Spanjës qau, kur flota e tij  
U fundos. Nuk qau tjetërkush?  
Frederiku i dytë fitoi në luftën shtatvjeçare,  
Po veç atij kush tjetër, vallë, fitoi?

.....  
Kaq shumë ngjarje.  
Kaq shumë pyetje.

Kuptimi më duket është i qartë. Ai flet dhe është kundër asaj letërsie, e cila merret me mbretërit dhe disa figura të shquara, duke lënë në harresë masat. Por kjo ka vlerë edhe për çështjet që po diskutojmë. Do të flasim për projektuesin, arkitektin, dhe ai ka një vend të shquar kur flasim për urbanistikën dhe arkitekturën, por do të flasim edhe për zbatuesit, inxhinierë, teknikë, mjeshtër e punëtorë, dhe këta janë shumë, do të flasim edhe për prodhuesit e materialeve të ndërtimit, pse edhe të gjithë këta krijojnë. Është puna si në një pjesë teatrale: flasim për autorin, por ajo merr jetë edhe në punën krijuese të regjizorit, të aktorëve, të piktorit e kështu me radhë. U ndala pak në këtë çështje, sepse m'u krijua përshtypja sikur u fol në mënyrë të njëanshme; nuk u fol edhe për punën



krijuese të zbatuesve, si dhe prodhuesve të materialeve të ndërtimit, sikur ajo nuk është punë krijuese, kurse mendoj se është dhe duhet konsideruar e tillë. Në qoftë se sot nuk është akoma një punë vërtet krijuese dhe, me sa duket, kemi vrejtje, atëherë le ta bëjmë të tillë. Ka këtu një problem: si ta bëjmë dhe si ta ndërtojmë të gjithë punën tonë në mënyrë që të gjithë, që nga projektuesi deri te zbatuesi ose prodhuesi i materialeve të ndërtimit, të bëjnë punë krijuese, të ndihmojnë e të plotësojnë njeri tjetrin? Duhet këtu bashkëpunim midis këtyre forcave. Duhet që ata të mos pengojnë dhe të mos dëmtojnë punën e njeri tjetrit. Kur bëhen projektet në zyrat e projekteve të mos pretendohet që ato të jenë të plota, të mos ngulet këmbë që të zbatohen pa u lëvizur një vizë më vonë, por të ndiqen edhe gjatë procesit të zbatimit, të kërkohet mendimi dhe të pranohen sugjerimet e inxhinierëve e punëtorëve të zbatimit. Sigurisht është fjala për ato mendime dhe ato sugjerime që e përmirësojnë veprën dhe bëhen nga pozitat e krijuesit dhe jo për mendime e vrejtje në dëm të veprës, që bëhen nga injoranca, pozitat e burokratizmit etj. Kjo ka edhe një logjikë: kur projektton, shkalla e njohjes e projektuesit është barazi me vlerën x, kurse në procesin e punës praktike edhe shkalla e tij e njohjes rritet, pasurohet edhe me eksperiencën e të tjerëve, prandaj mund të bëhen plotësime në projektet dhe kjo do të ishte e mirë.

Duke konkluduar mbi këtë çështje desha të them se mendimi që duhet të na udhëheqë është ai si në revolucionin tekniko-shkencor në tërësi, siç është thënë nga shoku Enver, se atë, si çdo revolucion tjetër, do ta bëjnë masat. Për këtë qëllim propozoj që çështjet për të cilat po diskutojmë në këtë mbledhje, të mos mbeten vetëm në mesnesh, në rrethet e arkitektëve e disa të tjerëve, por ne t'i çojmë edhe te zbatuesit, edhe te prodhuesit e materialeve të ndërtimit.

2) Çështja e dytë për të cilën desha të diskutoj është se edhe në këtë fushë, në atë të urbanistikës e arkitekturës, si në çdo fushë tjetër, dalin disa raporte e kontradikta, të cilat duhet t'i vendosim dhe t'i zgjidhim drejt dhe se rruga për këtë është po ajo e njohura: lufta me koncepte frenuese dhe të gabuara, lufta me vështirësitë materiale e teknike, si dhe lufta për organizim më të mirë të punës, në përshtatje me kushtet dhe rrethanat në periudha të caktuara. Konkretisht e kam fjalën:

a) Te raporti midis anës funksionale të objektit që projektojmë e ndërtojmë me atë të paraqitjes, anës esteti-

ke. Gjendemi këtu përpara raportit të njohur midis përmbajtjes dhe formës. Ata qëndrojnë bashkë, në unitet, por kanë edhe të kundërtat midis tyre. Në qoftë se shikojmë njerën anë, bie fjala anën funksionale dhe lemë pasdore paraqitjen, e dëmtojmë veprën, nuk kemi më një veprë arti, preket këtu edhe ana funksionale. Nuk duhet harruar se arkitektura është shkencë teknike, por është edhe art. Në të kundërtën, në qoftë se priremi drejt paraqitjes dhe lemë pas dore anën funksionale, gabojmë përsëri, biem në formalizëm dhe, kuptohet, ne nuk mund të jemi edhe për këtë. Ne duhet të gjejmë atë lidhje, atë raport të drejtë midis tyre, dhe të luftojmë kundër të dy prirjeve kur njera mohon ose le pas dore tjetrën. Përmbajtja, ana funksionale, është kryesore, ajo udhëheq, por në asnjë mënyrë nuk mund të mos përfillim edhe paraqitjen. Aktualisht më e përgjithshme është prirja për anën funksionale ose ekonomike, por ka ardhur koha dhe janë krijuar kushtet t'i hapim rrugë edhe së dytës, paraqitjes, anës estetike. Në fakt edhe ka filluar kjo punë, kohëve të fundit ka më shumë përpjekje në këtë drejtim, ka edhe disa rezultate. Veprat që u përmendën këtu, si Shtëpia e oficerëve ose Shkolla e partisë, etj. flasin mjaft qartë për këtë. Sigurisht duhet luftuar edhe kundër ndonjë teprimi ose shkarjeje në të dytën, megjithëse është akoma shpejt të flasim për këtë, por nuk duhet ta harrojmë.

b) Ose marrim raportin dhe kontradiktën midis dëshirave e kërkesave për ndërtime të bukura nga një anë, me mundësitë materiale e teknike reale sot. Edhe këtu vihen re dy prirje: më e përgjithshme aktualisht është prirja për të thënë: «këto janë mundësitë tona materiale e teknike, prandaj nuk mund të mendojmë për ndërtime të bukura sot, mos kërkoni qiçra në hell». Jo rrallë nxjerr kokë edhe prirja tjetër për të mos marrë parasysh kushtet e mundësitë reale. Nuk do të isha dakord me një mendim që u shpreh këtu se e dyta, paraqitja e veprës, duhet t'i nënshtrohet verbërisht të parës, kushteve e mundësive materiale e teknike. Mendoj se të dyja mund dhe duhet të lozin një rol aktiv. Dëshirat dhe kërkesat për paraqitjen e veprës shtyjnë përpara dhe nxitin teknikën e prodhimin, duke vënë kërkësa përpara tyre. Nga ana tjetër, rritja e mundësive materiale e teknike lejon dhe shtron kërkësa të reja përpara projektuesve për paraqitjen më të bukur të veprave, për anën estetike. Pra të dyja lozin një rol aktiv dhe të dyja shtyjnë përpara njera tjetrën.

c) Po kështu mund të përmendim raportin dhe kontradiktën midis projektuesit dhe zbatuesve. Më lart, në fi-



llim shpreha mendimin tim mbi këtë çështje, por dua të shtoj edhe dy ide plotësuese: e para, kur flitet për ndërtimin e një vepre, duhet të përpqemi dhe janë të gjitha mundësitë për t'u bërë të gjithë krijues, krijon projektuesi, por krijojnë edhe zbatuesit; e dyta, nuk do të ishte e drejtë të vazhdohet me qarjet e njerës palë për tjetrën, e projektuesit për zbatuesit, ose anasjelltas, por secili të bëjë punën e vet.

Mund të ketë, dhe sigurisht ka, edhe kontradikta të tjera, që duhet t'i zgjidhim në procesin e luftës për të çuar përpara çështjet e urbanistikës dhe arkitekturës, për të cilat po diskutojmë, por nuk po ndalemi në të gjitha. Këto quajta më kryesoret.

3) Çështja e tretë, për të cilën desha të diskutoj është kjo: t'i rrahim mendimet tona, përmes ballafaqimit dhe ndeshjes së tyre të gjejmë të vërtetën, më të drejtën, atë rezultante për të cilën foli shoku Enver në fjalimin e tij të njohur në Shkollën e partisë, dhe të luftojmë subjektivizmin si dhe çfaqjet e egoizmit profesional, duke eksperimentuar me guxim. Vlera e madhe e këtij diskutimi tonë sot qëndron edhe në atë që po i themi mendimet, ato që kemi në kokë, po dalin kështu ç'mendime ka në tërësi mbi çështjet e urbanistikës dhe të arkitekturës, dhe ç'mendon njeri e tjetri. Mbase të gjitha sa thuhet nuk janë plotësisht të drejta, ka edhe trajtime të njëanëshme, por e rëndësishme është që tani dijmë më mirë mendimet dhe shqetësimet kryesore, që ka mbi çështjet që po diskutojmë. Po a ka subjektivizëm lidhur me këto çështje dhe a ka egoizëm profesional në gjykimet tona për punët e njerit dhe tjetrit? Sigurisht ka. Si intelektualë nuk u shpëtojmë dot këtyre shfaqjeve. E rëndësishme është të vihemi në luftë kundër tyre, të krijojmë atmosferë kundër tyre. Në Tiranë kemi sot tri qëndra të mëdha projektuese, e kam fjalën për Institutin e Projektimit, Universitetin Shtetëror të Tiranës (degën e ndërtimit) dhe Byronë e Projektimit pranë Komitetit Ekzekutiv të K.P. të Tiranës. Çfarë ndodh? Në fakt, secila ka punën e vet dhe bën punën e vet, por ndodh që ndeshemi me qëndrime jo të hieshme, disa herë mospërfillëse për punën e njerit dhe të tjetrit, që arrijnë deri në pengesa që i nxjerrim njerit dhe tjetrit; kjo më e theksuar është në kuadrot e tyre drejtuese, të cilat flasin për ato shfaqje që zumë në gojë më lart. Disa herë është dashur të ndërhyjmë për t'u prerë rrugën këtyre shfaqjeve dhe për të hequr pengesat që i viheshin një projekti ose për të mbrojtur një projektues nga akuza të pavend e tende-

cioze. Që të ketë mendime të ndryshme, të bëhen diskutime, të ketë edhe kritika për projekte e vepra që ndërtojmë, kjo është krejt normale, bile kjo kërkohet medoemos, si rrugë zhvillimi, siç u shpjegua edhe më lart, por tjetër janë diskutimet dhe kritika e hapur për një projekt ose një vepër të caktuar, tjetër janë shfaqjet e subjektivizmit dhe të egoizmit profesional. Ndërsa jemi plotësisht për të parat, pa të cilat nuk ka zhvillim, jemi krejt kundër të dytave, sepse pengojnë ecjen përpara. Po kujtoj këtu vështirësitë që u ndeshën dhe pengesat që u nxuarën për një projekt në Institutin Bujqësor dhe një tjetër në Burrel, të projektuar nga pedagogë të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe të kundërshtuar nga shokë në Institutin e Projektimeve pa ndonjë bazë, nën pretekstin e shpenzimeve të tepërta. Nuk është e drejtë të zihen pozita të tilla: sikur një palë janë ngarkuar të lozin rolin e postbllokut dhe të ruajtjes së pasurisë së shtetit, sikur vetëm ata qenkan për kursimet dhe zbatokan kështu drejt politikën e partisë në ndërtimet, pa çka se duke e zhveshur veprën nga çdo gjë e bukur bëjnë një dëm të madh, edhe në paraqitjen e saj, edhe në anën ekonomike të saj; edhe sikur disa të tjerë mendojnë dhe veprojnë vetëm në të kundërtën. Për të përcaktuar ç'është e drejtë ose jo, në të gjitha rastet rruga më e mirë është diskutimi, ndeshja e mendimeve, kritika e hapur në mbledhjet, takimet si ky yni sot, në shtyp, dhe jo qosheve e skutave, si dhe eksperimentimi me guxim.

4) Dua të ndalem, në fund, në dy mendime, ose më mirë në dy kërkesa apo dëshira megjithëse nuk e di sa do të jenë të drejta ato që do të them.

a) Folën disa shokë, edhe në raport u fol, për lidhjen e arkitekturës me skulpturën dhe pikturën monumentale e dekorative, për nevojën e atij bashkëpunimi që duhet të krijojmë midis arkitektëve me skulptorët dhe piktorët. Unë do të isha dakord shumë për një gjë të tillë dhe, në qoftë se do të më lejohet, do të thosha se e kërkoj një gjë të tillë, bile pyes: pse nuk është bërë deri tani? Dhe do të shtoja se i ka kaluar koha, kemi mbetur, ca si prapa, më tutje nuk mund të vazhdohet kështu, nuk duhet të qëndrojmë në vend. Sigurisht kjo është e lidhur me disa shpenzime plus, por a nuk do të ishte më e drejtë të mendojmë, dhe duhet të mendojmë seriozisht, për të ulur diçka nga shpenzimet diku tjetër, bie fjala në strukturat kaq të rënda që kemi sot dhe këtu ka vend për ulje të mëdha, siç porositi partia, dhe të shpenzojmë diçka në fillim fare pak dhe më vonë më shumë për skulpturën dhe pikturën mo-



numentale e dekorative? E vërteta është se disa përpjekje, ose eksperimente që u bënë nuk dhanë ndonjë rezultat, jo aq për faj të vetë arkitektëve dhe skulptorëve e piktorëve se sa nga qëndrimi i ftohët i investitorëve. Por sidoqoftë nuk duhet dekurajuar, përkundrazi duhet ngulur këmbë, jo vetëm për të bindur investitorët për dobinë e tyre, por edhe në qoftë se gjatë punës, në praktikë mund të ndodhemi përpara ndonjë dështimi. Është krejt me vend të themi se edhe kështu si është sot ky Pallati i madh i kulturës këtu në Tiranë ku jemi mbledhur, dhe ku jashtë e brenda shohim vetëm mermerin e ftohët, kolonat ose muret krejt të zhveshura, nuk shkohet më. Jam i mendimit, dhe këtu nuk them asgjë të re, se futja e skulpturës, e pikturës monumentale e dekorative në veprat tona, sigurisht në ato më të rëndësishmet, lidhja e arkitekturës me këtë degë të artit do t'i bënte më të bukura dhe do ta plotësonte paraqitjen e godinave dhe të qyteteve tona, do t'i bënte ato më shumë shprehëse të ideve e të mendimit të kohës, do të bënte që ato të kryenin më mirë edhe një rol edukues për masat. Jam krejt i bindur se duke ecur në këtë rrugë, kjo do të ndihmohej, edhe vetë skulptura e piktura do të kishin ecje më të shpejta e më të suksesshme në këto degë të artit dhe të kulturës sonë kombëtare, sepse duke shtruar kërkesa ndaj tyre, për t'iu përgjigjur, ato do të zhvilloheshin më shpejt edhe me siguri me një nivel më të lartë artistik. Kjo do të bënte që godinat e mëdha dhe kryesore të mbanin fort vulën e kohës. Bie fjala, do të fillojë ndërtimi i hotelit të madh në qendër të Tiranës. Sa bukur do të ishte që në fasadën e tij të kishte një mozaik të madh ku të paraqitej revolucioni ynë në marshim. Atëhere vepra do të na kujtonte gjithmonë se ajo u ndërtua në periudhën e revolucionarizimit të gjithë jetës së vendit, do të barte kështu me shekuj vulën e kohës kur u ndërtua.

b) Në raport u fol shkarazi për arkitekturën industriale, dhe nuk di pse kaq shkarazi, por duket për arsye të prapambetjes që kemi akoma në këtë fushë. Ndonjë nga shokët folës u zgjerua pak më shumë, por përsëri jo mjaftueshëm. Dihet se shumë arkitektë të mëdhenj me ide përparimtare, të cilët i kanë shqetësuar kushtet e vështira të klasës punëtore në botën kapitaliste, ato salla të errëta, plot tymra, të ngushta dhe me lagështirë, janë marrë me ndërtimet industriale dhe janë përpjekur të zgjidhin disa probleme lidhur me kushtet dhe ambjentet e punës. Nga ana tjetër, dijmë, gjithashtu, se sot, nën presionin e luftës së punëtorëve për kushte më të mira pune,

si dhe të nxitur nga interesi i vetë kapitalistëve për të rritur sa më shumë shfrytëzimin përmes intensitetit të punës, në botë ka marrë një zhvillim të madh arkitektura industriale. Po tek ne si qëndron kjo punë? Për arësyen e parë se ne, në kushtet e socializmit, duhet të kujdesemi shumë herë më tepër për njeriun, për kushtet e punës dhe krijimin e ambjenteve sa më të kulturuar për punëtorët, edhe për arsye se atje ku ka ambjente të kulturuar me dritë e ajër të bollshëm, pastërti etj. edhe rendimenti i punës është më i lartë, ne duhet të mendohejmë dhe të veprojmë më drejt dhe me shumë kujdes në këtë drejtim. Ka disa arsye që ne e kemi lënë pak si pas dore këtë lloj arkitekture, ndër të cilat kryesore është sepse prej disa vjetësh projektet e shumë veprave industriale ne i kemi marrë nga jashtë, pra jemi marrë pak me këtë punë, pastaj ka ndodhur që edhe kur jemi marrë, për disa vepra të vogla të projektuara nga ne, për arsye të eksperiencës së vogël që kemi patur, nuk kemi mundur të çajmë rrugë dhe të themi ndonjë fjalë me peshë. Sidoqoftë, mendoj se nuk duhet të vazhdojmë më kështu, koha e kërkon dhe mundësitë i kemi për të bërë më shumë edhe në këtë drejtim, bile me një nivel të denjë për epokën tonë.

(Marrë me stenogram)

## KRISTAQ RAMA

### Të luftojmë për një sintezë të vërtetë të arkitekturës me skulpturën

Shembujt më të mirë të trashëgimisë njerëzore në fushën e ndërtimeve, bile do të thoshja që nga vendbanimet e para, të cilat banori i lashtësisë i zbukuronte me figura e dekoracione të ndryshme, e gjer në periudhat e ndritura të zhvillimit të arkitekturës në epokat e mëdha, dëshmojnë se arkitektura dhe artet figurative kanë tërhequr dhe në shumë raste kanë plotësuar njeri-tjetrin.

Kjo kërkesë njerëzore është në vetë natyrën e arkitekturës dhe arteve, sepse me ndërtimet që projekton njeriu, bashkë me funksionin dhe leverdinë, ka pasur dhe duhet të ketë parasysh gjithmonë të bukurën, por kjo e bukur duhet të kuptohet drejt dhe të jetë kurdoherë shprehja e konceptit të kohës mbi të bukurën, estetikën.



Arkitektët e vërtetë dhe teoricienët e tyre gjithmonë e kanë lidhur të bukurën në arkitekturë me leverdinë dhe logjikën e ndërtimeve.

Që nga mesjeta, në 10 librat mbi ndërtimet Leon Batista Alberti shkruan:

«Unë dua që gjithmonë dhe në çdo gjë arkitektët të kenë dëshirën për të vënë në radhë të parë leverdinë (funksionale sigurisht) dhe kursimin. Bile, edhe atëhere kur çdo gjë bëhet për hir të zbukurimit, arkitekti duhet të ndërtojë në mënyrë të tillë që të mund të mos mohohet se çdo gjë është bërë para së gjithash për hatër të leverdisë».

Mendim i drejtë dhe racional.

Pra, ne që pranojmë këtë tezë, mund të pohojmë se për hatër të leverdisë është e pamohueshme edhe e bukura. Dhe nuk ka si të jetë ndryshe. Arkitektura përbën ambientin kultural dhe material ku jeton dhe punon njeriu dhe si e tillë ajo ndikon në mënyrë të fuqishme në formimin e tij fizik dhe estetik.

Në etapat e ndryshme të zhvillimit të saj, historia e artit (dhe jo rastësisht, kjo fillon në çdo epokë me arkitekturën) na jep shembuj të formave nga më të ndryshmet të sintezës arkitekturë-skulpturë. Kjo tregon se sinteza e arteve është një fenomen estetik historikisht i ndryshueshëm. Por, sado të ndryshme dhe origjinale të jenë format e sintezës së skulpturës dhe arkitekturës ato zhvillohen në caqet e disa ligjeve të përgjithëshme, që, në një mënyrë ose në një tjetër, përcaktohen nga vetë specifika e këtyre arteve. Rilevimi dhe njohja e këtyre ligjeve paraqet një interes të madh jo vetëm teorik, por edhe praktik, sidomos për ne që jemi akoma në fazën e parë të përpjekjeve për krijimin e sintezës në arkitekturën tonë kombëtare.

Para së gjithash, sintezës i ndihmon zhvillimi i plotë i mjeteve specifike të shprehjes së të dy gjinive të artit.

Në praktikën botërore ka ekzistuar mendimi jo i drejtë i nënshtimit apo i nivelimit të gjinive të ndryshme të arteve që përbëjnë sintezën. Kjo pikëpamje presupozon mohimin nga mjetet shprehëse si të skulpturës ashtu dhe të arkitekturës.

Po kështu edhe sinteza eklektike e viteve të mbasluftës, që gjeti zhvillim në disa ndërtime të Europës lindore dhe që pat ndonjë shprehje edhe në ndërtimet tona të viteve 50, mohon në mënyrën e saj vetitë specifike të arkitekturës si art funksional dhe të skulpturës si art i formave plastike që shpreh idetë e kohës. Në ato ndërtime të këtij lloji, kryesisht në ato social kulturele dhe në disa

ndërtesa banimi janë përdorur krejt pa vend e pa logjikë elementë të huazuar nga stilet e kohrave të shkuara, që nuk kanë asnjë lidhje shpirtërore me psikologjinë, kërkesat dhe aspiratat e ditëve tona. Vërshimi i kapiteleve pseudo-jonike, dorike e korinthike, balkonet brenda balkoneve, imitimet fallco të materialeve të forta janë një butafori e tërë stilistike, një eklektizëm i shëmtuar, që i kushtoi arkitekturës sonë të re jo vetëm nga ana ekonomike, por ç'ka është më e keqja, ndikoi disi edhe në formimin e një shije të dyshimtë. Gjithë ky arsenal mjetesh, shpesh herë bëhej nën etiketën e krijimit të një arkitekture me motive nacionale. Kjo fazë e kapërcyer relativisht shpejt pati vetëm një të mirë të vogël: eksperiencën e hidhur, të cilën arkitektët bënë mirë që nuk e harruan shpejt.

Siç tregojnë shembujt më të shquar të sintezës së vërtetë, lidhja e skulpturës me arkitekturën bëhet organike atëhere kur këto zhvillojnë plotësisht mundësitë e tyre, vetëm atëhere ato plotësojnë dhe pasurojnë njera tjetrën duke e konsideruar, në radhë të parë vetë arkitekturën një plastikë më vete.

Zakonisht në veprat sintezë të artit ka një bazë dhe ide udhëheqëse. Duke punuar një monument, sado i madh qoftë ky, skulptori udhëheq arkitektin, kurse në krijimin e sintezës arkitekturë-skulpturë, roli udhëheqës i përket arkitektit.

Arkitektura është baza praktike e sintezës, strumbullari që bashkon artet figurative dhe të aplikuara në funksion të qëllimit.

Roli i arkitekturës në sintezë është i shumëanshëm. Ajo bëhet, në këtë rast baza materiale dhe ideore për skulpturën monumentalo-dekorative dhe pikturën murale. Reliefet dhe afresket, praktikisht nuk mund të ekzistojnë pa atë. Nga arkitekti varet kryesisht roli i sintezës, nga ai varet në se do të futet skulptura organikisht në arkitekturë, mbasi atij i përket plani i vendosjes së skulpturës në objekt, bile dhe zgjidhja e përgjithëshme e ansamblit skulptural. Ai parashikon mashtabin e skulpturës dhe karakterin e saj kompozicional, por njohja e rolit udhëheqës të arkitektit me krijimin e ansamblit monumental nuk zvogëlon rolin e skulpturës dhe nuk ul aspak karakterin krijues të punës së tij, përkundrazi detyra e përcaktuar dhe e formuluar qartë, e diktuar nga vendi gjithnjë i ndryshëm dhe origjinal që do të zerë skulptura në ndërtesën e dhënë, ve në lëvizje mendimin dhe fantazinë e artistit.



Siç dihet, kriteret për realizimin e sintezës nuk mund të përcaktohen një herë e përgjithmonë dhe të vendosen ca rregulla strikte, të përpunuara në bazë të ndonjë stili të së kaluarës, sepse sinteza e re bazohet në përmbajtjen e re, format e saj janë të lidhura me botkuptimin e epokës.

Përpyekjet për unitetin organik të skulpturës me arkitekturën, në sigurisht nuk i kuptojmë ngushtë si përpyekje për të futur skulpturën në çdo ndërtim. Ky do të ishte një kuptim akademik i këtij problemi, sepse objektet arkitektonike mund të jenë shumë të bukura edhe pa elemente e dekoracione skulpturale. Këtu nuk ka asgjë kontradiktore, sepse vetë arkitektura është art plastik, por deri sa arkitekti i drejtohet skulpturës, ai duhet t'u nënshtrohet kërkesave themelore të sintezës, domethënë skulptura duhet të futet organikisht në kompozimin e ndërtesës, të luajë në të një rol arkitektonik dhe të jetë teknologjikisht e lidhur me arkitekturën duke tingëlluar në unison me të.

Në lidhjen funksionale me arkitekturën, skulpturës i përpunohen dhe i thellohen shumë veti specifike. As skulptura formaliste dhe as ajo naturaliste nuk lidhet me arkitekturën, pasi skulptura monumentale kërkon një përmbajtje të madhe dhe të qartë. Përpyekjet për sintezën e skulpturës dhe arkitekturës janë të lidhura me përpyekjet e dyfishta për thellimin, zhvillimin dhe stabilizimin si të arkitekturës ashtu dhe të skulpturës sonë kombëtare.

Së fundi, problemet e arkitekturës duhet t'i shohim në tërë kompleksitetin e tyre, gjer në ngjyrat që duhet të kenë ndërtesat tona. Por duke mos dhënë Tirana shembullin e saj në këtë drejtim, sepse s'ka suva, apo vetëm tulla silikate, mbetet të pranojmë të paktën atë që është e dukëshme dhe e metë e ndërtimeve në kryeqytetin tonë, mungesën e kriterëve të drejta dhe shkencore në studimin e kuartaleve të banimit me tërë komponentet që i duhen njeriut të ditëve tona. Vetë fakti që Tirana e sotme prej 200 mijë banorësh ka mbetur me dy sheshe qendrore të trashëguar nga e kaluara, pa mundur të krijojë pika të tjera që t'i përgjigjen intesitetit të zhvillimit social, ekonomik e kultural të kryeqytetit, dëshmon në mënyrë të padiskutueshme për probleme ende të pazgjidhura nga urbanistika jonë që, si rrjedhim, përjashton edhe mundësinë e zhvillimit harmonik të gjinive të arteve monumentale dekorative.

## Arkitekti dhe mobiljet

Shfrytëzimi i mirë me anë të mobilimit i hapësirave të brendëshme të banesave ndikon shumë në realizimin e qëllimeve të arkitektit.

Qysh në fazën e projekt-idesë arkitekti duhet të mendojë për krijimin e ambjenteve të këndëshme me anë të mobilimit, dhe kështu projektin duke ju referuar një ose disa tipave mobiljesh që do t'i shkonin dhomës apo kuzhinës me përmasat që ai ka dhënë.

Por në realitet ideja që e ka shtyrë arkitektin t'i japë një formë apo një tjetër ambjentit keqkuptohet, dhe çdo banor e zgjidh në mënyrë individuale mobilimin e ambjentit ku jeton. Ideja e arkitektit keqkuptohet ose më mirë nuk realizohet siç duhet, sepse këtyre ambjenteve u duhen përshtatur ato tipe mobiljesh që ka menduar arkitekti.

Më konkretisht: Cilësia e ndërtimeve tona ka shkuar duke u rritur hap pas hapi dhe objekt pas objekti. Në qoftë se përpara takoheshin tek tuk banesa në kuzhinat e të cilave kish nuke ose aneks, tani është bërë e domosdoshme dhe nuk gjen ndërtesë banimi ku të mos ketë aneks pranë dhomës së ditës. Duke caktuar përmasat e aneksit arkitekti i përmbahet një lloj mobilimi të caktuar, i cili është i mjaftueshëm dhe u përshtatet këtyre përmasave. Por në aneks vihen tavolina të madhësive të ndryshme, dollapë kuzhine nga më të ndryshmit, kjo patjetër çon në krijimin e ambjenteve që të «marrin frymën» dhe që nuk janë aspak të këndëshëm nga ana estetike.

Është e nevojshme, pra, pjesmarrja e arkitektëve, në masë të gjerë në projektimin dhe krijimin e mobiljeve të reja që të jenë ekonomike dhe estetike, në këtë mënyrë do të ekonomizohen më mirë hapësirat e shfrytëzueshme dhe do t'i lihet vend më tepër kultivimit të interjereve të bukur dhe edukues.

Përdorimi i anekseve i ka çuar një hap të madh përpara ndërtimet tona, duke formuar ambjente si dhoma e ditës, që është shumë e nevojshme dhe në një shumicë rastesh përdoret si ambjent pritjeje. Një hap i madh ky në ngritjen e mirëqënies së punonjësve tanë.

Të shohim pak mobilimin e këtyre ambjenteve, d.m.th. të dhomës së ditës dhe të aneksit. Në një masë shumë të



madhe përdoren për mobilimin e aneksit raftet e kuzhinës, e më të zakonshmit që takojmë dhe në treg janë me përmasa 1x0,60x1,20 m, përmasa këto shumë të konsiderueshme, që zenë në një aneks të zakonshëm 1,20x2,40 m, 10% të volumit të përgjithshëm dhe gati 20% të sipërfaqes së shfrytëzueshme. Volumi i shfrytëzuar i këtyre rafteve në pjesën dërmuese nuk e kalon 40% të volumit të përgjithshëm të raftit. Kemi pra një humbje shumë të madhe si nga ana e hapësirës ashtu dhe nga sipërfaqja e aneksit që duhet shfrytëzuar në maksimum.

Projektimi dhe vënia në shfrytëzim e rafteve të varur në mur, jo vetëm që liron hapësirën e shfrytëzueshme të aneksit, por i le vend ekonomizimit të saj. Duke përdorur raftet e varur, ne reduktojmë praktikisht në zero sipërfaqen që zënë ato në pjesën më të nevojshme të aneksit dhe krijojmë mundësi për organizimin më të mirë të hapësirës nga ana estetike. Shfrytëzimi i hapësirave të brendëshme të këtyre rafteve mund të bëhet në mënyrë më racionale se sa tek raftet e mëdhenj duke kursyer në këtë mënyrë lëndën e drurit, si lëndë të parë deficitare.

Banori, si «*homo economicus*», përpiqet ta racionojë sa më mirë hapësirën e banesës së vet. Shohim, për shembëll, në mjaft raste që hapësirat poshtë lavamanëve ai i ka shfrytëzuar duke i kthyer në rafte të përdorshëm sipas nevojës. Arkitektët mund të krijojnë mobilje që t'u përshtaten këtyre hapësirave, dhe mund t'i bëjnë ato më të bukura, më funksionale dhe më ekonomike.

Në dhomën e ditës gjejmë një element shumë të përhapur e pothuajse tradicional, e kam fjalën për minderin apo nimin, i zgjidhur nga njerëzit në mënyrat më të ndryshme e në shumicën prej tyre i varfër estetikisht. Ky element duhet kanalizuar nga arkitekti. Projektimi i divanëve apo poltronave të tipeve të ndryshme për dhoma me përmasa të ndryshme, të adoptueshëm këta në krevate për familjet me shumë persona, është detyrë që u bie përsipër arkitektëve, pasi këta i krijojnë këto ambjente.

Projektohen dhe ndërtohen me dhjetra billoqe banimi nga të katër anët e atdheut tonë, të shumëllojshme janë seksionet që përdoren në to, por mobiljet janë po ato të përdorura në seksionet e vjetra, të viteve të mëparshëm.

Një ndihmë të madhe mund të na japë arkitektura popullore në ekonomizimin dhe mobilimin e hapësirave të banimit. Raftet e murit apo musandrat, që janë përdorur me aq zgjuarësi dhe shije në arkitekturën tonë popullore, kanë gjetur pak përdorim në ndërtimet e tanishme, megjithëse këta elementë mund të krijojnë sipërfaqe të lira

dhe të pastra. Përdorimi i rafteve të murit në dhomat e ditës si dhe në dhomat e fjetjes bën të rritet sipërfaqja e banimit për çdo banor, duke ndikuar kështu direkt në rritjen e mirëqënies së punonjësve dhe kursen në një masë deri në 60% lëndën e drurit që harxhohet për bërjen e këtyre mobiljeve komplet në dru.

Koha shtron kërkesa të rëndësishme në drejtim të projektimit të mobiljeve, që këto t'u përshtaten në mënyrë elastike ambjenteve duke i ngritur këta të fundit nga ana estetiko-edukative dhe gjithashtu t'u përgjigjen ritmeve të fuqishme të zhvillimit të arkitekturës sonë të re.

MAKSIM MITROJORGJI

## Drejt një plasticiteti lirik në arkitekturë

Mendimet që do të shfaq në këtë diskutim janë akoma mendimet e një studenti dhe besoj se shokët do të më falin edhe ndonjë ide që mund të mos përputhet sa duhet me realitetin e jetës. Por unë, si gjithë shokët e mi, ëndërrojmë ta bëjmë vendin tonë sa më të bukur duke dhënë kontributin tonë në fushën e arkitekturës.

Siç dihet, orientimet e partisë në fushën e ndërtimit janë që ne të ndërtojmë mirë, lirë dhe bukur. Të projektojmë për të sotmen dhe perspektivën. Shoku Enver na porositi ne arkitektëve... «**Të mendojmë dhe të punojmë që ato që ndërtojmë dhe prodhojmë sot të jenë të atilla jo vetëm sa për të plotësuar nevojat imediate, por të kënaqin edhe shijen dhe jo vetëm të brezave të sotëm, por edhe të atyre të ardhshëm.**»

Këto orientime kanë udhëhequr ndërtimet tona, i udhëheqin edhe sot e do t'i udhëheqin dhe në të ardhmen. Ne kemi vënë re se këto parime kanë gjetur zbatim dhe, në përputhje me kohën, kanë ardhur duke u thelluar e zhvilluar më tej krahas rritjes së mundësiave tona materiale e teknike si dhe të pasurimit të eksperiencës së arkitektëve tanë. Ne na gëzon fakti që shumë nga pedagogët tanë arkitektë, prej të cilëve kemi mësuar shumë gjëra nga njeri vit e pesëvjeçar tek tjetri, kanë projektuar ndërtesa të bukura për të cilat bëhet fjalë në referatin e shokut Sokrat Mosko.



Por referati ngre edhe shumë probleme të rëndësishëm për zbatimin edhe më të mirë të orientimit të partisë, për ndërtimin mirë, lirë e bukur, për të sotmen dhe perspektivën. Ajo që deri dje quhesh një lluks, sot është bërë një nevojë. Vetë zhvillimi ynë socialist, rritja e kulturës së masave kërkon që ne orientimet e partisë t'i thellojmë, t'ua përshtasim kushteve të reja, kërkesave të reja, pra të studjojmë, të kërkojmë e të projektojmë vepra gjithnjë më të bukura, më të mira e më të lira. Ne nuk duhet të ndërtojmë sot vetëm lirë dhe me një perspektivë të ngushtë nën justifikimin se duhet t'i bëjmë të lira, por edhe bukur, sepse ndryshe do të detyrohemi t'i prishim pas 10 vjetëve dhe kështu do të na dalin më të shtrenjta. Siç ndodhi në Fier me disa ndërtesa banimi, të cilave ju shtua një kat dhe mbetën si çibane në trupin e atij qyteti ku sot ngrihen edhe shumë ndërtesa të bukura. E lira nuk është në kundërshtim me të bukurën e të mirën, kur ato studjohen gjatë projektimit në unitet. Çështja është që të kërkohet vazhdimisht për t'i harmonizuar ato. Shtëpitë e sotme të banimit të Unazës nuk kushtojnë më shumë se ato që janë ndërtuar para 10 vjetëve në Tiranë. Po këto të sotmet janë më të bukura, sepse aty është derdhur më shumë fantazi dhe është kërkuar më shumë në drejtim të paraqitjes estetike.

Me të drejtë theksohet nga referuesi nevoja e larmisë kompozicionale dhe e kërkimit të formave nga më të ndryshmet të shprehjes arkitektonike. Për këtë mendoj se sot, kur ndërtohet kaq shumë, ndihet nevoja e një konceptimi më lirik dhe më plastik të formës arkitektonike për të zhdukur monotoninë dhe për të evituar përsëritjet. Ne rrojmë në një sistem shoqëror socialist, ku çdo gjë bëhet për masat punonjëse dhe ju shërben atyre, në një sistem që i ngre për ditë masat drejt shkallave më të larta të shkencës, teknikës dhe kulturës. Në shoqërinë tonë vjen gjithmonë duke u thelluar nevoja për të bukurën, për lirikën, për romantikën, lind nevoja për shumëllojshmëri dhe variacion. Këto na shtyjnë drejt kërkimit të formave plastike, të formave të lira dhe drejt një koncepti më lirik për to. Këtu nuk është fjala për shumëllojshmëri brenda ndërtimeve katërkëndëshe, por jashtë tyre, për forma eliptike, harkore, jashtë këndit të drejtë. Kjo nuk është ide e re. Për këtë është ndjerë nevoja gjatë gjithë kohrave. Kjo nuk është as pronë e disa vendeve dhe as e disa arkitektëve, sepse çdo popull ka traditat e tij në këtë fushë, të cilat i shfrytëzojnë në mënyrë krijuese arkitektët e sotëm. Edhe ne kemi traditat tona të një krijimtari popullore me for-

ma të lira lirike, të bukura, jashtë këndit të drejtë. Në monumentet tona të arkitekturës shihet qartë ky plasticitet i formës. Në ndërtimet karakteristike të popullit, në ato që janë edhe të bukura, gjejmë përdorimin e harkut, lojën e volumeve, në ndërtimin bazë, përdorimin e kupolave, strehëve, verandave etj. Për deri sa populli ka krijuar elementet plastike me materiale vendi, atëhere ne që kemi sot betonin mund të krijojmë forma arkitektonike plastike shumë më të bukura, elegante e të shumëllojshme duke shfrytëzuar e ngritur në art traditat tona popullore.

## VIOLENTINA SHEHU

### Jo spontaneitet në mobilim

Mobilimi i interjërimit duhet të projektohet i tillë që të jetë sa më funksional si për punë ashtu edhe për nga ana estetike.

Që një interjër të jetë i këndëshëm edhe i qetë, mobilimi i tij duhet të bëhet sa më i lehtë dhe sa më i larmishëm. Kjo si për ndërtesa shoqërore e administrative ashtu edhe për shtëpinë e banimit. Mobilimin e interjërimit nuk duhet t'ja lemë spontaneitetit, sepse do të ndodhë ashtu siç ndodh shpesh, që në objekte të ndryshme shoqërore ndeshemi me interjërë monotone dhe jo shumë funksionale. Shpesh në institucionet shtetërore shohim një vendosje të shregullt dhe pa kriter të mobiljeve; në të njëjtin ambient vendosen mobilje të stive dhe madhësive të ndryshme. Rastis që në një dhomë të vogël të vendoset një tavolinë apo dollap i madh, që kushedi se për ç'ambjent është projektuar. Një difekt i tillë vihet re edhe në shtëpitë e kulturës, megjithëse këtu bëhet një mobilim më i studjuar. Kështu, p.sh., ndodh që kur projektohen dhomat e aktiviteteve kulturele masive ato konceptohen në mënyrë standart dhe harrohet që një dhomë e rrethit të teatrit ka kërkesa të tjera nga dhoma e pikturës, ashtu si edhe dhoma e muzikës ka kërkesa të tjera nga ajo e bibliotekës. Duke i injoruar këto kërkesa specifike, kur vjen puna për pajisjen e këtyre interjërëve, ata nuk bëhen sa duhet funksionale dhe estetike. Që në projektim arkitekti duhet ta bëjë të qartë dhe të dallojë dhomën e bibliotekës nga



salla e provave të baletit. Kështu nesër, kur të hyjnë njerëzit, të mos thonë: «Bëjnë bibliotekë këtë sallë, e cila sipas arkitektit është menduar për sallë teatri». Këtu faji s'është i punonjësit të shtëpisë së kulturës, por i arkitektit. Një studim edhe më i thellë i projektimit të interjërimit nga ana e arkitektit duhet bërë për spitalet tona, ku njerzit kanë nevojë të ushqehen me doza më të mëdha optimizmi, kurajoje, besimi, për të lehtësuar gjëndjen shpirtërore. Në mjaft institucione të tilla, si hotele, restorante, vemë re një vendosje pa kriter dhe pa estetike të tablove, pa folur për vlerën e tyre artistike që shpesh shpreh një shije vulgare. Më ka rënë rasti të shoh në një restorant turistik siç është ai i Shëngjinit një tablo tepër kaba dhe të zymtë që të zinte frymën, e cila në vend që të krijonte kënaqësi, të largonte nga ambjenti. E njëjta gjë vihet re edhe në godinën e banimit ku shohim të njëjtat mobilje, bile shpesh detyrohemi të bllokojmë ndonjë dritare për të vendosur dollapin. Kjo ndodh nga mosstudimi i interjërëve gjatë projektimit. Arkitektët edhe për mobilimin e interjërëve duhet të mendojnë e punojnë në mënyrë krijonjëse duke qenë gjithnjë në bashkëpunim me ndërmarrjet e prodhimit të mobiljeve.

## REALIZIME TE ARKITEKTURES SONE

*Fotografitë  
nga ATSH, Laboratori i M.Nd. etj.*

Banesa në Rrugën «M. Shyri», Tiranë  
ark. I. Prushi








**Pallati i Kulturës, Tiranë**  
ark. E. Dobi, S. Mosko, B. Daja, S. Pashallari

**Brendi e Pallatit të Kulturës, Tiranë**








Projekt i Pallatit të Sportit «Punëtori»  
Pallati i Sportit «Punëtori» Durrës

Projekt i Pallatit të Sportit «Punëtori»  
Pallati i Sportit «Punëtori» Durrës




Projekt i Pallatit të Sportit «Punëtori»  
Pallati i Sportit «Punëtori» Durrës




**Pallati  
i sportit  
«Punëtori»  
Durrës.  
ark.  
S. Mosko,  
R. Semini,  
P. Qafzezi**






**Klubi «Studenti», Tiranë**  
projekt i katedrës së arkitekturës  
së fakultetit të inxhinierisë

**Godina e Radiopërhapjes**  
ark. K. Sahatçiu







Shtëpia e kulturës, Çorovodë, ark. K. Çomi






Shkolla e partisë «V. I. Lenin», Tiranë  
ark. K. Çomi

Instituti Pëdagogjik dyvjeçar, Shkodër  
ark M. Pepa







Hyrja e një kinemaje në Elbasan  
ark. V. Pistoli

Shtëpi lindjeje e lavanderi, Kavajë









**Hotel «Turizmi», Fier**  
ark. I. Pashko, M. Pepa

**Hotel qendror, Përmet**  
ark. Gj. Kroqi






Ura e Gomsiqes  
imh. Gj. Gjadr



7 — Nëndori VI






**Uzina e pjesëve të ndërrimit për traktorë, Tiranë**


**Urë mbi Gjanicë, Fier.**





Fabrika e çimentos, Krujë.






**Kombinati i mishit, Tiranë**

**Banesa në hyrje të Tiranës  
ark. A. Lufi**








**Banesa në Çorovodë  
ark. M. Bega**

**Banesa në Lushnjë  
ark. M. Pepa**







**Banesa në sheshin «Stalin», Fier  
ark. S. Mosko**



**Banesa në Rr. «Kongresi i Përmetit», Tiranë  
ark. I. Prushi**






**Banesa në Elbasan**




**Shtëpi banimi, Burrel**






Banesa  
në Korçë  
ark.  
P. Kolevica





Shkolla «Emin Duraku», Tiranë  
ark. M. Velo

Lapidari i Heroit të popullit Misto Mame, Tiranë  
ark. M. Velo





# Ngjarje kulturale artistike

## FESTIVALI IV I KËNGËS DHE VALLES I FËMIJËVE TË KOPSHTEVE TË TIRANËS



Në kuadrin e 30-vjetorit të P.P.SH. dhe kongresit të saj të VI, pranë shtëpisë së mësuesit «Ali Këlmendi» u zhvillua festivali IV i këngës e valles me fëmijët e kopshteve të kryeqytetit.

Festivali i sivjetshëm shënoi një ngritje të rëndësishme në krahasim me ata të viteve të

kaluara. Ai u karakterizua nga një tematikë më e larmishme dhe më e thjeshtë që ju përgjigj më mirë kërkesave të programit për edukimin ideoestetik të fëmijëve parashkollorë. Nëpërmjet këngëve, valleve e recitimeve fëmijët shprehën me dëlirësi e pastërti fëmijorë dashurinë e mirënjohjen e thellë

e të sinqertë që kanë për Partinë e shokun Enver, për jetën e lumtur e të begatëshme që u është krijuar në atdheun tonë socialist.

Repertori i këtij festivali përmbante këngë, recitime e valle festive kushtuar 30-vjetorit e kongresit të VI të Partisë, tablo e lojna muzikore, valle tematike e popullore, balet, fabula, e përralla të inskenuara. Të gjitha këto tregonin për punën që bëhet në institucionet parashkollore për edukimin politik e ideologjik, për edukimin mendor e moral, për kalitjen fizike dhe edukimin estetik, për lidhjen organike midis mësimit, lojës e punës.

Në përgjithësi këngët e vallet, lojnat e tabllotë muzikore, baleti e fabulat u ekzekutuan nga fëmijët me mjaft aftësi, forcë e dinamizëm. Në skenë debutuan me dhjetra talente të ardhëshme me artin e tyre fëmijor, plot sinqeritet e vërtetësi, gjë që dëshmon se tek fëmijët parashkollorë ka një brumë të mrekullueshëm për të përpunuar në të arthmen talente që mund të jenë një pasuri e madhe për artin tonë revolucionar.

Në përgatitjen e këtij festivali një kontribut shumë të çmuar dhanë prindët, kompozitorë, shkrimtarë, valltarë, e koreografë, studentë e punonjës të institucioneve artistike si Ç. Zadeja, B. Pici, R. Radoja, T. Harapi, T. Daija, K. Lara, B. Kongoli, K. Jakova, A. Mamaqi, T. Papuçiu, T. Hoshafi, P. Kanaçi, L. Papa, H. Shtuni etj., të cilët krijuan dhe vunë në skenë pjesë të gëzueshme e të përshtatëshme për fëmijët.

Një sukses i padiskutueshëm është se në këtë festival mjaft kolektiva edukatoresh të kopshteve të fëmijëve, megjithë vështirësitë e mëdha që kanë në gjetjen e repertorit, muarrën nismativë të guximshme për të vënë në skenë gjini muzikore

më të larta për moshën parashkollore siç janë fabulat e përrallat, baleti, tabllotë, e lojnat muzikore, gjë që tregon se në këtë drejtim po punohet më mirë për t'u dhënë fëmijëve pjesë më të përshtatëshme për botën e tyre fëmijore si fabulat: «Ara e përbashkët» (kopshti Nr. 31), «Një ngjarje në pyll» (kopshti Nr. 44), «Milin-gonat» (kopshti Nr. 52), «Brumbulli dhe bletët» (kopshti Nr. 11), «Kërpurdha e miqt e saj» (kopshti Nr. 43), «Baleti: Lule të Partisë» (kopshti Nr. 44) ose tabllotë muzikore «Dy lulet» (kopshti Nr. 9), «Pranvera» (kopshti Nr. 11), «Qyteti i lodrave» (kopshti Nr. 3), «Lamtumirë kopësht» (Kopshti Nr. 7) etj. si edhe shumë valle tematike e popullore, lojra muzikore të ekzekutuara me aftësi artistike nga kopshtet Nr. 2, 6, 8, 10, 21, 27, 34, 23, 24, 53, 17 etj. Gjithashtu në festival u dalluan zëra të bukura e melodiozë të disa fëmijëve si dhe kore të intonuara shumë mirë si kopshtet Nr. 37, 46, 13, 25, 33 etj. sidomos tek spektatorët la mbresa kori i kopshtit Nr. 37 me këngën «Lamtumirë kopësht».

Në këtë festival u paraqitën edhe disa pjesë si këngë, tablo, valle apo fabula të vështira e të pakapëshme nga fëmijët e moshës 3-6 vjeçare. Mendojmë se në fushën e krijimtarisë për fëmijët parashkollorë si në letërsi e në muzikë dalin mjaft probleme të rëndësishme. Është e domosdoshme që shkrimtarët e kompozitorët të njihen më shumë me kërkesat e fëmijëve, me specifikën e moshës parashkollore, që në të ardhmen t'u japin fëmijëve pjesë më të bukura e më të thjeshta, me përmbajtje më të thellë ideore, por që këto të jenë të ngritura në art, të jenë të lehta për t'u përvetësuar nga masa e fëmijëve.

Po kështu duhet përmirësuar



metoda e punës së edukatoreve në edukimin e fëmijëve me fjalën artistike dhe për një interpretim më të mirë të këngëve. Edhe në fushën e koreografisë mendoj se është e nevojshme të bëhen studime të posaçme për t'u mësuar fëmijëve të çdo grupi moshe kërcime të lehta e dinamike duke luftuar tendencën për t'u mësuar fëmijëve ritmet e valleve të të riturve.

Festivali IV i këngës e valles

me fëmijët e kopshteve të Tiranës shënon një sukses të rëndësishëm në pasurimin e freskimit e repertorit të këngëve e valleve, në edukimin ideoestetik të fëmijëve, për të përcuar tek ato idetë e Partisë dhe mësimet e shokut Enver, për t'i edukuar fëmijët që në moshë të njomë me tiparet e larta morale të brezit tonë të ri.

Korespondenti i «Nëndorit»

## FESTIVALI KOMBËTAR I KËNGËS DHE VALLES POPULLORE TË PËRPUNUAR



Është e para herë që tek ne ndërmerret një aksion, ku forca të konsiderueshme krijuese dhe ekzekutuese të artit muzikor e koreografik e përqëndrojnë veprimtarinë e tyre në përpunimin e interpretimin me një nivel të ngritur artistik të këngës dhe të valles sonë popullore.

Për pesë ditë rrjesht salla e Teatrit «8 Nëndori» të qytetit të Vlorës buçiti nga tingujt melodiozë e optimistë të melodive të këngëve dhe valleve popullore që ekzekutuan grupet, solistët e ansamblet e 11 rrethëve. Festivali nuk që vetëm një manifestim i thjeshtë artistik, por ai u kthye në një tribunë të

vërtetë, ku u rrahën mjaft probleme që i dalin veprimtarisë krijuese në këtë sektor të rëndësishëm të artit tonë popullor. Në referatet, kumtesat, diskutimet që u mbajtën gjatë seanceve të ndryshme të festivalit u trajtuan tema të rëndësishme mbi kriterin që duhet ndjekur në përpunimin e melodive vokale e instrumentale të këngës e të valleve popullore, u zhvilluan debate e u shkëmbyen mendime për shumë çështje e probleme, që preokupojnë sot veprimtarinë krijuese në këtë fushë dhe që të gjithë diskutantët pa përjashtim e vlerësuan mjaft frytdhënës këtë aksion artistik.

Këngët, vallet, meloditë vokale dhe instrumentale të përpunuara me shije nga kompozitorët e koreografët tanë profesionistë dhe amatorë, përgatitja serioze e programeve të koncerteve nga mjaft grupe e solistë pjesëmarrës i dhanë festivalit pamjen e një tabloje të gjërë ngjyrash, tingujsh, ritmesh, figurash plastike, që formonin një mozaik të pasur motivesh.

Një anë tjetër pozitive e festivalit ishte përpunimi i këngëve polifonike. Ansamblet e Korçës, Vlorës, Gjirokastrës, Fierit e Shkodrës etj, ekzekutuan këngë të ndryshme të përpunuara nga K. Kono, Ç. Zadeja, T. Harapi, S. Gjoni, A. Prodani, Sh. Kushta etj. Këto këngë tingëlluan të freskëta e optimiste. Në disa përpunime shihej kujdesi i kompozitorëve për të nxjerrë në pah në mënyrë të qartë koloritin e harmonisë popullore, tingujt transparentë e ekspresivë të pentatonit shqiptar. Bukur tingëlluan në këtë festival meloditë folkloristike të ekzekutuara me instrumenta popullore e të shoqëruara me orkestër simfonike. Kombinimi i melodisë pastorale, që luajti me kavall solisti popullor i rre-

thit të Elbasanit Nevruz Tahiri i shoqëruar nga orkestra, ishte i goditur. Po ashtu edhe meloditë popullore të luajtura me çifteli e gjeth nga solisti i rrethit të Shkodrës Gjet Toma i shoqëruar nga orkestra simfonike, ishin gjëra krejt të reja në këtë festival dhe u pritën mirë nga publiku.

Komplekset vokale, grupet korale, orkestrat simfonike e grupet e valleve të mjaft rrethëve si ato të Korçës, Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Gjirokastrës e Kukësit u paraqitën me një përgatitje serioze. Numra interesantë paraqitën edhe rrethet e Dibrës, Fierit, Durrësit, Lezhës e Matit. Në festival u dalluan përpunime të tilla si këngë labe e Ç. Zadejës, **Dasmë e re, Valle shkodrane** e T. Harapit, **Si dukat i vogël je** e T. Daisë, **Kjo anë e lumit** e Gj. Kapidanit, **Midis ballit ke një pikë** e A. Paparistos, kënga arbëreshe **Të fala katundit** e Z. Grudës, **Suitë këngësh Myzeqare** e S. Gjoni, **Çupat e Kolonjës** e A. Prodani, **Këngë epike Devollite** e K. Konos, **Dale që të flasim** e Shpëtim Kushtës, **Kënga e Kajo Karafilit** e A. Mulës, motive popullore për fizarmonikë të A. Balliçit, motive për kitarë të P. Gacit e përpunime të tjera të H. Dalipit, K. Laros, Th. Mones, P. Shollës, V. Çangut, B. Shehut, N. Dokos, L. Satës, M. Bylos, T. Rrotës, F. Ibrahimit, E. Marës, K. Rusit etj. Grupet e valleve të Korçës, Kukësit, Elbasanit, Vlorës, Fierit, Dibrës, Durrësit, Gjirokastrës etj. paraqitën valle të folklorit koreografik të rrethit. U vlerësua puna e koreografit R. Bogdani në Korçë, A. Aliaj e S. Verçani në Elbasan, G. Kaceli në Kukës, Xh. Thana në Dibër, N. Agolli, e M. Karalliu në Gjirokastrë, D. Sulli e J. Kosta në Vlorë, E. Tërshana në Lezhë etj.

Në referat, diskutime e de-



bate, që u zhvilluan në seminar u theksua me të madhe nevoja e një studimi të thellë shkencor të këngës e valles popullore. Studimi e analiza shkencore e tyre nuk duhet të mbështetet vetëm në ritmikën e melodikën e tyre pa studjuar thellë rrethanat e kushtet sociale-historike në të cilat lindi kjo këngë apo kjo melodi. Në këtë mënyrë mund të zbulojmë në melodinë popullore lirikën, epikën, tragjikën, elementët dramatikë e kontradiktorë, shprehjen e emocioneve dhe figurave të ndryshme në një motiv të caktuar. Shpesh herë kënga popullore nuk na paraqit mendimin e emocionet e plota mbi një temë të caktuar siç mund të na paraqiste partitura e një kënge të kompozuar me ritëm, melodi e harmoni të qartë. Gjëja më e rëndësishme për artistin e kompozitorin është që t'i zbulojë këta komponentë tek melodia e popullit, e cila i mban të fshehura në vetvete. Në veprat më të mira simfonike, në baletet, koncertet instrumentale e gjinitë e larta të muzikës së dhomës të kompozitorëve tanë motivi popullor është studjuar në thellësi e detaje duke u përpunuar në mënyrë krijuese dhe duke u veshur me një harmoni e orkestracion të përshtatshëm. Kënga popullore si në fakturën ritmike ashtu dhe në atë melodike ka specifikën e vet. Ajo nuk i nënshtrohet rregullave të harmonisë shkollore.

U theksua si nevojë e domosdoshme studimi i polifonisë sonë popullore, e cila përmban visare të çmuara të harmonisë, stilit e timbrit kombëtar. Ekziston akoma një deficiet i ndijshëm në repertorin tonë me këngë polifonike të përpunuara me kritere të drejta teknike e profesionale. Ato pak pjesë që u ekzekutuan janë përshtypje të mirë. Ku më shumë e ku më

pak tingëlloi logjike lirika optimiste e këngëve polifonike të 'ugut.

Për meloditë e këngëve dhe të valleve popullore të Shqipërisë së mesme pati dhe ndonjë mendim subjektiv dhe të gabuar, duke i cilësuar ato me ndikime të huaja e orientale. Shkallët e modet orientale nuk janë karakteristikë vetëm në muzikën tonë popullore, por në mjaft popuj të Ballkanit e të Azisë së vogël. Një zhvillim të theksuar pati muzika jonë popullore qysh në shekullin e XVI në Shkodër, Berat e Elbasan. Jaret shkodrane, këngët e vjetra të Elbasanit, këngët lirike, qytetare beratase e mjaft motive melodike e koreografike, që përpara 300 e ca vjetëve krijoheshin me frymën e ndikimin e artit bizantin e orienttal, u përpunuan gjatë qindra vjetëve nga populli, i cili u dha atyre tiparet e karakteristikat origjinale shqiptare. Ato, pra, s'janë as turke as orientale, por krijime origjinale shqiptare, që kryen një funksion të caktuar në një epokë të caktuar historike.

Festivali i Vlorës që vetëm hapi i parë; megjithë punën e madhe e serioze që kishin bërë amatorët e rretheve mund të themi se problemi i përpunimit të muzikës popullore kërkon në të ardhmen një zgjidhje më të thellë e më të organizuar. Disa përpunime si ato të Fierit dhe të disa rretheve të tjera nuk tingëljuan me forcën e duhur, për arsye të ekzekutimit të dobët.

Janë të gjitha mundësitë që muzikën popullore ta trajtojmë në të ardhmen në një plan më të gjërë, më të kulturuar e më shkencor. Pasuria e madhe dhe e larmishme e folklorit tonë muzikor e koreografik na jep të gjitha mundësitë për forma e përpunime me një nivel edhe më të ngritur, ku të marrin

pjesë forcat krijuese e ekzekutuese profesioniste, orkestra simfonike, artistë lirikë, kuarte te harqesh komplekse vokale e kore të fuqishëm. Këto forca do të nxjerrin në pah me forcë të madhe vlerat e mëdha të folklorit duke ekzekutuar valle simfonike, ballada, rapsodi me tema popullore e forma të tjera vokale e instrumentale me motive të zgjedhura e të seleksionuara nga bagazhi i pasur i artit popullor. Duhet thënë se në këtë festival shumica e pjesëve të programeve ishin harmonizime e stilizime të thjeshta, kurse pjesë të përpunuara me nivel të lartë artistik pati pak. Shumica e kompozitorëve ia kishin përshtatur përpunimet e tyre aftësive ekzekutuese e interpretuese të amatorëve.

Nga disa rrethe si Gjirokastra, Lezha, Dibra etj, pati disa krijime të mbështetura në intonacionet e muzikës popullore e jo përpunime të folklorit të rrethit. Një e metë tjetër që ajo që vallet e përpunuara shpesh herë me shije e profesionalizëm shoqëroheshin me muzikë të papërpunuar.

Të pakta ishin në festival edhe këngët e folklorit të ri, ku trajtohen tema të kohës dhe ku shihet një rritje cilësore në krijimtarinë e masave. Temat aktuale të kohës populli i trajton sot me një ritmikë impulsive e dinamikë të re duke shfrytëzuar nga folklori tradicional ato faktura ritmike e melodike që janë në gjëndje ta paraqesin me vërtetësi atmosferën gazmore e optimiste të kohës.

Përveç orkestrinës popullore të Kukësit e të ndonjë kompleksi të vogël me çifteli, ansamblet orkestrale me instrumenta popullore munguan pothuajse fare.

Festivali i këngës dhe valles popullore të përpunuar që një shkollë e përvojë e madhe për të gjithë kompozitorët, koreografët e forcat e tjera krijuese e ekzekutuese. Ai u cilësua me të drejtë si një festival pune, ku u shkëmbyen mjaft mendime për një trajtim më të kulturuar e me nivel të ngritur artistik të këngës e valles popullore.

**Baki Kongoli**